



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KODI ZGJEDHOR

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 dhe ndryshuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004, ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 dhe ligjin nr. 9371, datë 14.4.2005)

PASQYRA E LËNDËS

PJESA E PARË PËRKUFIZIME DHE PARIME

		Faqe
Neni 1	Qëllimi i këtij Kodi	
Neni 2	Përkufizime	
Neni 3	Parime të përgjithshme	
Neni 4	Subjektet e parimit të moscenimit të zgjedhjeve	
Neni 5	Ndalimi i përdorimit të burimeve në mbështetje të kandidatëve, partive politike ose koalicioneve.....	
Neni 6	Emërimi dhe detyrat e nëpunësit ndërlidhës.....	
Neni 7	Caktimi i datës së zgjedhjeve	
Neni 8	Orari i votimit	

PJESA E DYTË ZGJEDHËSIT, SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE VËZHGUESIT

KREU I ZGJEDHËSIT

Neni 9	Kushtet për të qenë zgjedhës	
Neni 10	Vendi i votimit të zgjedhësve	
Neni 11	Zgjedhësit që banojnë në një shtet tjetër	
Neni 12	Zgjedhësit që ndodhen në vende të posaçme	

KREU II KANDIDATËT

Neni 13	Kushtet për të qenë kandidat	
Neni 14	Plotësimi i vendeve vakante në organet e zgjedhura	

KREU III PARTITË POLITIKE

Neni 15	Regjistrimi i partive politike	
Neni 16	Koalicionet zgjedhore	
Neni 17	Identifikimi i subjekteve zgjedhore	

**KREU IV
VËZHGESIT**

Neni 18	E drejta për të caktuar vëzhgues
Neni 19	Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

**PJESA E TRETË
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KQZ-SË**

KREU I

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Neni 20	Kriteret për anëtarë të KQZ-së
Neni 21	Parime të përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së
Neni 22	Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së
Neni 23	Imuniteti, të drejtat dhe detyrat e anëtarit të KQZ-së
Neni 24	Shkarkimi i anëtarit të KQZ-së
Neni 25	I shfuqizuar
Neni 26	Përtëritja e përbërjes dhe zëvendësimi i anëtarëve të KQZ-së
Neni 27	Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së
Neni 28	Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së
Neni 29	Kompetencat e KQZ-së
Neni 30	Mbledhjet dhe vendimmarrja në KQZ
Neni 31	Aktet e KQZ-së dhe hyrja në fuqi e tyre
Neni 32	Sekretari dhe administrata e KQZ-së
Neni 33	Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ

KREU II

KOMISIONET E ZONAVE ZGJEDHORE (KZZ)

Neni 34	Përbërja e KZZ-së
Neni 34/1	Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZZ-së
Neni 34/2	Kushtet për emërimin e anëtarit dhe të sekretarit të KZZ-së
Neni 35	Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZZ-së
Neni 36	Detyrat e KZZ-së
Neni 37	Detyrat e sekretarit të KZZ-së
Neni 38	Mbledhjet dhe vendimet e KZZ-së
Neni 39	I shfuqizuar

KREU III

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR QEVERISJEN VENDORE (KZQV)

Neni 40	Përbërja e KZQV-së
Neni 40/1	Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KZQV-së
Neni 40/2	Kushtet për emërimin e anëtarit dhe sekretarit të KZQV-së
Neni 41	Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KZQV-së
Neni 42	Detyrat e KZQV-së
Neni 43	Detyrat e sekretarit të KZQV-së
Neni 44	Mbledhjet dhe vendimet e KZQV-së

KREU IV

KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT (KQV)

Neni 45	Përbërja e KQV-së
Neni 45/1	Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së
Neni 45/2	Kushtet për emërimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së
Neni 45/3	Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së
Neni 46	Detyrat e KQV-së
Neni 47	Detyrat e sekretarit të KQV-së
Neni 48	Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së

KREU V

KQV TË POSAÇME

Neni 49	Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-ve të posaçme
---------	--

**PJESA E KATËRT
LISTAT E ZGJEDHËSVE**

KREU I

LISTAT E ZGJEDHËSVE, PËRMBAJTJA, HARTIMI DHE MIRATIMI I TYRE

Neni 50	Regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve
Neni 51	Përmbajtja e listës së zgjedhësve
Neni 52	Organi që harton dhe miraton listat
Neni 53	Përbërësit zgjedhorë të regjistrimit themeltar të shtetasve dhe administrimi i tyre
Neni 54	I shfuqizuar

KREU II

PROCESI I PËRGATITJES SË LISTËS SË ZGJEDHËSVE DHE KRIJIMIT TË ZONA VE TË QENDRA VE TË VOTIMIT

Neni 55	Përgatitja e listave paraprake të zgjedhësve
Neni 56	Njoftimi me shkrim i zgjedhësve
Neni 57	Shkaqet për ndryshime në listat paraprake
Neni 58	Procedura e rishikimit dhe e ndryshimit të listave paraprake
Neni 58/1	Ndryshimi në listën paraprake me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile
Neni 59	Përgatitja e listës përfundimtare të zgjedhësve
Neni 60	Ndryshimi i listës pas shpalljes së listës përfundimtare
Neni 60/1	Zgjedhjet e pjesshme ose të parakohshme
Neni 61	Vënia e listave të zgjedhësve në dispozicion të subjekteve zgjedhore
Neni 62	Zgjedhësit e veçantë
Neni 63	Institucionet e posaçme
Neni 64	Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit
Neni 64/1	Studentët
Neni 64/2	Dispozitë kalimtare për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005
Neni 64/3

PJESA E PESTË

SISTEMI I ZGJEDHJEVE

KREU I

SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Neni 65	Përbërja e Kuvendit
Neni 66	Zgjedhja e deputetit në zonat njëmërore
Neni 67	Ndarja e mandateve plotësuese
Neni 68	Ndarja e mandateve plotësuese partive të koalicionit me listë shumë-mërore të përbërë

KREU II
ZONAT ZGJEDHORE

		Faqe
Neni 69	Zonat zgjedhore njëmërore	
Neni 70	I shfuqizuar	
Neni 71	I shfuqizuar	
Neni 72	I shfuqizuar	
Neni 73	I shfuqizuar	
Neni 74	I shfuqizuar	
Neni 75	I shfuqizuar	

KREU III

SISTEMI I ZGJEDHJEVE VENDORE

Neni 76	Sistemi i zgjedhjeve vendore
Neni 77	Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore

PJESA E GJASHTË PARAQITJA E KANDIDATËVE

KREU I

KANDIDATËT PËR TË CILËT VOTOHET DREJTPËRDREJT

Neni 78	Paraqitja e dokumentacionit të kandidatit
Neni 79	Kërkesat për vlefshmërinë e dokumenteve të kandidimit
Neni 80	Lista e zgjedhësve që mbështesin kandidatin për zgjedhjet për në Kuvend
Neni 81	Lista e zgjedhësve që mbështesin kandidatin në zgjedhjet vendore
Neni 82	Zëvendësimi i kandidatit
Neni 83	I shfuqizuar

KREU II

LISTAT SHUMEMËRORE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT

Neni 84	Paraqitja e listave
Neni 85	Pranimi i listave
Neni 86	Verifikimi i listave nga KQZ-ja

KREU III

LISTAT SHUMEMËRORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 87	Kushtet për vlefshmërinë e listave
Neni 88	Mospranimi i listave
Neni 89	Verifikimi dhe publikimi i listave

PJESA E SHTATË PROCEDURAT E VOTIMIT

KREU I FLETËT E VOTIMIT

Neni 90	Fletët e votimit
Neni 91	Përmbajtja e fletëve të votimit
Neni 92	Vulosja e fletëve të votimit
Neni 93	Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KQZ-ja në KZZ ose KZQV
Neni 93/1	Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KZZ-ja ose KZQV-ja në KQV

KREU II QENDRAT E VOTIMIT DHE ZONAT E TYRE

Neni 94	Caktimi i zonave të qendrave të votimit
Neni 95	Vendndodhja e qendrës së votimit, e selive të KZZ-ve dhe KZQV-ve dhe e Vendit të Numërimit të Votave
Neni 95/1	Përgatitja e Vendit të Numërimit të Votave
Neni 95/2	Ngritja e grupeve të numërimit
Neni 96	I shfuqizuar

KREU III PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 97	Veprime paraprake të KQV-së
Neni 98	Hapja e votimit dhe prania e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

KREU IV PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Neni 99	Numri i kutive të votimit
Neni 100	Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit
Neni 101	Votimi
Neni 102	Fletët e votimit të dëmtuara
Neni 103	Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë
Neni 104	Rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit
Neni 105	Personat e pranishëm në qendrën e votimit
Neni 106	I shfuqizuar
Neni 107	Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit

KREU V MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 108	Mbyllja e votimit
Neni 109	Veprimet pas mbylljes së votimit
Neni 109/1	Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave
Neni 109/2	Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZZ-ja ose KZQV-ja
Neni 109/3	Numërimi i votave
Neni 109/4	Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës
Neni 109/5	Vlerësimi i votave
Neni 109/6	Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit
Neni 109/7	Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga KZZ-ja ose KZQV-ja
Neni 109/8	Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave
Neni 110	I shfuqizuar

KREU VI RINUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 111	I shfuqizuar
Neni 112	I shfuqizuar
Neni 113	I shfuqizuar
Neni 114	I shfuqizuar
Neni 115	I shfuqizuar

KREU VII
NDALIMI I PERDORIMIT TË FORCAVE DHE STRUKTURAVE TË POSAÇME

Neni 116 Përdorimi i forcave dhe strukturave të posaçme

PJESA E TETË
PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

Neni 117 Pavlefshmëria e zgjedhjeve

PJESA E NËNTË
REFERENDUMET

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 118 Kuptimi i referendumit

Neni 119 Kufizime në ushtrimin e të drejtës së referendumit

Neni 120 Procedurat për zhvillimin e referendumeve

Neni 121 Miratimi i projektligjeve që votohen në referendum

KREU II
LLOJE TË VEÇANTA REFERENDUMESH

SEKSIONI 1
REFERENDUMI KUSHTETUES

Neni 122 Llojet e referendumit kushtetues

Neni 123 Procedurat fillestare

Neni 124 Shqyrtimi paraprak nga Gjykata Kushtetuese

Neni 125 Procedurat e mëtejshme për referendumin kushtetues

SEKSIONI 2
REFERENDUMI I PËRGJITHSHËM

Neni 126	Nisma për referendum të përgjithshëm
Neni 127	Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve
Neni 128	Verifikimi i kërkesës nga KQZ-ja
Neni 129	Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese
Neni 130	Caktimi i datës së referendimit të përgjithshëm
Neni 131	Referendume me nismën e Kuvendit

SEKSIONI 3
REFERENDUMET VENDORE

Neni 132	Nisma për referendum vendor
----------	-----------------------------------

PJESA E DHJETË
FUSHATA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Neni 133	Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore
Neni 134	Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës
Neni 135	Materialet propagandistike
Neni 136	Fushata zgjedhore në Radiotelevizionin Publik
Neni 137	Edicionet informative të Radiotelevizionit Publik.....
Neni 138	Minutazh falas për KQZ-në
Neni 139	Orari i transmetimeve
Neni 140	Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private
Neni 141	Thyerja e heshtjes zgjedhore
Neni 142	Monitorimi i fushatës zgjedhore

PJESA E NJËMBËDHJTË
FINANCIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 143	Financimi i zgjedhjeve
Neni 144	Burimet jopublike të financimit të fushatës zgjedhore
Neni 145	Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondit për financimin e fushatës zgjedhore
Neni 145/1	Deklarimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore

PJESA E DYMBËDHJETË
ANKIMET

KREU I

ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE I VENDIMEVE TË KOMISIONEVE
ZGJEDHORE

Neni 146	E drejta e ankimimit
Neni 146/1	Llogaritja e afateve
Neni 147	Forma dhe përmbajtja e ankimit kundër vendimeve të KZZ-së ose KZQV-së
Neni 148	Regjistrimi i kërkesave ankimore nga KQZ-ja
Neni 149	Verifikimi i plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore
Neni 150	Objekti i verifikimit paraparak
Neni 151	Përmbajtja e vendimit të pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore
Neni 152	Bashkimi i kërkesave ankimore
Neni 153	Palët në shqyrtimin administrativ
Neni 154	Shqyrtimi administrativ
Neni 155	Çelja e seancës për shqyrtimin e kërkesës ankimore
Neni 156	Paraqitja e pretendimeve dhe kërkimi i provave
Neni 157	Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova
Neni 158	Këqyrja e materialit zgjedhor
Neni 159	Faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet
Neni 160	Prapësimet mbi provat
Neni 161	Mbyllja e hetimit administrativ
Neni 161/1	Tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre
Neni 161/2	Afati për marrjen e vendimit

Neni 161/3	Vendimet me shumicë të cilësuar në KQZ
Neni 161/4	Përmbajtja e vendimeve të KQZ-së

KREU II

ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË

Neni 162	E drejta e ankimit në gjykatë
Neni 163	Përbërja e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë
Neni 164	Kohëzgjatja dhe mbledhjet e Kolegjit Zgjedhor
Neni 165	Kriteret për mospërfshirjen e gjyqtarëve në short
Neni 166	Pavlefshmëria e delegimit
Neni 167	Mbrojtja e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor
Neni 167/1	Përfshirja e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes
Neni 168	Afati i ankimit në gjykatë
Neni 169	Forma dhe përmbajtja e ankimit
Neni 170	Veprimet paraprake lidhur me kërkesëpadinë
Neni 171	Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë
Neni 172	Të drejtat e palëve në proces
Neni 173	Afati i gjykimit në Kolegjin Zgjedhor
Neni 174	Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.....
Neni 174/1	Përmbajtja e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

PJESA E TREMBËDHJETË

PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 175	Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve
Neni 176	Votimi më shumë se një herë
Neni 177	Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve
Neni 178	Sanksione administrative
Neni 179	Sanksionet për shkelje të parimeve të Kodit

PJESA E KATËRMBËDHJETË

RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 180	Ruajtja e dokumentacionit
----------	---------------------------------

PJESA E PESËMBËDHJETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 181	Zonat zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2005
Neni 181/1	Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së në funksion të përtëritjes së përbërjes së tij
Neni 182	Shfuqizime
Neni 182/1	I shfuqizuar

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PJESA E PARË

PËRKUFIZIME DHE PARIME

Neni 1

Qëllimi i këtij Kodi

Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave:

- a) për votimin për zgjedhjet për Kuvendin, për organet e qeverisjes vendore dhe në referendum;
- b) për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të zgjedhjeve;
- c) për përgatitjen dhe rishikimin e listave të zgjedhësve;
- ç) për caktimin e zonave zgjedhore;
- d) për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe financimin e tyre;
- dh) për pasqyrimin e fushatave zgjedhore nga ana e mediave;
- e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve;
- ë) për procedurat e votimit dhe të nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve;
- f) për shkeljet penale dhe administrative të dispozitave të këtij Kodi.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij Kodi:

1. “Data e zgjedhjeve” është data e votimit e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.
2. “Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë.
3. “Kandidat” është një shtetas shqiptar, i regjistruar në komisionet e zgjedhjeve si kandidat për deputet ose për kryetar bashkie a komune, ose për këshillin e bashkisë a të komunës, në përputhje me këtë Kod, për të cilin do të votohet në zgjedhje.
4. “Kandidat i pavarur” është një kandidat për deputet ose për kryetar bashkie a komune, ose për këshillin e bashkisë a të komunës, që nuk mbështetet nga asnjë parti politike.
5. “Koalicion” është një grupim i dy ose më shumë partive politike të regjistruara në KQZ, të cilat paraqesin kandidat për deputet, kandidat për kryetar bashkie ose komune ose një listë shumemërore për zgjedhjet për Kuvendin ose këshillin e bashkisë a komunës.
6. “KQV” është Komisioni i Qendrës së Votimit.
7. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i krijuar sipas nenit 154 të Kushtetutës.
8. “KZQV” është Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore.

9. "KZZ" është Komisioni i Zonës Zgjedhore.
10. "Listat e zgjedhësve" janë dokumente zyrtare të regjistrimit të zgjedhësve për çdo zonë të qendrës së votimit, të parashikuara në përputhje me këtë Kod.
11. "Listë shumemërore" është lista e kandidatëve të një partie politike ose koalicioni, e cila miratohet nga KQZ-ja dhe shërben për caktimin e deputetëve nga mandatet plotësuese për Kuvendin ose për caktimin e këshilltarëve në këshillat e njësisë të qeverisjes vendore.*
12. "Listë shumemërore e përbashkët" është lista e kandidatëve të një koalicioni, i cili paraqitet si një subjekt i vetëm në fletën e votimit.
13. "Listë shumemërore e përbërë" e një koalicioni është lista shumemërore që përbëhet nga lista të veçanta të partive të koalicionit, të cilat paraqiten veçmas në fletën e votimit.
14. "Njësi zgjedhore" është një zonë zgjedhore ose një bashki a komunë në rastin e zgjedhjeve vendore.
15. "Parti politike" është një parti e regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike".
16. "Periudhë e zgjedhjeve" është periudha nga 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve, deri në shpalljen përfundimtare të rezultateve të votimit.
17. "Përfaqësues i subjektit zgjedhor" është një person i autorizuar nga një kandidat ose parti politike e regjistruar, për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore, në emër dhe për llogari të kandidatit ose të partisë.
18. "Qendër votimi" është mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimit, në përputhje me këtë Kod.
19. "Referendum kushtetues" është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.
20. "Referendum i përgjithshëm" është referendumi, që zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.
21. "Referendum vendor" është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.
22. "Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve" është një agregat i listave të zgjedhësve, të hartuara sipas rregullave përkatëse të këtij Kodi.
23. "Rishikimi i listave" është procesi i fshirjes ose i shtimit të emrave apo i ndryshimit të të dhënave në listat e zgjedhësve.
24. "Student" është çdo zgjedhës i regjistruar si student me shkëputje nga puna në një program arsimimi ose kualifikimi profesional në Shqipëri për jo më pak se tre muaj, vendqëndrimi i të cilit, për qëllimin e edukimit ose të kualifikimit, është i ndryshëm nga vendbanimi i tij.
25. "Subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet e regjistruara në KQZ, kandidatët e tyre, si dhe kandidatët e pavarur të regjistruar në KZZ ose KZQV.
26. shfuqizuar.†
27. shfuqizuar.‡
28. "Zgjedhës" është çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote.

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 1*)

† Kjo pikë është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 1*)

‡ Kjo pikë është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 1*)

29. "Zgjedhës në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit" janë të gjithë zgjedhësit, që shërbejnë në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit, me vendqëndrim në një repart ushtarak ose të rendit.

30. "Zgjedhje" janë votimet për Kuvendin, për organet përfaqësuese të qeverisjes vendore ose në referendum.

31. "Zgjedhje të pjesshme" janë votimet për të plotësuar vendin e kandidatit të pavarur të zgjedhur në një zonë njëemërore ose vendin e kryetarit të bashkisë a të komunës, si dhe për zgjedhjen e një këshilli të ri vendor në rast shpërndarjeje.

32. "Zonë e qendrës së votimit" është një zonë gjeografike brenda territorit të një bashkie, komune ose zone zgjedhore, e përcaktuar në përputhje me këtë Kod.

33. "Zonë zgjedhore" është një nga 100 ndarjet gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë, e përcaktuar në përputhje me Kushtetutën, si dhe me rregullat e këtij Kodi, në të cilën votohet për zgjedhjen e një deputeti.

34. "Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve" është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

a) rezultatin e votimit për kandidatët për deputetë, kryetarë bashkie dhe komune, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në njësitë zgjedhore përkatëse; dhe

b) numrin e vendeve të fituara nga çdo parti politike ose koalicion, pas llogaritjeve të parashikuara në këtë Kod; ose

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të Pjesës së Nëntë të këtij Kodi.*

35. "Marrëdhënie krushqie e afërt" është lidhja e krushqisë midis anëtarit të komisionit dhe kandidatit, ku njëri prej tyre është prind i bashkëshortit ose bashkëshortes së tjetrit apo motër ose vëlla i bashkëshortit ose bashkëshortes, apo bashkëshort i motrës së bashkëshortes ose të bashkëshortit apo bashkëshorte e vëllait të bashkëshortes ose të bashkëshortit.†

Neni 3

Parime të Përgjithshme

1. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

2. Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

3. Zgjedhësit ushtrojnë lirisht të drejtën e votës, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

4. Zgjedhësit janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

5. Ndarja e zonave zgjedhore bëhet duke përfshirë në secilën prej tyre një numër afërsisht të barabartë zgjedhësish.

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 1*)

† Kjo pikë është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 1*)

6. Çdo zgjedhës ka të drejtën vetëm të një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor ose të një alternative referendare, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

7. Subjektet zgjedhore janë të lira të bëjnë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

8. Komisionet zgjedhore, të parashikuara në këtë Kod, i përmbushin funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente.

9. Ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike janë të detyruara të garantojnë moscenimin e parimeve të përgjithshme të përcaktuara në këtë nen, si dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të mos dëmtohet ose pengohet nga veprimtaria e tyre administrimi dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente.

Neni 4

Subjektet e Parimit të Moscenimit të Zgjedhjeve

Parimi i moscenimit të zgjedhjeve zbatohet për të gjitha nivelet e institucioneve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor. Këtij parimi i nënshtrohen të gjithë nëpunësit ose funksionarët politikë gjatë veprimtarisë së tyre, në emër dhe për llogari të institucionit.

Neni 5

Ndalimi i Përdorimit të Burimeve në Mbështetje të Kandidatëve, Partive Politike ose Koalicioneve

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të ministrive ose të institucioneve të tjera të administratës publike në nivel qendror ose vendor.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me “burime njerëzore” kuptohet përdorimi i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. Edhe marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë, me përjashtim të rasteve të motivuara, konsiderohen veprimtari të institucionit të administratës publike.

Neni 6

Emërimi dhe Detyrat e Nëpunësit Ndërlidhës

1. Aparati i Këshillit të Ministrave dhe i Kryeministrit, të gjitha ministritë, prefekturat dhe bashkitë janë të detyruara të caktojnë nëpunës ndërlidhës, përgjegjës për shkëmbimin e informacionit me KQZ-në, për veprimtaritë që kanë lidhje me administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike, jo më vonë se 24 orë pas caktimit të datës së zgjedhjeve.

2. Për emërimin e nëpunësit ndërlidhës i dërgohet njëkohësisht njoftim me shkrim KQZ-së, në të cilin përfshihet emri i nëpunësit, detyra ose titulli që mban, adresa e punës, si dhe numrat e telefonit dhe faksit. Në rast se ndonjëri nga këto institucione nuk cakton nëpunësin e vet ndërlidhës, në përputhje me kërkesat dhe brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, atëherë titullari i institucionit përkatës konsiderohet se ka marrë përsipër funksionin e nëpunësit ndërlidhës.

3. Nëpunësi ndërlidhës ka për detyrë t'i paraqesë KQZ-së informacion të plotë me shkrim për urdhrat e titullarit për çdo veprimtari që mund të ndikojë ose dëmtojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente. Ky informacion i jepet me shkrim KQZ-së jo më vonë se 10 ditë përpara datës së përcaktuar për fillimin e veprimtarisë.

4. Nëpunësit ndërlidhës i jepet akses i informacionit në nivelet më të larta të institucionit të vet, me qëllim shkëmbimin e informacionit me KQZ-në.

5. Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e institucionit mund të dëmtojë ose të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, atëherë KQZ-ja informon me shkrim nëpunësin ndërlidhës të institucionit përkatës jo më vonë se 5 ditë përpara datës së përcaktuar për fillimin e veprimtarisë.

Neni 7

Caktimi i Datës së Zgjedhjeve

1. Data e zgjedhjeve caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, sipas rregullave të parashikuara në nenet 65, 109, 115, 151 pika 3, 152 pika 3 dhe 170 pika 6 të Kushtetutës.

2. Për efekt të zbatimit të këtij Kodi, mandati i Kuvendit mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së mbledhjes së parë të tij. Mandati i organeve të qeverisjes vendore mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të tretë pas datës së shpalljes me vendim të KQZ-së në shkallë vendi të rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

3. Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 75 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Me vendim të Kuvendit, mbyllja e legjislaturës dhe shpërndarja e tij bëhen jo më shpejt se 45 ditë para datës së caktuar për zgjedhjet dhe jo më vonë se 3 ditë para kësaj date.

4. Në zbatim të nenit 87 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së Kuvendit. Në zbatim të nenit 65 të Kushtetutës zgjedhjet zhvillohen jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Datë e shpërndarjes së Kuvendit është data e votimit të pestë, sipas paragrafit 7 të nenit 87 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin e ri.

5. Në zbatim të paragrafit 4 të nenit 96 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, jo më vonë se 24 orë pas votimit të parashikuar në pikën 3 të po atij neni, Presidenti i Republikës dekreton shpërndarjen e Kuvendit dhe cakton datën e zgjedhjeve. Në zbatim të nenit 65 të Kushtetutës zgjedhjet zhvillohen jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

6. Kur për shkaqe të tjera nga ato të përmendura në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni Kuvendi vetëshpërndahet, atëherë Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së tij. Kuvendi shpërndahet në ditën e votimit të tij

për vetëshpërndarje. Në zbatim të nenit 65 të Kushtetutës zgjedhjet zhvillohen jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.*

7. Në çdo rast zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen në të dielën më të afërt me ditën e dyzet e pestë pas datës së dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

8. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zhvillohen 60 deri 30 ditë para mbarimit të mandatit të organeve vendore ekzistuese ose jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes ose shkarkimit të tyre. Në rast ankimi të organit të shpërndarë ose të shkarkuar, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 45 ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në rast të mosushtrimit të së drejtës së ankimit nga organet e qeverisjes vendore të shpërndarë ose të shkarkuar, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë pas mbarimit të afatit të ankimit, të parashikuar në nenin 115 pika 3 të Kushtetutës. Afatet e tjera zbatohen për analogji.

9. Dekreti i Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve përmban datën dhe llojin e zgjedhjeve.

Neni 8

Orari i Votimit

1. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 31 marsit dhe 15 tetorit, qendrat e votimit hapen në orën 7⁰⁰ dhe mbyllen në orën 19⁰⁰.

2. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 16 tetorit dhe 30 marsit, qendrat e votimit hapen në orën 7⁰⁰ dhe mbyllen në orën 18⁰⁰.

3. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes të qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.

PJESA E DYTË

ZGJEDHËSIT, SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE VËZHGUESIT

KREU I

ZGJEDHËSIT

Neni 9

Kushtet për të Qenë Zgjedhës

1. Çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve ose para saj dhe që plotëson kushtet e parashikuara në këtë Kod, ka të drejtë të votojë për zgjedhjet për Kuvendin, për organet e qeverisjes vendore dhe në referendume.

* Pikat 3, 4, 5 dhe 6 janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 2)

2. Përjashtohen nga e drejta për të zgjedhur shtetasit e shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë, si të pazotë për të vepruar për shkak të paaftësisë mendore.

Neni 10
Vendi i Votimit të Zgjedhësve

Zgjedhësit votojnë në qendrën e votimit në zonën e së cilës ata janë regjistruar në listën e zgjedhësve.

Neni 11
Zgjedhësit që Banojnë në një Shtet Tjetër

Zgjedhësit që banojnë në një shtet tjetër kanë të drejtë të votojnë vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

Neni 12
Zgjedhësit që Ndodhen në Vende të Posaçme

Zgjedhësit, që në datën e zgjedhjeve ndodhen në institucione të posaçme ose në reparte ushtarake apo të rendit, si dhe studentët, votojnë sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

KREU II

KANDIDATËT

Neni 13
Kushtet për të Qenë Kandidat

1. Kandidati për deputet, përveç kushteve për të qenë zgjedhës, duhet të plotësojë edhe kushtet e pikës 3 të nenit 45 dhe nenit 69 të Kushtetutës.

2. Kandidati për organet e qeverisjes vendore, përveç kushteve të parashikuara në nenin 45 të Kushtetutës, duhet të jetë shtetas me vendbanim në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Kandidati për organet e qeverisjes vendore nuk mund të jetë deputet në Kuvend ose kandidat për deputet.

3. Kandidatët e listave të partive, të depozituara në komisionet e zgjedhjeve, duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 14
Plotësimi i Vendeve Vakante në Organet e Zgjedhura

1. Kur vendi i deputetit në Kuvend mbetet vakant, ai plotësohet me një anëtar të ri.

2. Kur mandati i një deputeti të zgjedhur nga lista shumemërore e një subjekti zgjedhor mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës në listë.

3. Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga një deputet i ri i zgjedhur nga zgjedhësit e së njëjtës zonë zgjedhore. Presidenti i Republikës, mbi bazën e njoftimit të menjëhershëm të Kryetarit të Kuvendit, cakton me dekret datën e zgjedhjeve të pjesshme në atë zonë, jo më vonë se 45 ditë nga marrja e njoftimit. Deputeti i zgjedhur për plotësimin e vendit vakant qëndron deri në fund të mandatit të deputetit të larguar.

Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore mbaron në mënyrë të parakohshme gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës. Në rast se gjatë kësaj periudhe mbaron mandati i një deputeti të pavarur, ai nuk zëvendësohet.*

4. Kur vendi i kryetarit të bashkisë ose komunës mbetet vakant, brenda dy javëve Këshilli i Ministrave njofton Presidentin e Republikës. Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve të pjesshme për zgjedhjen e kryetarit të ri të bashkisë ose komunës, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit. Kur vendi i këshilltarit në këshillat e bashkisë ose të komunës mbetet vakant, ai plotësohet nga kandidati i radhës së listës shumemërore përkatëse.

5. Në qoftë se vendi i kryetarit të bashkisë ose komunës mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në fund të mandatit.

6. Zgjedhjet e pjesshme zhvillohen sipas së njëjtës procedurë si zgjedhjet e përgjithshme.

KREU III

PARTITË POLITIKE

Neni 15

Regjistrimi i Partive Politike

1. Çdo parti politike që paraqet kandidatë për deputetë, kandidatë për kryetarë bashkie ose komune apo për këshilltarë në këshillin e bashkisë ose të komunës, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë Kod, regjistrohet në KQZ si subjekt zgjedhor jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve. Partitë politike ose koalicionet, partitë anëtare të të cilave kanë fituar së bashku më shumë se 20 për qind të votave në zgjedhjet e përgjithshme pararendëse janë të detyruara të paraqesin kandidatë në 100 zonat zgjedhore.

2. Për t'u regjistruar pranë KQZ-së, një parti politike duhet të paraqesë:

- a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 3)

- c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;
- ç) kopjen e vulës së partisë;
- d) emrin dhe adresën e financierit të partisë;
- e) emrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

Neni 16*

Koalicionet Zgjedhore

1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara në KQZ, sipas nenit 15 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor, duke paraqitur, 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve, marrëveshjen përkatëse të koalicionit. Marrëveshja duhet të përcaktojë nëse partitë përbërëse të koalicionit do të paraqiten në votimin proporcional veçmas në fletët e votimit, ose nëse koalicioni do të paraqitet si subjekt i vetëm.

2. Brenda afatit të parashikuar në nenin 78 të këtij Kodi, koalicionet e regjistruara depozitojnë në KQZ listat shumemërore, në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij Kodi.

3. Marrëveshjet e koalicionit zbatohen drejtpërdrejt nga KQZ-ja kur ato përmbajnë:

- a) datën e krijimit, të dhënat mbi përbërjen dhe emërtimin e koalicionit;
- b) listën shumemërore të përbërë kur partitë e koalicionit paraqiten veçmas në fletën e votimit, ose listën shumemërore të përbashkët kur koalicioni paraqitet si subjekt i vetëm.

4. KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe të zbatojë marrëveshje për formulat e shpërndarjes së votave midis partive anëtare të një koalicioni.

5. Partitë politike nuk mund të marrin pjesë në më shumë se një koalicion.

Neni 17

Identifikimi i Subjekteve Zgjedhore

Nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër, shkronja nistore ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojë konfuzion ose lajthim të votuesve, atëherë KQZ-ja vendos cila parti ose cili koalicion ka të drejtë të përdorë emrin, shkronjën nistore ose emblemën përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme.

KREU IV

VËZHGUESIT

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 4*)

Neni 18*
E drejta për të Caktuar Vëzhgues

1. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje.

2. Çdo parti politike e regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZZ, KZQV, KQV dhe në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të një kandidati për njësinë zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Kandidatët e partive politike dhe koalicioneve nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

3. Kandidatët e pavarur në zonat e tyre përkatëse kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në KZZ, KZQV, KQV dhe në Vendin e Numërimit të Votave.

4. Akreditimi i vëzhguesve pranë komisioneve zgjedhore bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi. Akreditimi mund të përfshijë një ose më shumë qendra votimi, ose një apo më shumë njësi zgjedhore. Një organizatë joqeveritare shqiptare, parti politike, koalicion ose kandidat i pavarur nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues të pranishëm në një qendër votimi. Organizatat joqeveritare të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare nuk mund të kenë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues të huaj në një qendër votimi.

5. Kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten KQZ-së jo më herët se 45 ditë dhe jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ-ja miraton kërkesat jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre. Ndaj refuzimit ose mosdhënies së akreditimit mund të bëhet ankim, sipas procedurave të këtij Kodi. Kërkesat e vëzhguesve të huaj paraqiten jo më vonë se 72 orë para datës së zgjedhjeve.

6. KQZ-ja ka të drejtë, me udhëzim të veçantë, t'u delegojë KZZ-ve ose, sipas rastit, KZQV-ve, kompetencën e akreditimit të vëzhguesve, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 19
Të Drejtat dhe Detyrat e Vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve;
 - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
 - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
 - a) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 5)

b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti, koalicion ose alternativë referendare në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;

c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;

ç) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;

d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

PJESA E TRETË

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KQZ-SË

KREU I

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Neni 20

Kriteret për Anëtarë të KQZ-së

1. Anëtar i KQZ-së mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote dhe që plotëson kërkesat e këtij neni.

2. Anëtari i KQZ-së duhet të plotësojë këto kushte:

a) të ketë arsimin e lartë;

b) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë;

c) të mos ketë qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike, në nivel qendror dhe vendor gjatë 5 viteve të fundit;

ç) të mos ketë qenë punonjës i Shërbimit Informativ Shtetëror ose i Policisë së Shtetit në 5 vitet e fundit;

d) të mos jetë larguar nga administrata publike për shkelje të ligjit.

3. Anëtari i KQZ-së duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në të paktën njërin nga fushat e mëposhtme:*

a) në fushën e së drejtës;

b) në administratën publike ose zgjedhore;

c) në shoqata dhe organizata jofitimprurëse që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

ç) në fushën e marrëdhënieve publike;

d) në fushën e statistikave;

dh) në fushën e shkencave politike.

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 6)

Neni 21

Parime të Përgjithshme për Zgjedhjen e Anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtarët e KQZ-së zgjidhen sipas nenit 154 të Kushtetutës. Anëtarët e KQZ-së kolegjisht duhet të përmbushin në çdo kohë kërkesat e nenit 20 të këtij Kodi.
2. Anëtarët e KQZ-së kanë mandat 7-vjeçar dhe mund të rizgjidhen vetëm një herë.
3. Fillimi dhe mbarimi i mandatit të anëtarit të KQZ-së përcaktohet në këtë Kod.
4. Anëtarësia në KQZ nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike.
5. Përpara fillimit të detyrës anëtari i zgjedhur i KQZ-së kryen betimin para Presidentit të Republikës në një ceremoni publike. Teksti i betimit është: **“Betohe në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj.***

Neni 22

Zgjedhja e Anëtarëve të KQZ-së

1. Kuvendi i Shqipërisë zgjedh dy anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve respektive nga spektri i majtë dhe i djathtë i përbërjes politike të tij, përjashtuar partinë më të madhe të secilit spektër politik. Numri i kandidaturave që i paraqiten Kuvendit të Shqipërisë nuk është më i madh se dy për secilin vend vakant. Kandidaturat brenda grupimeve përzgjidhen me konsensus ose sipas numrit të votave mbështetëse të deputetëve që i përkasin të njëjtit spektër të propozuesit, përjashtuar partinë më të madhe të spektrit përkatës. Një deputet nuk duhet të mbështesë më shumë se një listë kandidaturash. Kandidaturat e propozuara i paraqiten Kuvendit nga Kryetari i tij.
2. Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së, në bazë të propozimeve respektive të dy partive më të mëdha të pozitës dhe opozitës. Numri i kandidaturave të propozuara nuk është më i madh se dy për secilin vend në KQZ.
3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh tre anëtarë të KQZ-së, sipas kësaj procedure:
 - a) dy anëtarë të KQZ-së miratohen me nga dy kandidatura të propozuara respektivisht nga dy partitë më të mëdha;
 - b) për kandidatin e tretë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndjek këtë procedurë: Dy grupet më të mëdha parlamentare propozojnë nga katër kandidatura me profesionin jurist. Secili prej grupeve parlamentare përzgjedh dy nga katër kandidaturat e grupit tjetër. Katër kandidaturat e përzgjedhura i paraqiten Këshillit të Lartë të Drejtësisë për votim jo më vonë se 48 orë nga depozitimi i tyre.Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

* Kjo pikë është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 7)

Nëse asnjë kandidat nuk arrin shumicën e kërkuar, zhvillohet raundi i dytë në të njëjtën ditë midis dy kandidatëve që marrin më shumë vota në raundin e parë.

Nëse edhe në raundin e dytë asnjë kandidat nuk merr dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zhvillohet raundi i tretë në të njëjtën ditë midis dy kandidatëve të raundit të dytë. Në raundin e tretë fiton kandidati që merr 50 përqind plus 1 të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 23

Imuniteti, të Drejtat dhe Detyrat e Anëtarit të KQZ-së

1. Anëtari i KQZ-së mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit.

2. Anëtari i KQZ-së mund të ndalohet ose arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të anëtarit të KQZ-së të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

3. Paga dhe privilegjet e anëtarit të KQZ-së janë të njëjta me pagën dhe privilegjet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit është 10 përqind më e lartë se paga e anëtarit të KQZ-së.

4. Anëtari i KQZ-së ushtron funksionin në mënyrë të pavarur. Ai voton në përputhje me ligjin.

5. Anëtari i KQZ-së nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe votimin e një çështjeje kur:

a) ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjë nga kandidatët që kanë paraqitur ankim në KQZ; ose

b) ka një nga pengesat e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

Tërheqja nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes deklarohet me shkrim nga anëtari i KQZ-së ose mund të kërkohet nga çdo përfaqësues i subjekteve zgjedhore apo nga anëtarët e tjerë të KQZ-së. Tërheqja nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes ose vendimi i KQZ-së për përjashtimin e anëtarit nga shqyrtimi dhe rezultati i votimit regjistrohet në procesverbal.*

6. shfuqizuar.

7. shfuqizuar.†

Neni 24

Shkarkimi i Anëtarit të KQZ-së

1. Anëtari i KQZ-së shkarkohet kur:

a) kryen veprimtari shtetërore ose politike, njëkohësisht me detyrën e anëtarit të KQZ-së;

b) me veprim ose mosveprim cenon veprimtarinë e KQZ-së për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe referendumet, si dhe me shpalljen e rezultateve të tyre.‡

* Pikat 4 dhe 5 janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 8)

† Pikat 6 dhe 7 janë shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 8)

‡ Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 9)

2. Shkarkimi i anëtarit të KQZ-së mund të propozohet nga 33 deputetë ose nga KQZ-ja.

3. Anëtari i KQZ-së shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit nga Kuvendi. Gjykata Kushtetuese merr vendim jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e ankimit.

Neni 25*
I shfuqizuar

Neni 26†
Përtëritja e Përbërjes dhe Zëvendësimi i Anëtarëve të KQZ-së

1. Përbërja e KQZ-së përtërihet çdo tre vjet dhe realizohet në dy faza, sipas modaliteteve dhe procedurave të parashikuara në nenin 22 të këtij Kodi.

2. Në fazën e parë përtërihen 4 anëtarë të KQZ-së:

- a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
- b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
- c) dy anëtarë të zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

3. Në fazën e dytë përtërihen 3 anëtarë të KQZ-së:

- a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
- b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
- c) një anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

4. Anëtarët e rinj të KQZ-së zgjidhen jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen.

5. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së, sipas nenit 25 të këtij Kodi, organi që e ka zgjedhur anëtarin që largohet, emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës. Anëtari zëvendësues qëndron në detyrë deri në mbarimin e afatit të mandatit kushtetues dhe ligjor që gëzonte sipas aktit të zgjedhjes anëtari i larguar para kohe.

6. Pavarësisht nga pika 4 e këtij neni, përbërja e KQZ-së nuk mund të ndryshohet gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në këtë rast, anëtarët ekzistues zëvendësohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës së zgjedhjeve. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga organi përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.

Neni 27
Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së

1. Kryetari zgjidhet me votim të fshehtë nga KQZ-ja, sipas kësaj procedure:

* Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 10*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004 (*neni 1*)

- a) në 7 fletë votimi shkruhen emrat e të shtatë anëtarëve të KQZ-së;
 - b) secili prej anëtarëve voton, duke bërë shënimin përkatës, për një nga emrat që janë në fletëvotim;
 - c) anëtari që ka marrë 5 vota konsiderohet i zgjedhur Kryetar;
 - ç) në rast se asnjë prej anëtarëve nuk ka fituar numrin e kërkuar të votave, bëhet një votim i dytë midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota;
 - d) në rast se edhe në votimin e dytë asnjë prej kandidatëve nuk merr 5 vota, atëherë anëtari që ka marrë më shumë vota do të kryejë funksionet e Kryetarit për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj;
 - dh) në përfundim të kësaj periudhe bëhet një votim i ri. Në këtë votim anëtari i KQZ-së i zgjedhur si Kryetar duhet të marrë 5 vota. Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr numrin e kërkuar të votave, bëhet një raund i dytë votimi ndërmjet anëtarëve që kanë marrë më shumë vota. Në raundin e dytë zgjidhet kryetar anëtari që ka marrë më shumë vota.
2. Kryetari i KQZ-së zgjidhet për një periudhë 3,5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje dhe përfshihet në mandatin si anëtar.
3. Zëvendëskryetari i KQZ-së zgjidhet me votim të fshehtë nga anëtarët e KQZ-së, të propozuar nga spektri i kundërt politik i Kryetarit dhe sipas kësaj procedure:
- a) në një fletë votimi shkruhen emrat e anëtarëve, sipas pikës 3 të këtij neni;
 - b) secili prej anëtarëve voton, duke bërë shënimin përkatës, për një nga emrat që janë në fletëvotim;
 - c) anëtari që ka marrë shumicën e votave të të gjithë anëtarëve zgjidhet Zëvendëskryetar i KQZ-së;
 - ç) në rast se asnjë prej anëtarëve nuk ka marrë shumicën e kërkuar, bëhet një raund i dytë votimi ndërmjet dy anëtarëve që kanë marrë më shumë vota. Anëtari që merr më shumë vota në raundin e dytë zgjidhet Zëvendëskryetar i KQZ-së.
4. Zëvendëskryetari zgjidhet për një periudhë prej 3,5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje dhe përfshihet në mandatin si anëtar.
5. Mbledhja për zgjedhjen e Kryetarit kur mungon Zëvendëskryetari drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i KQZ-së dhe procedura e zgjedhjes zhvillohet në prani të një noteri.
6. shfuqizuar.*

Neni 28[†]

Të Drejtat dhe Detyrat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së

1. Kryetari i KQZ-së ka këto kompetenca:
- a) drejton mbledhjet e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhënie me institucionet e tjera;
 - b) kryen funksionet e drejtuesit ekzekutiv të institucionit. Në zbatim të kompetencave, sipas kësaj shkronje, Kryetari i KQZ-së nxjerr urdhra të brendshëm në bazë dhe për zbatim të vendimeve të KQZ-së.

* Kjo pikë është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 11)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 12)

2. Zëvendëskryetari i KQZ-së kryen detyrat e Kryetarit në mungesë të tij.

Neni 29*
Kompetencat e KQZ-së

KQZ-ja kryen këto detyra:

1. Nxjerr, në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Merr vendime për njësimin e praktikave zgjedhore.
3. Drejton dhe kontrollon, nëpërmjet anëtarëve dhe strukturave të saj, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor.
4. Shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, në bazë të rezultateve të shpalluara nga KZZ-ja, ose sipas rastit KZQV-ja, dhe pas përfundimit të shqyrtimit të ankimeve në gjykatë. Shpallja bëhet jo më vonë se tri ditë nga data kur KQZ-ja merr të gjitha të dhënat zyrtare nga komisionet zgjedhore dhe vendimet gjyqësore, sipas këtij Kodi. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së tij.
5. Shpall kandidatët fitues nga listat shumemërore për deputetë.
6. Kryen, me shpenzimet e veta, kurse trajnimi jo më vonë se 30 ditë pas emërimit të anëtarëve të KZZ-ve ose KZQV-ve dhe në përfundim të tyre, pas kryerjes së testeve, u jep atyre dëshminë përkatëse. Për anëtarët e KQV-ve kryen, me shpenzimet e veta, sesione kualifikimi për legjislacionin zgjedhor. KQZ-ja merr masa dhe organizon edhe programe për edukimin zgjedhor të shtetasve.
7. Emëron dhe shkarkon, në përputhje me këtë Kod, anëtarët e KZZ-së ose KZQV-së dhe i mbikëqyr ata në përmbushjen e detyrave të tyre.
8. Boton buletinin e zgjedhjeve, i cili përmban rezultatet e zgjedhjeve për çdo njësi zgjedhore dhe qendër votimi, raportin për shpenzimet zgjedhore, si dhe publikon raportet, sipas nenit 145/1 të këtij Kodi.
9. Paraqet në Kuvend, brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor për veprimtarinë e vitit të kaluar.
10. Përgatit projektbuxhetin vjetor, sipas ligjit përkatës, për funksionimin e institucionit dhe, pas miratimit me ligj të buxhetit, përcakton në mënyrë të përgjithshme strukturën e shpenzimeve buxhetore.
11. Përgatit projektbuxhetin për zgjedhjet e pritshme dhe administron fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme në shërbim të zgjedhjeve, duke marrë vendim për strukturën e shpenzimeve buxhetore dhe donacioneve të ndryshme për zgjedhjet.
12. Shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore për zhvillimin e procesit zgjedhor, në përputhje me rregullat e këtij Kodi.
13. Harton dhe shpërndan modelet për ankimet zgjedhore, në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 13*)

14. Cakton masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe anëtarët e grupeve të numërimit.

15. Vendos sanksione administrative kundër personave që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet.

16. Miraton strukturën, organikën dhe strukturën e pagave të administratës së KQZ-së.

17. Emëron nëpunësit civilë të administratës së KQZ-së, në përputhje me ligjin "Për statusin e nëpunësit civil". Në periudha të caktuara, KQZ-ja vendos të marrë përkohësisht dhe jo me kohë të plotë pune punonjës të niveleve të ndryshme.

18. Miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të KQZ-së, duke përfshirë edhe mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve, të paktën 6 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit.

19. Kryen detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera.

Neni 30*

Mbledhjet dhe Vendimmarrja në KQZ

1. Mbledhjet e KQZ-së thirren nga Kryetari, Zëvendëskryetari ose të paktën nga dy anëtarë të KQZ-së. Në çdo rast thirrja duhet të përmbajë rendin e ditës së mbledhjes.

2. Gjatë periudhës nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ-ja mbledhet rregullisht çdo ditë. Mbledhjet e KQZ-së mbyllen me caktimin e rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse.

3. Njoftimi për mbledhjen së bashku me rendin e ditës shpallet publikisht në hyrje të selisë së KQZ-së dhe, sipas rastit, pranë selive të KZZ-ve ose KZQV-ve të interesuara për çështjen të paktën 24 orë para orës së caktuar për fillimin e mbledhjes.

4. Në fillim të çdo mbledhjeje çdo subjekt zgjedhor i regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje ose persona të tjerë të interesuar, vetëm një herë dhe për një kohë jo më të gjatë se 7 minuta kanë të drejtë të flasin për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

5. Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas pikës 6 të këtij neni.

6. Shpallja e rezultatit të votimit për listat shumemërore për Kuvendin, vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZZ-ve ose KZQV-ve për rezultatin e zgjedhjeve, si dhe vendimet për kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve miratohen kur votojnë *pro* jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së. Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së.

7. Vendimet e KQZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të KQZ-së, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën *pro* ose *kundër*. Mendimi në pakicë është pjesë e vendimit të KQZ-së dhe zbardhet së bashku me të. Anëtarët në pakicë, jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit, duhet të depozitojnë me shkrim arsyetimin e mendimit të tyre në pakicë.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 14*)

8. Çdo mbledhje e KQZ-së fillon sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të këtij neni. Në mbledhjet e KQZ-së kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime vetëm anëtarët e KQZ-së, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, sipas nenit 33 të këtij Kodi dhe me leje të KQZ-së, edhe personat që lidhen me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

9. Mbledhjet e KQZ-së janë të hapura.

Neni 31

Aktet e KQZ-së dhe Hyrja në Fuqi e Tyre

1. KQZ-ja, në bazë dhe për zbatim të ligjit, mund të nxjerrë vetëm këto akte:
 - a) vendime;
 - b) udhëzime.
2. Çdo akt normativ i KQZ-së votohet tri herë, sipas radhës së mëposhtme:
 - a) votohet në parim;
 - b) votohet nen për nen ose sipas rastit pjesë për pjesë;
 - b) në fund votohet në tërësi.
3. Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Kopja origjinale e vendimit mbahet në arkivin e KQZ-së, duke shënuar datën, kohën dhe marrjen në dorëzim të vendimit të KQZ-së kundrejt nënshkrimit.*
4. Sekretari i KQZ-së, kundrejt kërkesës se çdo personi, jep pa pagesë, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KQZ-së.
5. Aktet e KQZ-së me karakter normativ hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa aktet e tjera hyjnë në fuqi menjëherë.†

Neni 32

Sekretari dhe Administrata e KQZ-së

1. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave, që burojnë nga Kushtetuta dhe ky Kod, KQZ-ja ka administratën e vet të përbërë me nëpunës të shërbimit civil. Procedurat e rekrutimit, transferimit, ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele dhe shkarkimit nga detyra bëhen në përputhje me përcaktimet e bëra për institucionet e pavarura në ligjin "Statusi i nëpunësit civil"‡
2. Sekretari i KQZ-së është nëpunësi më i lartë civil në administratën e KQZ-së dhe emërohet me vendim të KQZ-së.
3. Sekretari i KQZ-së duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e të drejtës ose të administratës publike.
4. Sekretari i KQZ-së kryen këto detyra:
 - a) merr masa për organizimin e mbledhjeve të KQZ-së, përgatit materialet e mbledhjes, si dhe bën njoftimet përkatëse;
 - b) merr masa për botimin e akteve të KQZ-së dhe bërjen publike të tyre;

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 15)

† Pika 4 dhe pika 5 janë shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 15)

‡ Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 16)

- c) merr masa për plotësimin e kushteve të punës së anëtarëve të KQZ-së, sipas kërkesave të tyre, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;
- ç) është përgjegjës, drejton dhe organizon punën për zbatimin e urdhrave të brendshëm të Kryetarit të KQZ-së, sipas nenit 28 të këtij Kodi;
- d) ndjek zbatimin e buxhetit dhe merr masat përkatëse për të;
- dh) propozon për miratim në KQZ Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Administratës së KQZ-së;
- e) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga ky Kod.*

Neni 33[†]

Përfaqësuesit e Subjekteve Zgjedhore në KQZ

1. Çdo parti politike mund të caktojë një përfaqësues pranë KQZ-së. Koalicionet përfaqësohen nga përfaqësuesit e partive përbërëse të koalicionit.
2. Përfaqësuesit e partive parlamentare janë me status të përhershëm pranë KQZ-së. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet, që zhvillon KQZ-ja edhe jashtë periudhës zgjedhore. Përfaqësuesit e partive të tjera e fitojnë këtë status nga çasti i regjistrimit si subjekt zgjedhor pranë KQZ-së dhe e ushtrojnë atë deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Autorizimi për përfaqësim jepet nga kryetari i partisë.
3. Përfaqësuesit në KQZ, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të votojnë. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e KQZ-së, të diskutojnë dhe të paraqesin propozime e kërkesa, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod dhe në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të KQZ-së, të marrin kopje të akteve të KQZ-së, të kërkojnë informacion rreth të gjitha aspekteve të veprimtarisë së KQZ-së dhe t'i vëzhgojnë ato.
4. Përfaqësuesit janë të detyruar të respektojnë Rregulloren e KQZ-së, si dhe etikën e mbledhjeve dhe të komunikimit.

KREU II

KOMISIONET E ZONAVE ZGJEDHORE (KZZ)

Neni 34[‡]

Përbërja e KZZ-së

1. KZZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) një anëtar propozohet nga partia kryesore e shumicës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia kryesore e opozitës parlamentare, dy anëtarë propozohen përkatësisht nga partia e dytë dhe e tretë e shumicës parlamentare dhe dy anëtarë propozohen përkatësisht nga partia e dytë dhe e tretë e opozitës parlamentare;

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 16)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 17)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 18)

b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZZ-ve nga partia kryesore e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia kryesore e opozitës parlamentare. KZZ-të respektive përcaktohen nga KQZ-ja, sipas kritereve objektive të bazuara në:

- i) përzgjedhjen rastësore; dhe
- ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;
- c) sekretari i KZZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia e cila propozon zëvendëskryetarin e kësaj KZZ-je.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZZ-së zgjidhen nga KQZ-ja me propozim të KZZ-së. Në KZZ-të, ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër, zgjidhet njëri nga anëtarët e KZZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

3. Anëtarët e KZZ-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZZ-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj. Për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së.

4. KZZ-ja ngrihet në përputhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të fundit për Kuvendin jo më herët se 8 muaj dhe jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të votave që ka marrë secila parti në votimin proporcional.

Në rast se dy ose më shumë parti kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit për Kuvendin si koalicion zgjedhor me listë shumemërore të përbashkët, për efekt të ngritjes së KZZ-së, renditja e këtyre partive bëhet mbi bazën e numrit të votave që ato kanë marrë në shkallë vendi në zgjedhjet që i paraprijnë ngritjes së KZZ-së, pavarësisht nga lloji i tyre. Në rast se dy parti kanë marrë të njëjtin numër votash, atëherë renditja përcaktohet duke i dhënë përparësi votave për Kuvendin. Në rast se përsëri nuk është e mundur të bëhet renditja, atëherë hidhet shorti.

5. KQZ-ja emëron anëtarët e KZZ-ve jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 34/1 dhe 34/2 të këtij Kodi.

6. Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZZ-të, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZZ-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

8. Kur vendi i një anëtari të KZZ-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen brenda 30 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda 3 ditëve.

Neni 34/1*

Papajtueshmëritë me Detyrën e Anëtarit dhe të Sekretarit të KZZ-së

Anëtari dhe sekretari i KZZ-së nuk mund të jenë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kryetarë të bashkive ose komunave;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose
- ç) anëtarë ose sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 34/2†

Kushtet për Emërimin e Anëtarit dhe të Sekretarit të KZZ-së

Anëtar dhe sekretar i KZZ-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist;
- c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 35‡

Shkarkimi dhe Lirimi i Anëtarëve dhe i Sekretarit të KZZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

- a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZZ-së;
- b) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- c) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
- ç) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose janë të ndaluar për kryerjen e tij;
- d) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose
- dh) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtarët dhe sekretari i KZZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së edhe kur:

- a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 19*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 19*)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 20*)

b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë; ose

c) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

Neni 36* **Detyrat e KZZ-së**

KZZ-ja përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin në zonën zgjedhore përkatëse dhe kryen këto detyra:

1. Përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve ose të referendumeve në zonë, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja.
2. Emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve, sipas këtij Kodi.
3. Verifikon dokumentacionin e kandidatëve.
4. Regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë.
5. Afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë.
6. Administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja për zgjedhjet në zonë.
7. Garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit.
8. Merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit.
9. Përgatit tabelën e rezultateve të zgjedhjeve në zonë dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 109/7 të këtij Kodi.
10. Shpall rezultatet e zgjedhjeve në zonë, sipas përcaktimeve të nenit 109/7 të këtij Kodi dhe kandidatin fitues në zonë.

Neni 37† **Detyrat e Sekretarit të KZZ-së**

Sekretari i KZZ-së kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZZ-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZZ-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZZ-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZZ-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në protokoll vendimet e KZZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 21*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 22*)

ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;

f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, sipas nenit 93 të këtij Kodi dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse;

gj) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit.

Neni 38*

Mbledhjet dhe Vendimet e KZZ-së

1. Mbledhjet e KZZ-së janë publike.

2. Mbledhjet e KZZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të KZZ-së. Vendimet e KZZ-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

3. Vendimet e KZZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën *pro* ose *kundër*, si dhe arsyetimin përkatës.

4. Vota e anëtarëve që janë në kushtet e konfliktit të interesit, të parashikuar në nenin 35 pika 2 të këtij Kodi dhe nuk janë liruar nga detyra, sipas atij neni, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.

5. Në rast se KZZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Vendimi i KQZ-së zbatohet nga KZZ-ja. Në rast se çështja është dërguar nga kryetari i KZZ-së, ose nga të paktën 2 anëtarë të KZZ-së, KQZ-ja merr vendim në përputhje me nenin 30 pikat 5 dhe 6 të këtij Kodi, ndërsa në rast ankimi nga subjekti i interesuar, KQZ-ja vendos sipas dispozitave të Kreut I të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

Neni 39[†]

I shfuqizuar

KREU III

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR QEVERISJEN VENDORE (KZQV)

Neni 40[‡]

Përbërja e KZQV-së

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 23*)

† Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 24*)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 25*)

1. KZQV-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) një anëtar propozohet nga partia kryesore e shumicës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia kryesore e opozitës parlamentare, dy anëtarë propozohen përkatësisht nga partia e dytë dhe e tretë e shumicës parlamentare dhe dy anëtarë propozohen përkatësisht nga partia e dytë dhe e tretë e opozitës parlamentare;

b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZQV-ve nga partia kryesore e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia kryesore e opozitës parlamentare. KZQV-të respektive përcaktohen nga KQZ-ja, sipas kritereve objektive të bazuara në:

i) përzgjedhjen rastësore; dhe

ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;

c) sekretari i KZQV-së duhet të jetë me arsim të lartë dhe propozohet nga partia e cila propozon zëvendëskryetarin e kësaj KZQV-je.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZQV-së zgjidhen nga KQZ-ja me propozim të KZQV-së. Në KZQV-të, ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZQV-së përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KZQV-së përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

3. Anëtarët e KZQV-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZQV-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj. Për punën e kryer, anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së.

4. KZQV-ja ngrihet në përputhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të fundit për organet e qeverisjes vendore jo më herët se 8 muaj dhe jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZQV, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të përgjithshëm të votave, që ka marrë secila parti në votimin për këshillat në shkallë vendi.

5. KQZ-ja emëron anëtarët e KZQV-ve jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 40/1 dhe 40/2 të këtij Kodi.

6. Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZQV-të, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në këtë nen, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive, që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZQV-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

8. Kur vendi i një anëtari të KZQV-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen brenda 30 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda 3 ditëve.

Neni 40/1*

Papajtueshmëritë me Detyrën e Anëtarit dhe Sekretarit të KZQV-së

Anëtari dhe sekretari i KZQV-së nuk mund të jenë:

- a) deputetë në Kuvend;
- b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose
- ç) anëtarë ose sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 40/2†

Kushtet për Emërimin e Anëtarit dhe Sekretarit të KZQV-së

Anëtar dhe sekretar i KZQV-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit, kur është e mundur, të jetë jurist;
- c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse; dhe
- ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 41‡

Shkarkimi dhe Lirimi i Anëtarëve dhe Sekretarit të KZQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

- a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZQV-së;
- b) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- c) nuk kanë më vendbanimin e tyre në njësinë zgjedhore;
- ç) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose janë të ndaluar për kryerjen e tij;
- d) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZQV-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht;
- dh) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja .

2. Anëtarët dhe sekretari i KZQV-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së edhe kur:

- a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 26)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 26)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 27)

b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë; ose

c) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

Neni 42*

Detyrat e KZQV-së

KZQV-ja përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore brenda territorit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe kryen këto detyra:

1. Përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja.
2. Emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve, sipas këtij Kodi.
3. Verifikon dokumentacionin e kandidatëve.
4. Regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në njësinë zgjedhore.
5. Afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore.
6. Administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja për zgjedhjet në njësinë e qeverisjes vendore.
7. Garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit.
8. Merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit.
9. Përgatit tabelën e rezultateve të zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 109/7 të këtij Kodi.
10. Shpall rezultatet e zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 109/7 të këtij Kodi, lidhur me kandidatin fitues për kryetar të bashkisë ose komunës dhe anëtarët e këshillit të bashkisë ose komunës.

Neni 43[†]

Detyrat e Sekretarit të KZQV-së

Sekretari i KZQV-së kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZQV-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZQV-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZQV-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZQV-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZQV-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve vendimet e KZQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 28*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 29*)

- ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZQV-së dhe të procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;
- f) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të materialeve zgjedhore, sipas nenit 93 të këtij Kodi dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse;
- gj) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit.

Neni 44*

Mbledhjet dhe Vendimet e KZQV-së

1. Mbledhjet e KZQV-së janë publike.
2. Mbledhjet e KZQV-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të KZQV-së. Vendimet e KZQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
3. Vendimet e KZQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën *pro* ose *kundër*, si dhe arsyetimin përkatës.
4. Vota e anëtarëve që janë në kushtet e konfliktit të interesit, të parashikuar në nenin 41 pika 2 të këtij Kodi dhe nuk janë liruar nga detyra, sipas atij neni, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.
5. Në rast se KZQV-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZQV-së ose nga të paktën 2 anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Vendimi i KQZ-së zbatohet nga KZQV-ja. Në rast se çështja është dërguar nga kryetari i KZQV-së ose nga të paktën 2 anëtarë të KZQV-së, KQZ-ja merr vendim në përputhje me nenin 30 pikat 5 dhe 6 të këtij Kodi, ndërsa në rast ankimi nga subjekti i interesuar, KQZ-ja vendos sipas dispozitave të Kreut I të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

KREU IV

KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT (KQV)

Neni 45[†]

Përbërja e KQV-së

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 30*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 31*)

1. Në zgjedhjet për Kuvendin KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 34 të këtij Kodi. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 40 të këtij Kodi.

2. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Propozimet për anëtarë dhe sekretar të KQV-së bëhen jo më vonë se 35 ditë para ditës së zgjedhjeve. KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 45/1 dhe 45/2 të këtij Kodi. Në çdo rast emërimi i tyre bëhet jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KQV-ja ngrihet jo më vonë se 15 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

4. Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KQV-së mbetet vakant, ai plotësohet brenda tri ditëve, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit. Zëvendësimi i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve bëhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i largimit.

5. Zëvendësimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, si rregull, me persona, të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.

Neni 45/1*

Papajtueshmëritë me Detyrën e Anëtarit dhe Sekretarit të KQV-së

Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose
- ç) anëtarë a sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 45/2†

Kushtet për Emërimin e Anëtarit dhe Sekretarit të KQV-së

Anëtar ose sekretar i KQV-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) si rregull ka arsimin e mesëm ose të lartë;
- c) është me vendbanim brenda njësisë zgjedhore përkatëse;
- ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 45/3‡

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 32)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 32)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 32)

Shkarkimi dhe Lirimi i Anëtarëve dhe Sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZZ-së apo, sipas rastit, të KZQV-së kur:

- a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KQV-së;
- b) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- c) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
- ç) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose janë të ndaluar për kryerjen e tij;
- d) nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose
- dh) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZZ-së ose, sipas rastit, të KZQV-së kur:

- a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë; ose
- c) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

Neni 46 Detyrat e KQV-së

1. KQV-të ngrihen dhe funksionojnë për të gjitha llojet e zgjedhjeve.
2. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në këtë Kod dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.*

Neni 47[†] Detyrat e Sekretarit të KQV-së

Sekretari i KQV-së kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KQV-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KQV-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KQV-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KQV-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
- ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KQV-së dhe të procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 33)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 34)

- f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, sipas nenit 93/1 të këtij Kodi, nga KZZ-ja apo, sipas rastit, nga KZQV-ja dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- g) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KQV-së;
- gj) përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në Kutinë e Materialeve të Votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë.

Neni 48*

Mbledhjet dhe Vendimet e KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.
2. Mbledhjet e KQV-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të KQV-së. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
3. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron në vendim votën *pro* ose *kundër*, si dhe arsyetimin përkatës.
4. KQV-ja merr vendim për:
 - a) hapjen e votimit;
 - b) pezullimin e votimit;
 - c) kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit;
 - ç) largimin e forcave të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit;
 - d) largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit, sipas nenit 105 të këtij Kodi;
 - dh) mbylljen e votimit.
5. Në rast se KQV-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZZ-së ose, sipas rastit, KZQV-së nga kryetari ose nga dy anëtarë të KQV-së, apo mund të ankimohet në KZZ ose, sipas rastit, në KZQV nga subjekti i interesuar. Vendimi i KZZ-së apo, sipas rastit, KZQV-së zbatohet nga KQV-ja.

KREU V

KQV TË POSAÇME

Neni 49†

Përbërja dhe Përgjegjësitë e KQV-ve të Posaçme

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 35*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 36*)

KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja krijojnë, në përputhje me këtë Kod dhe udhëzimet e KQZ-së, KQV të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi, si edhe KQV-ja.

PJESA E KATËRT

LISTAT E ZGJEDHËSVE

KREU I

LISTAT E ZGJEDHËSVE, PËRMBAJTJA, HARTIMI DHE MIRATIMI I TYRE

Neni 50*

Regjistrimi i Zgjedhësve në Listat e Zgjedhësve

1. Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi. Lista e zgjedhësve përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin në zonën e qendrës së votimit të njësisë së qeverisjes vendore, mbështetur në të dhënat e regjistrit themeltar të shtetasve dhe të regjistrit të përkohshëm të shtetasve të peregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit, të hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 15 pika 6 të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004 "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore", si dhe zgjedhësit, sipas neneve 63, 64 dhe 64/1 të këtij Kodi.

2. Zgjedhësi regjistrohet vetëm në një listë zgjedhësish. Përfshirja në listën e zgjedhësve për shkak të qenies në regjistrin e përkohshëm të shtetasve të peregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit ose si zgjedhës, sipas neneve 63, 64 dhe 64/1 të këtij Kodi, sjell si pasojë heqjen e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve që hartohet në bazë të regjistrit themeltar të shtetasve.

Neni 51[†]

Përmbajtja e Listës së Zgjedhësve

1. Në listën e zgjedhësve shënohet njësia e qeverisjes vendore që ka hartuar dhe miratuar listën e zgjedhësve, numri ose emri i njësisë zgjedhore, lloji dhe data e zgjedhjeve ose e referendumeve, si dhe numri i qendrës së votimit.

2. Në listën e zgjedhësve, për çdo zgjedhës, shënohen: numri rendor në listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, adresa shifrore zgjedhore, emri, atësia, mbiemri dhe datëlindja. Renditja në listën e zgjedhësve bëhet sipas mbiemrit.

Neni 52[‡]

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 37*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 38*)

[‡] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 39*)

Organi që Harton dhe Miraton Listat

1. Listat e zgjedhësve hartohen dhe miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përgjigjet për hartimin dhe saktësinë e të dhënave të listave dhe i firmos ato, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

3. Ndryshimet në listat e zgjedhësve bëhen vetëm me miratimin e kryetarit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

Neni 53*

Përbërësit Zgjedhorë të Regjistrit Themeltar të Shtetasve dhe Administrimi i tyre

1. Emri, atësia, mbiemri, datëlindja, shtetësia shqiptare dhe numri i zonës së qendrës të votimit formojnë përbërësit zgjedhorë të regjistrit themeltar. Sistemet e administrimit të regjistrit themeltar duhet të kryejnë përditësimin automatik të përbërësve zgjedhorë sa herë që ndryshojnë përbërësit e regjistrit themeltar, si dhe nxjerrjen e tyre nga baza e të dhënave në çdo kohë.

2. Regjistri i përkohshëm i shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit, sipas nenit 15 pika 6 të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004 "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore", ka të njëjtët përbërës zgjedhorë si regjistri themeltar.

3. Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nxjerr akte nënligjore lidhur me administrimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë në regjistrin themeltar të shtetasve dhe regjistrin e përkohshëm të shtetasve.

Neni 54[†]

I shfuqizuar

KREU II[‡]

PROCESI I PËRGATITJES SË LISTËS SË ZGJEDHËSVE DHE KRIJIMIT TË ZONAVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT

Neni 55

Përgatitja e Listave Paraprake të Zgjedhësve

Lista paraprake e zgjedhësve përgatitet si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, jo më vonë se nëntë muaj para mbarimit të mandatit të organeve për të

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 40*)

† Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 41*)

‡ Titulli i këtij Kreu dhe neni 55 janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 42*)

cilat zhvillohen zgjedhjet, u dërgon kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore listat e zgjedhësve të përditësuara, sipas zonave të qendrave të votimit të përfshira në njësitë përkatëse, të nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

2. Brenda dy muajve nga çasti i marrjes së listës, zyrat e gjendjes civile, nën autoritetin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe në zbatim të udhëzimeve të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, mbështetur në regjistrat themeltarë të gjendjes civile të njësisë përkatëse, kryejnë përditësimin e listës si më poshtë:

a) regjistrojnë të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës së zgjedhjeve të fundit, duke përfshirë edhe ata që mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e fundit për zhvillimin e zgjedhjeve;

b) evidentojnë dhe çregjistrojnë zgjedhësit, që nuk figurojnë më në regjistrin themeltar të zyrave të gjendjes civile, për arsye se kanë vdekur ose kanë lënë shtetësinë shqiptare pas zgjedhjeve të fundit;

c) kontrollojnë të dhënat për zgjedhësit e tjerë, duke bërë korrigjimet e nevojshme.

3. Brenda 30 ditëve nga përditësimi i listave të zgjedhësve, sipas pikës 2 të këtij neni, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën ndarjen e zgjedhësve, sipas zonave të qendrave të votimit të zgjedhjeve të fundit dhe u cakton atyre numrin e qendrave përkatëse të votimit. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit, përgatit hartën e njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur edhe kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe e shpall atë në mjedise publike, me hyrje të lirë, brenda njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë përkatëse mban të pandryshuar vendndodhjen dhe adresën ekzistuese të qendrave të votimit, me përjashtim të rastit kur kjo është e pamundur. Ai nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 10 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveçse në rastet e forcave madhore.

4. Listat paraprake shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se gjashtë muaj përpara datës së përfundimit të mandatit të organit për të cilin zhvillohen zgjedhjet, pranë zyrave të njësisë përkatëse dhe çdo qendre votimi, duke u vendosur në mjedise publike me hyrje të lirë për shtetasit. Një kopje e këtyre listave u dërgohet zyrave të gjendjes civile përkatëse, të cilat përditësojnë në regjistrin themeltar të gjendjes civile numrin e zonës së qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Një kopje e tyre i dërgohet në format elektronik Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Kjo kopje duhet të përmbajë, për të gjithë emrat e përfshirë nga regjistri i përkohshëm i shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit edhe shënimin, që sqaron burimin e regjistrimit.

Neni 56*

Njoftimi me Shkrim i Zgjedhësve

1. Brenda 30 ditëve nga shpallja e listave paraprake të zgjedhësve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në listat paraprake të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Lajmërimi me shkrim përmban qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 43)

3. Për kryerjen e njoftimit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngarkon administratorët e lagjeve ose, sipas rastit, kryetarët e fshatrave që përfshihen në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe, nëse është e nevojshme, edhe persona të tjerë nga administrata e njësisë së qeverisjes vendore.

4. Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtar i madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit.

Neni 57*

Shkaqet për Ndryshime në Listat Paraprake

1. Listat paraprake ndryshohen në rastet kur një zgjedhës:
 - a) vdes;
 - b) ka humbur të drejtën për të zgjedhur;
 - c) është regjistruar në më shumë se një listë;
 - ç) ka transferuar gjendjen civile ose ka bërë kërkesë për transferimin e saj, në përputhje me ligjin nr.9296, datë 21.10.2004 “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”;
 - d) provon se të dhënat e tij vetjake nuk janë të sakta;
 - dh) është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit;
 - e) nuk është në listën paraprake të asnjë qendre votimi;
 - ë) nuk përmbush kriterin e moshës për të qenë zgjedhës në datën e zgjedhjeve;ose
 - f) nuk përmbush kriterin e shtetësisë.
2. Lista paraprake e zgjedhësve ndryshohet edhe për shkaqet e procedurat e parashikuara në nenet 63, 64 dhe 64/1 të këtij Kodi.

Neni 58†

Procedura e Rishikimit dhe e Ndryshimit të Listave Paraprake

1. Me përjashtim të kërkesave për ndryshime në listën paraprake të zgjedhësve që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kërkesat për ndryshime në listën paraprake të zgjedhësve nuk mund të paraqiten më vonë se katër muaj përpara mbarimit të mandatit.
2. Kërkesa për ndryshime në listën paraprake bëhet nga vetë zgjedhësi ose, në mungesë të tij, nga një pjesëtar i trungut të tij familjar, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikat 1/a dhe 1/b të nenit 57 të këtij Kodi, kur kërkesa mund paraqitet nga çdo person i tretë. Në rastin e shkronjave “ç”, “ë” dhe “f” të nenit 57 të këtij Kodi ndryshimi në listën paraprake të zgjedhësve bëhet edhe nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, kryesisht mbi bazën e informacionit të marrë nga zyra e gjendjes civile.
3. Kërkesa për ndryshimin e listës paraprake i paraqitet me shkrim kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe përmban:

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 44)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 45)

- a) emrin e plotë të subjektit kërkues dhe adresën e tij;
- b) shkakun për të cilin kërkohet ndryshimi në listë; dhe
- c) dokumentet që provojnë shkakun për të cilin kërkohet ndryshimi.

4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos për kërkesën brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj. Vendimi hartohet në jo më pak se tri kopje, nga të cilat njëra i dërgohet kërkuesit jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes së vendimit, njëra Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në përfundim të periudhës së rishikimit dhe kopja e tretë ruhet pranë organit vendimmarrës.

5. Kundër vendimit të kryetarit të bashkisë, komunës ose njësisë bashkiake ose në rastin kur ai nuk merr vendim, mund të bëhet ankim nga kërkuesi në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet njësia e qeverisjes vendore jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijani për vendimin ose nga kalimi i afatit për marrjen e vendimit.

6. Gjykata shqyrton çështjen dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesëpadisë. Në rast se paditësi ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk paraqitet në gjykim, gjykata pushon gjykimin. Në rast se i padituri nuk paraqitet në gjykim, gjykimi zhvillohet në mungesë. Gjykata duhet t'i njoftojë vendimin palës në mungesë, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, brenda 24 orëve nga data e shpalljes së vendimit. Kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore është i detyruar të zbatojë vendimin e gjykatës brenda 5 ditëve nga marrja dijani, pa qenë nevoja që paditësi të kërkojë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Në çdo rast, gjykata duhet të vërë në dispozicion të palëve vendimin e saj të arsyetuar me shkrim në të njëjtën datë me shpalljen e vendimit.

Neni 58/1*

Ndryshimi në Listën Paraprake me Kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Ndryshimet në listën paraprake, sipas nenit 57 të këtij Kodi, bëhen me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në rastet kur:

a) në bazë të verifikimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile rezulton se të njëjtët zgjedhës janë përfshirë si në listën e zgjedhësve, për shkak të qenies në regjistrin e përkohshëm, ashtu dhe në listën e zgjedhësve, që hartohet në bazë të regjistrin themeltar të shtetasve. Në këtë rast, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, në regjistrin themeltar të të cilit është regjistruar zgjedhësi, ta heqë atë nga lista e zgjedhësve;

b) zgjedhësit janë përfshirë në listat e zgjedhësve të institucioneve të posaçme dhe, në përputhje me nenin 63 të këtij Kodi, është kërkuar heqja e tyre nga lista e zgjedhësve të vendbanimit;

c) zgjedhësit janë përfshirë në listat e zgjedhësve në repartet e Forcave të Armatosura dhe Forcat e Rendit dhe, në përputhje me nenin 64 të këtij Kodi, është kërkuar heqja e tyre nga lista e zgjedhësve të vendbanimit;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 46)

ç) zgjedhësit janë përfshirë në listat e zgjedhësve si studentë dhe, në përputhje me nenin 64/1 të këtij Kodi, është kërkuar heqja e tyre nga lista e zgjedhësve të vendbanimit.

Neni 59*

Përgatitja e Listës Përfundimtare të Zgjedhësve

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, pasi pasqyron vendimet administrative dhe të gjykatave për ndryshime në listën paraprake, pasi heq nga lista paraprake personat e vdekur dhe personat që nuk mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zgjedhjeve, si dhe zgjedhësit që kanë lënë shtetësinë shqiptare, miraton listën përfundimtare të zgjedhësve për çdo qendër votimi.

2. Lista përfundimtare e zgjedhësve i dërgohet e printuar, jo më vonë se 25 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KZZ-së ose, sipas rastit, KZQV-së në tre formate, si më poshtë:

a) listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit për t'u shpallur pranë çdo qendre votimi në një vend publik me hyrje të lirë, jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Një kopje tjetër e kësaj liste i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të procesit zgjedhor, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon një kopje të printuar të të gjitha listave të zgjedhësve Arkivit Qendror të Shtetit për ruajtje;

b) listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit, e cila i dorëzohet KQV-së përkatëse bashkë me materialet e tjera të votimit nga KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja për t'u përdorur nga kjo e fundit në datën e zgjedhjeve. Ky format përmban edhe vendin për nënshkrimin e zgjedhësit, si dhe vendin e vendosjes së numrit të serisë së dokumentit të identifikimit;

c) listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore ose, sipas rastit, njësie të qeverisjes vendore, e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit të zgjedhësve. Ky format mbahet nga KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja dhe shërben për informim të zgjedhësve. Për zgjedhjet për pushtetin vendor për Bashkinë e Tiranës, kryetarët e njësive bashkiake i dërgojnë një kopje të listës në nivel njësie bashkiake edhe KZQV-së së Bashkisë së Tiranës.

Neni 60[†]

Ndryshimi i Listës pas Shpalljes së Listës Përfundimtare

1. Kur zgjedhësi vëren se nuk është i regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij, ai ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit. Vendimi që pranon

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 47)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 48)

kërkesën përmban lejimin e kërkuarit për të votuar në zgjedhjet përkatëse, si dhe numrin e qendrës së votimit ku lejohet të votojë zgjedhësi që ka paraqitur kërkesën.

3. Emri i zgjedhësit që paraqitet për të votuar me vendim gjykate shënohet nga KQV-ja në një regjistër të posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi i gjykatës dhe një certifikatë personale e zgjedhësit me fotografi, e lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Neni 60/1*

Zgjedhjet e Pjesshme ose të Parakohshme

1. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile u dërgon listat e zgjedhësve zyrove të gjendjes civile për përditësim, sipas përcaktimeve të nenit 55 të këtij Kodi, jo më vonë se pesë ditë nga nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Në burgjet dhe vendet e paraburgimit, në repartet e Forcave të Armatosura dhe të Rendit dhe në institucionet arsimore, listat e zgjedhësve përgatiten dhe u dërgohen kryetarëve të njësive përkatëse të qeverisjes vendore brenda 10 ditëve nga nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

2. Zyrat e gjendjes civile kryejnë përditësimin e listave të zgjedhësve brenda 10 ditëve nga marrja e tyre. Brenda 24 orëve nga përfundimi i përditësimit, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore miratojnë dhe shpallin listat përfundimtare të zgjedhësve, në përputhje me nenin 59 të këtij Kodi.

3. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve, i parashikuar nga neni 56 i këtij Kodi, organizohet dhe kryhet pas shpalljes së listës përfundimtare, por jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjeve.

4. Ndryshimet në listën përfundimtare bëhen në përputhje me nenin 60 të këtij Kodi.

Neni 61†

Vënia e Listave të Zgjedhësve në Dispozicion të Subjekteve Zgjedhore

1. Listat e zgjedhësve vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

2. Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një kopje të listave të zgjedhësve në shkallë vendi.

3. Subjekteve të mësipërme zgjedhore u vihen në dispozicion listat e zgjedhësve jo më vonë se 3 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

4. Në rast se subjektet zgjedhore kërkojnë më shumë se një kopje të listave të zgjedhësve, ato vihen në dispozicion kundrejt pagesës. Në këtë rast, pagesat për listat e zgjedhësve duhet të mbulojnë vetëm shpenzimet administrative të riprodhimit të tyre.

Neni 62*

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 49)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 50)

Zgjedhësit e Veçantë

Anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve votojnë në qendrën e votimit ku janë caktuar komisionerë, pavarësisht nëse e kanë ose jo emrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Kur nuk e kanë emrin në listë, emri i tyre shënohet në regjistrin e posaçëm që mbahet sipas nenit 60 pika 3 të këtij Kodi.

Neni 63[†]

Institucionet e Posaçme

1. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet edhe kur në to ndodhen nga 15 deri në 100 zgjedhës.

2. Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet e përgjithshme, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore në territorin e së cilës ndodhet institucioni i posaçëm.

3. Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e listës, sipas pikës 2 ose 3 të këtij neni, përfshin emrat e zgjedhësve të burgjeve dhe të vendeve të paraburgimit në listën e zgjedhësve të njësisë së tij dhe ia dërgon ato Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila, brenda 5 ditëve nga marrja e tyre, njofton njësitë përkatëse të qeverisjes vendore të vendbanimit të këtyre zgjedhësve t'i heqin ata nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre.

5. Në spitalet dhe në institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë, procedurat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni kryhen dy javë përpara datës së zgjedhjeve.

Neni 64[‡]

Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit

1. Jo më vonë se katër muaj para mbarimit të mandatit për Kuvendin, Ministri i Mbrojtjes dhe institucionet e tjera qendrore kompetente, me kërkesë të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, urdhërojnë komandantët e reparteve përkatëse të përgatisin listën e zgjedhësve që do të ndodhen në ato reparte në periudhën nga 60 deri në 30 ditë nga data e përfundimit të mandatit të Kuvendit. Komandantët e reparteve duhet të specifikojnë praninë e zgjedhësve në repartet përkatëse, sipas ditëve të diela që përfshihen në periudhën e mësipërme, si dhe njësinë e qeverisjes vendore ku zgjedhësit kanë vendbanimin. Lista i dërgohet jo më vonë se 15 ditë nga marrja e urdhrin, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet reparti.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 51)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 52)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 53)

2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i përfshin këta zgjedhës në listën përfundimtare të qendrës së votimit, në territorin e së cilës ndodhet reparti. Renditja e tyre në listë bëhet mbi bazën e rregullave të përgjithshme për hartimin e listës së zgjedhësve.

3. Brenda 5 ditëve nga marrja e listës nga komandanti i repartit përkatës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i dërgon një kopje të listës Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila jo më vonë se pesë ditë nga marrja e listës, u kërkon njërive përkatëse të qeverisjes vendore të vendbanimit të këtyre zgjedhësve t'i heqin ata nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, në përputhje me procedurat dhe afatin e caktuar nga KQZ-ja.

Neni 64/1* **Studentët**

1. Studentët kanë të drejtë të votojnë në vendqëndrimin e tyre. Kërkesa për t'u regjistruar sipas vendqëndrimit dorëzohet në dekanatin e fakultetit ku studenti është i regjistruar.

2. Jo më vonë se 5 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me kërkesë të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, u kërkon rektorateve të universiteteve të përgatisin listën e zgjedhësve që duan të votojnë sipas vendqëndrimit të tyre dhe që ndodhen aty në periudhën nga 60 deri në 30 ditë nga data e përfundimit të mandatit të Kuvendit. Rektorët njoftojnë jo më vonë se 5 ditë nga marrja e kërkesës, dekanatet e fakulteteve nën juridiksionin e tyre, të cilët shpallin menjëherë fillimin e procedurave të regjistrimit në listë.

3. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, dekanët dorëzojnë në rektoratin përkatës listën e studentëve që kanë bërë kërkesë për të votuar me vendqëndrim. Në listën e përgatitur nga dekanati përfshihen vetëm studentët e regjistruar pranë fakultetit përkatës. Dekanët duhet të specifikojnë njësinë e qeverisjes vendore ku zgjedhësit kanë vendbanimin.

4. Rektori ia dërgon listën, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e saj, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet universiteti.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i përfshin këta zgjedhës në listën përfundimtare të qendrës së votimit të caktuar për këtë rast. Renditja e tyre në listë bëhet mbi bazën e rregullave të përgjithshme për hartimin e listës së zgjedhësve.

6. Brenda 5 ditëve nga marrja e listës nga rektori i universitetit përkatës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i dërgon një kopje të listës Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e listës, u kërkon njërive përkatëse të qeverisjes vendore të vendbanimit të këtyre zgjedhësve t'i heqin ata nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, në përputhje me procedurat e caktuara nga KQZ-ja.

Neni 64/2†

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 54*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 54*)

Dispozitë Kalimtare për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005

1. Brenda 15 ditëve nga përfundimi i procesit të identifikimit dhe regjistrimit të shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004 “Për verifikimin, identifikimin, dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”, zyrat e gjendjes civile u dërgojnë kryetarëve të njësive përkatëse të qeverisjes vendore listat e zgjedhësve të përditësuar.

2. Procesi i përgatitjes së listës së zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005 fillon jo më vonë se data 15 mars 2005, me veprimet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 55 të këtij Kodi dhe nenet në vijim. Lista paraprake shpallet jo më vonë se data 31 mars 2005.

3. Jo më vonë se data 15 mars 2005 kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton me shkrim kryetarët e njësive të qeverisjes vendore përkatëse për zgjedhësit e përfshirë në listat e zgjedhësve të njësisë së tij me burim regjistrin e përkohshëm të shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit dhe u kërkon atyre heqjen e këtyre zgjedhësve nga listat e zgjedhësve të njësive të tyre vendore.

Neni 64/3*

Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në nenet 52, 55, 56, 58, 61, 63, 64, 64/1 dhe 64/2 të këtij Kodi, për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake.”

PJESA E PESTË

SISTEMI I ZGJEDHJEVE

KREU I

SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Neni 65

Përbërja e Kuvendit

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhësit në zonat zgjedhore njëemërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara nga listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore të depozituara në KQZ.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 54)

Neni 66

Zgjedhja e Deputetit në Zonat Njëmërore

1. Quhet i zgjedhur deputet në Kuvend në zonën njëmërore kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim në atë zonë.

2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet kandidatëve përkatës organizohet hedhja e shortit. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit.

Neni 67

Ndarja e Mandateve Plotësuese

Dyzet mandatet plotësuese ndahen midis partive dhe koalicioneve të partive në përputhje me rezultatin e dalë vetëm nga votimi i zhvilluar në datën e zgjedhjeve dhe sipas rregullave të mëposhtme:

a) partitë që fitojnë më pak se 2,5 për qind dhe koalicionet e partive që fitojnë më pak se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin nuk përfitojnë nga mandatet plotësuese. Për të përcaktuar përqindjen e koalicionit që paraqet listë të përbërë, totali i numrit të votave të vlefshme të koalicionit formohet duke mbledhur votat që ka marrë veçmas secila parti ose koalicion në pjesën e votimit proporcional të fletës së votimit;

b) numri i votave të vlefshme të fituara nga çdo parti ose koalicion, që kalon pragun përkatës, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në shkallë vendi dhe rezultati shumëzohet me 140. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve i caktohet fillimisht një numër i përgjithshëm mandatesh, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, mandati caktohet me short;

c) për të përcaktuar numrin e mandateve plotësuese, që përfiton çdo parti ose koalicion, nga numri i mandateve të caktuara sipas shkronjës "b" të këtij neni, zbritet numri i mandateve të fituara nga çdo parti ose koalicion në zonat njëmërore. Në rast se diferenca është negative ose zero, partia ose koalicioni përkatës mban vetëm mandatet e fituara në zonat njëmërore;

ç) pavarësisht nga shkronja "b", në rast se:

i) në një ose më shumë zona njëmërore fitojnë kandidatët e pavarur;

ii) në një ose më shumë zona njëmërore fitojnë kandidatët e partive ose të koalicioneve që nuk e kalojnë pragun përkatës; ose

iii) partitë ose koalicionet që kalojnë pragun përkatës fitojnë më shumë mandate në zonat njëmërore sesa do t'u takonin në bazë të shkronjës "b";

ndarja e mandateve plotësuese mes partive dhe koalicioneve, për të cilat diferenca e parashikuar në shkronjën "c" është pozitive, bëhet në bazë të formulës së mëposhtme:

$$N = (A - B) [40 / (40 + C)],$$
 ku N është numri i mandateve plotësuese që përfiton partia ose koalicioni; A është numri i mandateve që i caktohet partisë ose koalicionit sipas shkronjës "b"; B është numri i mandateve të fituara prej tyre në zonat njëmërore

dhe C është shuma e mandateve të fituara, sipas pikave “i”, “ii” dhe “iii” të kësaj shkronje (në rastin e pikës “iii”, mbliidhet vetëm teprica). Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve i caktohet fillimisht një numër mandatesh plotësuese, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short;

d) deputetët zgjidhen nga listat shumemërore të partive ose koalicioneve, sipas renditjes në to;

dh) në rast se numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie politike ose koalicioni është më i vogël se numri i vendeve që i takojnë asaj partie ose koalicioni, sipas këtij neni, vendet e paplotësuara ndahen midis partive dhe koalicioneve të tjera të partive që kalojnë pragun përkatës, në përputhje me formulën e mëposhtme:

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga secila nga partitë ose koalicionet e mësipërme, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve të paplotësuara. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve fillimisht i caktohet një numër vendesh shtesë i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Vendet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetje dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për vendin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

Neni 68

Ndarja e Mandateve Plotësuese Partive të Koalicionit me Listë Shumemërore të Përbërë

Pasi llogaritet, sipas nenit 67 të këtij Kodi, numri i mandateve plotësuese që fiton koalicioni me listë shumemërore të përbërë, ndarja e mandateve plotësuese për çdo parti pjesëmarrëse në koalicion bëhet si më poshtë:

a) numri i votave të vlefshme të partive pjesëmarrëse në koalicion pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara në shkallë vendi nga partitë dhe koalicionet që kalojnë pragun përkatës dhe rezultati shumëzohet me 140. Rezultati shumëzohet me raportin e numrit të mandateve të fituara, sipas llogaritjes së parashikuar në nenin 67 nga koalicioni, me numrin e mandateve që mund të fitonte koalicioni, sipas llogaritjes së parashikuar në nenin 67 pika 1 shkronja “b”. Secilës nga partitë pjesëmarrëse në koalicion i caktohet fillimisht një numër i përgjithshëm mandatesh i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten, deri në numrin e mandateve të fituara nga koalicioni, u caktohen partive pjesëmarrëse me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short;

b) për të caktuar numrin e mandateve plotësuese të fituara nga çdo parti e koalicionit, nga numri i mandateve të fituara, sipas shkronjës “a” të këtij neni, zbritet numri i mandateve të fituara nga secila prej këtyre partive në zonat njëemërore. Në rast se diferenca është negative ose zero, partia përkatëse nuk fiton nga ndarja e mandateve plotësuese;

* Titulli dhe paragrafi i parë i këtij neni janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 55)

c) kur një ose më shumë parti kanë fituar më shumë mandate në zonat njëmërore sesa do t'u takonin në bazë të shkronjës "a", ndarja e mandateve plotësuese për partitë e koalicionit, për të cilat diferenca e parashikuar në shkronjën "b" është pozitive, bëhet sipas formulës:

$N = (A - B) K / D$; ku:

N është numri i mandateve plotësuese që përfiton partia; A është numri i mandateve që i caktohen partisë sipas shkronjës "a"; B është numri i mandateve të fituara prej tyre në zonat njëmërore; K është numri i mandateve plotësuese që përfiton koalicioni sipas nenit 67; D është shuma e diferencave pozitive të llogaritura sipas shkronjës "b";

ç) secilës prej këtyre partive i caktohet fillimisht një numër mandatesh plotësuese i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten, deri në plotësimin e numrit të mandateve të fituara nga koalicioni, gjatë ndarjes së mandateve plotësuese, u caktohen këtyre partive me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

KREU II

ZONAT ZGJEDHORE

Neni 69

Zonat Zgjedhore Njëmërore

1. Për efekt të zgjedhjeve për Kuvendin, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në 100 zona zgjedhore njëmërore me numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish.*

2. Kufijtë e zonave zgjedhore nuk mund të ndryshohen gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit.

Neni 70

I shfuqizuar

Neni 71

I shfuqizuar

Neni 72

I shfuqizuar

Neni 73

I shfuqizuar

Neni 74

I shfuqizuar

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 56)

Neni 75
I shfuqizuar*

KREU III

SISTEMI I ZGJEDHJEVE VENDORE

Neni 76
Sistemi i Zgjedhjeve Vendore

1. Kryetarët e bashkive ose të komunave, si dhe anëtarët e këshillave të bashkive ose komunave zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës.

2. Anëtarët e këshillave të bashkisë dhe të komunave zgjidhen në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike dhe koalicionet, si dhe në bazë të kandidatave të pavarura individuale.

3. Partitë politike të regjistruara në KQZ kanë të drejtë të paraqesin kandidatë të përbashkët për kryetar bashkie ose komune, si dhe lista të përbashkëta shumemërore për këshillat vendorë.

Neni 77
Zgjedhja e Organeve të Qeverisjes Vendore

1. Kryetar bashkie ose komune zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet kandidatëve përkatës hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike me pjesëmarrjen dhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit.

3. Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KZQV-ja në bazë të sistemit proporcional të mëposhtëm:

a) numri i votave të vlefshme, të fituara nga çdo kandidat i pavarur, pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme dhe shumëzohet me numrin e vendeve në këshill. Në rast se rezultati është 1 ose më i madh se 1, kandidati i pavarur fiton një vend në këshill;

b) numri i votave të vlefshme, të fituara nga çdo parti ose koalicion, si dhe nga çdo kandidat i pavarur që nuk ka fituar një vend në këshill, sipas shkronjës "a" të kësaj pike të këtij neni, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve që mbeten pasi zbatohet shkronja "a" e kësaj pike. Secili prej këtyre subjekteve zgjedhore përfiton një numër vendesh të barabartë me numrin e plotë që rezulton nga llogaritja e mësipërme. Në rast se për kandidatin e pavarur rezultati është 1 ose më i madh se 1, kandidati i pavarur fiton vetëm 1 vend. Vendet që mbeten u jepen subjekteve zgjedhore me mbetjet dhjetore më

* Nenet 70, 71, 72, 73, 74 dhe 75 janë shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 57)

të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short;

c) kandidatët e partive ose të koalicioneve zgjidhen në këshillat vendorë sipas radhës në listat shumemërore përkatëse;

ç) në rast se numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie ose koalicioni është më i vogël se numri i vendeve që i takojnë asaj partie ose koalicioni sipas këtij neni, vendet e paplotësuara ndahen midis partive dhe koalicioneve të tjera të partive që kanë paraqitur listë shumemërore, në përputhje me formulën e mëposhtme:

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga secila nga partitë ose koalicionet e mësipërme pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve të paplotësuara. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve fillimisht i caktohet një numër vendesh shtesë, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Vendet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetje dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për vendin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

PJESA E GJASHTË

PARAQITJA E KANDIDATËVE

KREU I

KANDIDATËT PËR TË CILËT VOTOHET DREJTPËRDREJT

Nenin 78

Paraqitja e Dokumentacionit të Kandidatit

1. Dokumentacioni për paraqitjen e kandidatëve për deputet, kryetar bashkie ose komune apo për këshillin e bashkisë ose të komunës, dorëzohet përkatësisht në KZZ ose, sipas rastit, në KZQV jo më vonë se 32 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Komisionet përkatëse verifikojnë saktësinë e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Nëse komisionet vërejnë mospërputhje ose parregullsi në dokumentacionin e kandidimit përpara mbarimit të afatit të vërtetimit të tyre, sipas pikës 1 të këtij neni, komisioni i jep kandidatit mundësinë për t'i korrigjuar mospërputhjet ose parregullsitë, duke përcaktuar afatin për riparaqitjen e dokumentacionit, por jo më vonë se 28 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Komisionet përkatëse marrin vendim brenda 24 orëve për pranimin ose mospranimin e dokumentacionit të riparaqitur.

3. Jo më vonë se 4 muaj përpara përfundimit të mandatit të Kuvendit ose, sipas rastit, të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, KQZ-ja lëshon dokumentacionin e kandidimit, së bashku me formularët për mbledhjen e firmave, në përputhje me nenet 80 dhe 81 të këtij Kodi.

Neni 79

Kërkesat për Vlefshmërinë e Dokumenteve të Kandidimit

1. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.

2. Dokumentet e kandidimit duhet të përmbajnë këto të dhëna:

a) emrin, atësinë, mbiemrin datëlindjen dhe adresën e kandidatit;

b) deklarin e kandidatit që ai gëzon të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar për në organin për të cilin konkurron;

c) emrin dhe adresën e një personi të emëruar si përfaqësuesi zyrtar i tij, i cili duhet të gëzojë të drejtën e votës;

ç) një listë të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidaturën e tij, sipas nenit 80 të këtij Kodi;

d) një deklaratë nga partia dhe/ose koalicioni që mbështet kandidatin, të nënshkruar nga kryetari i partisë, sipas përcaktimit të neneve 15 dhe 16 të këtij Kodi, përveç rastit të kandidatëve të pavarur. Në rast se koalicioni përbëhet nga parti që kanë vendosur të paraqiten veçmas në fletën e votimit, përveç koalicionit duhet të deklarohet edhe emri i partisë së koalicionit që paraqet kandidatin.

Neni 80

Lista e Zgjedhësve që Mbështesin Kandidatin për Zgjedhjet për në Kuvend

1. Për kandidatët për deputetë, dokumentet e kandidimit shoqërohen me një listë me nënshkrimet e 300 zgjedhësve që banojnë në atë zonë, emrat e të cilëve janë në listat paraprake të zgjedhësve të asaj zone zgjedhore.

2. Kandidatët e partive politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nëse një anëtar i partisë përkatëse zotëron të paktën një mandat në Kuvend. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga personi i zgjedhur, ku të deklarohet se ai është anëtar i partisë politike.

3. Kandidatët e pavarur përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nëse zotërojnë mandate në Kuvend.

Neni 81

Lista e Zgjedhësve që Mbështesin Kandidatin në Zgjedhjet Vendore

1. Për kandidatët për kryetar bashkie ose komune, dokumentet e kandidimit shoqërohen me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për njësitë zgjedhore deri në 5 000 zgjedhës një listë me nënshkrimet e 50 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve;

b) për njësitë zgjedhore nga 5 000 deri në 30 000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet e 100 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve;

c) për njësitë zgjedhore me më shumë se 30 000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet e 300 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve.

2. Listat shumemërore të kandidatëve të partive politike për këshillat e bashkive ose komunave, përveç dokumenteve të kandidimit të parashikuar në nenin 79 pika 2 shkronjat "a" dhe "b" të këtij Kodi, për çdo kandidat të listës, duhet të mbështeten nga:

a) për njësitë zgjedhore deri në 5 000 zgjedhës një listë me nënshkrimet e 50 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve;

b) për njësitë zgjedhore nga 5 000 deri në 30 000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet e 100 zgjedhësve;

c) për njësitë zgjedhore me më shumë se 30 000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet e 300 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve.

3. Kandidatët e partive politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga personi i zgjedhur, ku të deklarohet se ai është anëtar i partisë politike.

4. Kandidatët e pavaruar përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nëse janë kryetarë bashkie a komune ose zotërojnë mandate në Kuvend a në këshill.

5. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet deklaratë me shkrim të nënshkruar nga personi i zgjedhur, ku të deklarohet se ai është anëtar i partisë politike.

Neni 82

Zëvendësimi i Kandidatit

1. Kandidati mund ta tërheqë kandidaturën brenda 24 orëve nga verifikimi i bërë nga komisioni. Kandidati, që tërhiqet pas vërtetimit të bërë nga komisioni, nuk mund të zëvendësohet nga partia politike që ai përfaqëson.

2. Në rast se kandidati i regjistruar vdes përpara datës së zgjedhjeve, atëherë zgjedhjet në atë zonë shtyhen për katër javë. Në këtë rast KQZ-ja cakton një datë tjetër për paraqitjen e kandidaturës zëvendësuese.

3. Menjëherë pas mbarimit të afatit për tërheqjen e kandidaturës, komisioni përkatës i zgjedhjeve kryen këto veprime:

a) dërgon në KQZ një listë përfundimtare të kandidatëve të verifikuar;

b) publikon në gazeta, postera dhe mediat elektronike brenda juridiksionit të njësisë zgjedhore emrat dhe përkatësinë partiake të të gjithë kandidatëve, sipas renditjes së tyre në fletën e votimit dhe sipas mënyrës dhe në kohën e caktuar nga KQZ-ja.

4. Në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin ose për kryetar bashkie a komune, KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja publikon emrin dhe adresën e përfaqësuesit zyrtar të kandidatit.

Neni 83

I shfuqizuar*

KREU II

* Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 57)

LISTAT SHUMEMËRORE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT

Neni 84

Paraqitja e Listave

1. Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore paraqesin në KQZ një listë kandidatësh për 40 vende në Kuvend, brenda afatit të parashikuar në nenin 78 të këtij Kodi. Kjo listë duhet të mbështetet nga firmat e 7000 votuesve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi për firmat, i parashikuar nga ky nen i Kodit, nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet të paktën një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga personi i zgjedhur, ku të deklarohet se është anëtar i partisë politike.

2. Koalicionet e partive politike të regjistruara në KQZ mund të paraqesin listë shumemërore të kandidatëve. Kur koalicioni përbëhet nga parti që kanë vendosur të paraqiten veçmas në fletën e votimit, ai paraqet listë shumemërore të përbërë, e cila formohet nga listat e veçanta të partive përbërëse të koalicionit, ndërsa kur koalicioni paraqitet si një subjekt i vetëm, ai paraqet listë shumemërore të përbashkët. Lista duhet të mbështetet nga firmat e 10 000 votuesve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve. Koalicioni përjashtohet nga detyrimi për firmat, i parashikuar nga ky nen i Kodit, nëse partitë anëtare të tij zotërojnë së bashku mandate në Kuvend në numër jo më të vogël sesa numri i partive anëtare. Për qëllim të këtij Kodi, koalicioni paraqet deklarata me shkrim të nënshkruara nga persona të zgjedhur, ku të deklarohet se janë anëtarë të partive politike të koalicionit.

3. Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë. Në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose humbjeje të së drejtës për të kandiduar të një kandidati të listës, sipas këtij Kodi, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

4. Kur ka marrëveshje të subjektit zgjedhor për renditjen përfundimtare të kandidatëve të listës shumemërore, ajo depozitohet bashkë me listën shumemërore. Marrëveshja zbatohet drejtpërdrejt nga KQZ-ja kur përmban:

a) formulën e caktimit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të listës shumemërore;

b) marrëveshja të jetë e nënshkruar nga kryetari i partisë ose, sipas rastit, nga kryetarët e partive të koalicionit.

5. Listat nënshkruhen nga kryetari i partisë ose, sipas rastit, nga kryetarët e partive të koalicionit. Listave u bashkëngjitet një deklaratë e nënshkruar nga çdo kandidat që gëzon të drejtën e votës, dëshiron të kandidojë dhe pranon renditjen në listë. Lista duhet të shoqërohet për secilin kandidat nga dokumentet e parashikuara në nenin 79 pika 2, shkronjat "a" dhe "b" të këtij Kodi.

Neni 85

Pranimi i Listave

Kur partitë politike ose koalicionet paraqesin një listë me më pak se 20 kandidatë, lista nuk pranohet nga KQZ-ja. Nëse listat e veçanta të partive të koalicionit që paraqet

listë të përbërë, përmbajnë më pak se 10 kandidatë secila, lista e përbërë nuk pranohet nga KQZ-ja.

Neni 86

Verifikimi i Listave nga KQZ-ja

1. KQZ-ja verifikon rregullsinë e listave shumemërore, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në nenin 78 të këtij Kodi, për verifikimin e kandidatëve të drejtpërdrejtë.

2. Pas verifikimit të listave shumemërore, KQZ-ja i publikon ato në tri gazetatat me tirazh më të madh në shkallë vendi e në mediat elektronike dhe u dërgon një kopje të listës KZZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre, sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

3. Emrat e listave shumemërore të vërtetuara nuk mund të ndryshohen.

KREU III

LISTAT SHUMEMËRORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 87

Kushtet për Vlefshmërinë e Listave

1. Për caktimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive dhe të komunave, partitë politike të regjistruara paraqesin në KZQV një listë kandidatësh, sipas këtyre kushteve:

a) brenda afatit për paraqitjen e kandidaturave për kryetar bashkie dhe komune, i dorëzojnë KZQV-së një listë të kandidatëve, sipas formularit të përgatitur nga KQZ-ja;

b) çdo kandidat në listë deklaron se pranon të kandidojë për subjektin zgjedhor përkatës;

c) lista nënshkruhet nga kryetari i partisë ose personi i autorizuar prej tij për të mbështetur kandidatët;

2. Në rast vdekjeje të një kandidati të listës, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

Neni 88

Mospranimi i Listave

1. KZQV-ja nuk e pranon listën e kandidatëve kur numri i kandidatëve në listë është më i vogël se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit.

2. Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë.

Neni 89

Verifikimi dhe Publikimi i Listave

KZQV-ja verifikon listat e paraqitura nga partitë. Pas verifikimit, KZQV-ja i publikon listat në shtypin dhe mediat vendore, i shpall ato në territorin e bashkisë ose të komunës dhe i dërgon menjëherë një kopje KQZ-së.

PJESA E SHTATË

PROCEDURAT E VOTIMIT

KREU I

FLETËT E VOTIMIT

Neni 90*

Fletët e Votimit

1. Për zgjedhjet për Kuvendin zgjedhësi voton me dy fletë votimi me ngjyra të ndryshme, njëra për kandidatët që konkurrojnë drejtpërdrejt në zonë dhe tjetra për partitë politike dhe koalicionet që konkurrojnë në ato zgjedhje. Fleta e votimit për partitë politike dhe koalicionet në formë dhe përmbajtje është e njëjtë për të gjitha zonat e zgjedhjeve.

2. Për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, zgjedhësi voton me dy fletë votimi me ngjyra të ndryshme, njëra për kandidatët për kryetar bashkie ose komune dhe tjetra për kandidatët për këshillin e bashkisë ose të komunës.

3. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të kryeqytetit përdoren katër fletë votimi me ngjyra të ndryshme, një për kandidatët për kryetar të Bashkisë së Tiranës, një për kandidatët për kryetar të njësisë bashkiake, një për kandidatët për Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe fleta e fundit e votimit për kandidatët për këshillat e njësisive bashkiake. Format i tyre ndërtohet sipas pikës 4 të nenit 91 të këtij Kodi.

4. Sasia e secilit lloj të fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 për qind.

Neni 91[†]

Përmbajtja e Fletëve të Votimit

1. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

2. Fletët e votimit prodhohen në blloqe me kundërfletë. Vetëm në kundërfletë shënohet numri i serisë.

3. Emrat e kandidatëve për deputetë ose për kryetarë të njësisive të qeverisjes vendore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit alfabetik të emrit.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 58*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 59*)

4. Për secilin kandidat, në fletën e votimit shkruhet:
- a) emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit, ashtu sikurse figuron në dokumentacionin e kandidimit; dhe
 - b) poshtë emrit të kandidatit emërtimi, shkronjat nistore të partisë dhe/ose të koalicionit që përfaqëson kandidati, ose fjala “i pavarur”.
5. Në fletën e votimit për listat shumëmemërore të partive politike dhe koalicioneve radha e renditjes përcaktohet në bazë të rendit alfabetik të emërimit të partive dhe koalicioneve. Në fletën e votimit për partitë politike dhe koalicionet me listë të përbashkët shënohen emërtimet e tyre, së bashku me shkronjat nistore, si dhe shkronja nistore e emrit dhe mbiemri i kryetarit të partisë politike.
6. Partitë pjesëtare në një koalicion zgjedhor me listë të përbërë shënohen të renditura njëra pas tjetrës në pjesën e fletës së votimit që i përket koalicionit zgjedhor. Radha e renditjes së tyre përcaktohet sipas rendit alfabetik. Për secilën nga partitë politike të koalicionit me listë të përbërë shënohet emërtimi i saj, së bashku me shkronjat nistore, si dhe shkronja nistore e emrit dhe mbiemri i kryetarit të partisë politike.

Neni 92*

Vulosja e Fletëve të Votimit

1. Në pjesën e pasme fletët e votimit vulosen me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së.
2. Vula e KQV-së përmban tekstin “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit. Vula e kryetarit të KQV-së përmban tekstin “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror.
3. Vula e kryetarit të KQV-së përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit dhe për asnjë dokument tjetër zgjedhor.
4. Vulat e KQV-ve dhe vulat e kryetarëve të KQV-ve, secila veçmas, prodhohen dhe i dorëzohen KQZ-së të paketuara me ambalazh sigurie. Vulat e KQV-ve dhe të kryetarëve të KQV-ve prodhohen në numër të barabartë me numrin e KQV-ve dhe të kryetarëve të KQV-ve në shkallë vendi.

Neni 93[†]

Dërgimi i Materialeve Zgjedhore nga KQZ-ja në KZZ ose KZQV

1. KQZ-ja dërgon në selitë e KZZ-ve ose, sipas rastit, KZQV-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet e mëposhtme zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi:
 - a) numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë;
 - b) vulën e KQV-së;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 60*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 61*)

c) procesverbalet e qendrës së votimit ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës së policisë dhe të largimit të saj, si dhe mbylljen e votimit;

ç) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;

d) zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;

dh) zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”;

e) zarfin në të cilin është shënuar “ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”;

dhe

ë) lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësit dhe aparatit verifikues të saj.

2. Përveç kutive me materialet zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KZZ-ve ose KZQV-ve u jepen:

a) kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

b) numër i mjaftueshëm kodesh sigurie, sipas nenit 93/1 të këtij Kodi;

c) numër i mjaftueshëm dhomash të fshehta;

ç) kopje të mjaftueshme të Kodit Zgjedhor dhe të manualeve zgjedhore;

d) numrin e nevojshëm të vulave të kryetarëve të KQV-ve; dhe

dh) mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

3. KQZ-ja u dorëzon KZZ-ve ose KZQV-ve vulat e paketuara, sipas nenit 92 pika 4 të këtij Kodi, të mbyllura në ambalazhin e sigurisë dhe pa identifikuar numrin serial të vulës.

4. Përveç materialeve për KQV-të, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja i dërgon KZZ-së ose KZQV-së Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së, Tabelat për Rezultatet nga Grupet e Numërimit, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Njësisë Zgjedhore, vulën e KZZ-së ose KZQV-së, si dhe materiale të tjera të nevojshme për të, për administrimin e zgjedhjeve.

Neni 93/1*

Dërgimi i Materialeve Zgjedhore nga KZZ-ja ose KZQV-ja në KQV

1. KZZ-ja ose KZQV-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Kryetari, zëvendëskryetari, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, dhe sekretari i KQV-së paraqiten në selinë e KZZ-së ose KZQV-së dhe tërheqin:

a) kutinë me materialet zgjedhore, sipas nenit 93 pika 1 të këtij Kodi;

b) kutitë e votimit;

c) listat e zgjedhësve, sipas nenit 59 të këtij Kodi;

ç) dhomat e fshehta;

d) vulat me kodet e sigurisë; dhe

dh) mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

2. Kryetari i KQV-së merr në dorëzim vulën e kryetarit nga KZZ-ja ose KZQV-ja. Kryetari i KQV-së përkatëse, në praninë e anëtarëve të KZZ-së ose KZQV-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 62)

a) merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;

b) gris ambalazhin e vulës;

c) në një letër të bardhë vulos modelin e krahasimit të vulës; dhe

ç) poshtë secilës vulë shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij dhe nënshkruan në prani të anëtarëve të KZZ-së ose KZQV-së.

3. Letra e bardhë me modelin krahasues të secilës vulë, sipas pikës 2 të këtij neni, nënshkruhet në pjesën e pasme të saj nga anëtarët e KZZ-së ose KZQV-së dhe mbahet në ruajtje nga sekretari i KZZ-së ose KZQV-së.

4. Vulat me kodet e sigurisë dorëzohen me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë. KQV-ja merr në dorëzim aq vula me kode sigurie sa duhen për mbylljen e kutive të votimit dhe për mbylljen e kutisë me materiale zgjedhore, si dhe tre vula shtesë për përdorim në rast dëmtimi. Një kopje e procesverbalit ku janë shënuar kodet e sigurisë, duke përfshirë edhe kodet shtesë të sigurisë, mbahet nga KZZ-ja ose KZQV-ja dhe një kopje i jepet KQV-së.

KREU II

QENDRAT E VOTIMIT DHE ZONAT E TYRE

Neni 94*

Caktimi i Zonave të Qendrave të Votimit

1. Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit ruhen edhe në zgjedhjet pasardhëse, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 100 dhe më i madh se 1000 zgjedhës, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 63 pika 1 të këtij Kodi.

3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 3 të nenit 55 të këtij Kodi, në rast se:

a) një zonë qendre votimi ka më shumë se 1000 zgjedhës, vendos krijimin e një qendre votimi shtesë brenda së njëjtës zonë. Kryetari i njësisë përkatëse, në zbatim të udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, bën ndarjen e listës së zgjedhësve në dy pjesë me numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërohet sipas sistemit unik kombëtar të numërimit të qendrave të votimit;

b) një zonë qendre votimi ka më pak se 100 zgjedhës, vendos që ajo t'i bashkohet zonës së qendrës së votimit më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Si rregull, zgjedhësit banojnë jo më shumë se 5 km nga qendra e re e votimit.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 63)

Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit.

4. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive kjo nuk është e mundur.

5. Përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësisve bashkiake të Tiranës.

Neni 95*

Vendndodhja e Qendrës së Votimit, e Selive të KZZ-ve dhe KZQV-ve dhe e Vendit të Numërimit të Votave

1. Qendrat e votimit, selitë e KZZ-ve ose KZQV-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë.

2. Qendrat e votimit, selitë e KZZ-ve ose KZQV-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen:

- a) në ndërtesa private pa autorizimin e veçantë të KQZ-së;
- b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore dhe shëndetësore; ose
- c) në ndërtesa që përdoren ose janë në pronësi, pjesërisht apo tërësisht, të një partie politike ose kandidati apo të afërmeve të tij.

3. Jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve, me propozim të KZZ-së ose KZQV-së, KQZ-ja cakton Vendin e Numërimit të Votave brenda njësisë më të madhe administrative që përfshin njësi të zgjedhore. Si rregull, Vendi i Numërimit të Votave caktohet në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Vendet e numërimit të votave vihen në dispozicion të KZZ-ve ose KZQV-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve. KZZ-ja ose KZQV-ja, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të Vendit të Numërimit të Votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.

Neni 95/1[†]

Përgatitja e Vendit të Numërimit të Votave

1. Përpara prezantimit të vendit të numërimit subjekteve zgjedhore dhe KQV-ve përkatëse, KZZ-ja ose KZQV-ja përgatit infrastrukturën e nevojshme logjistike të vendit të numërimit, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave, sipas planvendosjes tip të miratuar nga KQZ-ja dhe udhëzimeve përkatëse të KQZ-së. Për këtë, KZZ-ja ose KZQV-ja vendos tryeza pune për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave. Tryezat e punës vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZZ-së ose KZQV-së dhe nga vëzhguesit,

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 64*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 65*)

kandidatët ose përfaqësuesit e medias. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit në një largësi të vogël nga tryezat e punës, por në largësi të atillë që të mos kenë kontakt fizik me materialet e votimit. Tryezat e punës së grupeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KZZ-së ose KZQV-së duhet të jetë në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave.

2. Pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave sigurohen nga KQZ-ja në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose vendore.

Neni 95/2*

Ngritja e Grupeve të Numërimit

1. Për numërimin e votave në rang njësie zgjedhore, me vendim të KZZ-së ose KZQV-së, jo më vonë se 2 orë para mbylljes së votimit, sipas nenit 8 të këtij Kodi, caktohen deri në 5 grupe numërimi me shtatë anëtarë dhe një sekretar secili. Çdo grup numërimi numëron votat e të paktën 3 qendrave të votimit.

Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i grupit të numërimit caktohen sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara për KZZ-të ose, sipas rastit, për KZQV-të. Kryetari i grupit të parë të numërimit caktohet me propozimin e subjektit politik që ka propozuar zëvendëskryetarin e KZZ-së ose KZQV-së dhe më pas për kryetarin e grupit të dytë të numërimit me propozimin e subjektit politik që ka propozuar kryetarin e KZZ-së ose KZQV-së dhe vijohet me këtë radhë për grupet e tjera.

2. Në rast se ndonjë nga subjektet zgjedhore nuk paraqet propozimet brenda këtij afati kohor, KZZ-ja ose KZQV-ja cakton me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në rang njësie zgjedhore.

Neni 96†

I shfuqizuar

KREU III

PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 97‡

Veprime Paraprake të KQV-së

1. KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit dhe në prani të vëzhguesve, sipas nenit 18 të këtij Kodi, një orë përpara hapjes së votimit, kryen këto detyra:

a) i vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 65)

† Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 66)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 67)

- b) heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m;
- c) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
- ç) vendos materiale të tjera të kërkuara nga KQZ-ja;
- d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;
- dh) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta dhe i mbyll ato, sipas procedurës së përcaktuar në shkronjën “e” të këtij neni;
- e) vulos kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe numrat e vulave të sigurisë i shënon në Procesverbalin e Vulosjes së kutive të votimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Në rast se ndonjë nga vulat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe në Procesverbalin e Vulosjes shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar dhe numri i kodit të sigurisë së vulës shtesë. Origjinali i procesverbalit mbyllet në zarfin ku është shkruar “ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”, i cili futet në kutinë e votimit për kandidatët para fillimit të procesit të votimit. Kopje e Procesverbalit të Vulosjes me vulën e KQV-së u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare;
- ë) në një nga faqet anësore të kutisë shënon qartë numrin e qendrës së votimit, si dhe vendos shenja dalluese që i bëjnë të qartë zgjedhësit se ku duhet të hedhë çdonjërin nga fletët e votimit.
2. Anëtarët e KQV-së, në prani të vëzhguesve, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

Neni 98*

Hapja e Votimit dhe Prania e Anëtarëve dhe Sekretarit të KQV-së

1. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në nenin 97, kryetari i KQV-së deklaron hapjen e votimit jo më përpara orës së parashikuar në nenin 8 të këtij Kodi.
2. Sekretari i KQV-së shënon në Librin e Potokollit të Mbledhjeve të KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të KQV-së që largohet prej qendrës së votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai i kalon vulën e kryetarit për përdorim anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi deri në çastin e rikthimit të tij. Sekretari i KQV-së bën shënimin përkatës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Kur sekretari largohet nga qendra e votimit, vula e KQV-së dhe Libri i Protokollit të Mbledhjeve i kalojnë për përdorim zëvendëskryetarit deri në rikthimin e sekretarit të KQV-së. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bëhet shënimi përkatës për pasqyrimin e këtij fakti.

KREU IV

PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 68)

Neni 99^{*}
Numri i kutive të votimit

1. Në zgjedhjet për Kuvendin, në qendrën e votimit vendosen dy kuti votimi, një për kandidatin për deputet në zonën njëemërore dhe një për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore.

2. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, në qendrën e votimit vendosen dy kuti votimi, një për kandidatët për kryetar bashkie ose komune dhe një për kandidatët për këshillat bashkiakë ose të komunës.

Në zgjedhjet vendore për kryeqytetin, në qendrën e votimit vendosen katër kuti votimi, një për kandidatët për kryetar të Bashkisë së Tiranës, një për kandidatët për kryetar të njësisë bashkiake, një për kandidatët për Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe një për kandidatët për këshillat e njësisive bashkiake.

3. Në votimin në referendum përdoret një kuti votimi për çdo çështje për të cilën votohet.

Neni 100[†]
Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit

1. Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit:

a) zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të identitetit si më poshtë:

- i) certifikatë lindjeje me fotografi;
- ii) letërnjoftim; ose
- iii) pasaportë;

b) një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kontrollon zgjedhësin në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme. Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët mund ta verifikojnë menjëherë. Emri i këtij zgjedhësi shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe ai nuk lejohet të votojë;

c) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve, shënon në listën e zgjedhësve numrin e serisë së dokumentit të indentitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.

Në rast se një anëtar i KQV-së vë në dyshim identitetin e një zgjedhësi, rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, duke shkruar emrin e kundërshtuesit, arsyet e kundërshtimit, emrin dhe numrin e identifikimit të zgjedhësit dhe arsyet pse kryetari i KQV-së e pajisi personin me fletën e votimit;

ç) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;

d) fleta e votimit vulozet në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së;

dh) zgjedhësi, pasi merr fletën e votimit, timbroset në dorën e majtë me një lëndë të posaçme nga një anëtar i KQV-së, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 69*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 70*)

herë. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, ai nuk lejohet të votojë dhe mbahen shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së identiteti i tij e numri i fletëve të votimit që ai ka marrë.

2. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listat zgjedhore përfundimtare, por është i pajisur me vendim gjykate, e cila i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi, sipas nenit 60 të këtij Kodi, KQV-ja shënon emrin e zgjedhësit në një regjistër të veçantë dhe i bashkëlidh vendimin e gjykatës, si dhe një certifikatë personale me fotografi të zgjedhësit.

Neni 101^{*}

Votimi

1. Pasi merr një fletë votimi për kandidatin dhe një fletë votimi për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe voton në secilën fletë votimi, duke shënuar në krah të emrit të kandidatit ose të partisë a koalicionit shenjën “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.

2. Zgjedhësi, pasi voton, palos fletët e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, dhe del nga dhoma e fshehtë. Zgjedhësi hedh fletët e votimit në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

3. Zgjedhësi voton vetëm për vete, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 103 të këtij Kodi.

4. Anëtarët e KQV-së, që kanë lejuar një zgjedhës të votojë më shumë se një herë ose në emër të zgjedhësve të tjerë, mbajnë përgjegjësi penale, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal.

Neni 102[†]

Fletët e votimit të dëmtuara

1. Nëse shënimi në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E DËMTUARA” dhe e fut atë zarin e FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA. Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarin e FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

2. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarin e FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 71*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 72*)

futet në zarfin e FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

3. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.

Neni 103*

Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

1. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

2. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

3. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

4. Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

5. Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

6. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.

7. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel ndihmës për të garantuar hyrjen e lirë.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 73)

8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për zgjedhësit e verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 104^{*}

Rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit

1. Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja merr vendim për pezullimin e votimit, si dhe mund të vendosë thirrjen e organeve të Policisë së Shtetit. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe rrethanave.

2. Kryetari, zëvendëskryetari i KQV-së ose çdo anëtar njofton menjëherë KZZ-në ose KZQV-në për incidentin e ndodhur. KZZ-ja ose KZQV-ja është e detyruar të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së njoftimin dhe orën e marrjes së tij. KZZ-ja ose KZQV-ja ia përcjell kërkesën menjëherë organeve të Policisë së Shtetit.

3. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja, me vendim, u kërkon organeve të Policisë së Shtetit të largohen nga qendra e votimit dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit.

Neni 105[†]

Personat e pranishëm në qendrën e votimit

1. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:

- a) anëtarët dhe sekretari i KQV-së;
- b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre; dhe
- c) vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.

2. Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit. Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë në ushtrim të detyrës, në përputhje me nenin 104 të këtij Kodi, si dhe punonjësit e policisë së burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 74*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 75*)

Neni 106^{*}
I shfuqizuar

Neni 107[†]
Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit

1. Në zgjedhjet për Kuvendin dhe referendumet e përgjithshme, zgjedhësit, që shërbejnë në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit, votojnë në njësinë zgjedhore, ku ndodhen repartet e tyre, sipas nenit 64 të këtij Kodi.

2. Në zgjedhjet dhe referendumet vendore, zgjedhësit, që shërbejnë në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit, votojnë në zonën e qendrës së votimit të vendbanimit të tyre.

KREU V

MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 108[‡]
Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar në nenin 8 dhe në përputhje me pikën 3 të nenit 8 të këtij Kodi.

2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin tip përkatës, duke shënuar në të edhe orën e mbylljes së votimit. Vendimi për mbylljen e votimit dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe/ose të huaj dhe përfaqësuesit e akredituar të medias.

Neni 109[§]
Veprimet pas mbylljes së votimit

Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:

1. Kryetari i komisionit, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, vulos kutitë e votimit me kodin e sigurisë të dërguar nga KQZ-ja, sipas nenit 93/1 të këtij Kodi, në pjesën nga e cila futen fletët e votimit. Numri serial i vulës shënohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Në rast se vula me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një

* Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 76*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 77*)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 78*)

§ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 79*)

nga vulat shtesë. Në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar.

2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së:

a) fillon numërimin e zgjedhësve që kanë votuar, sipas nënshkrimeve të bëra në listën e zgjedhësve;

b) ia deklaron shifrën me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së;

c) i fton ata të verifikojnë shifrën e thënë prej tij; dhe

ç) shënon në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit, sipas listës së zgjedhësve. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, merret vendim nga KQV-ja. Sekretari i KQV-së shënon vendimin e marrë në këtë rast në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të KQV-së. Nëse kërkohet nga një anëtar i KQV-së, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbyllën në zarfin ku është shënuar "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA". Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, përcakton numrin e fletëve të votimit të përdorura. Për të përcaktuar këtë numër, nga totali i fletëve të votimit të marra në dorëzim nga KQV-ja, zbritet numri i fletëve të votimit të papërdorura. Numri i fletëve të votimit të përdorura verifikohet me numrin e kundërfletëve. Numri i fletëve të votimit të përdorura pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe, në rast mospërputhje me numrin e kundërfletëve, pasqyrohet edhe ky fakt.

5. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin e FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

6. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 5 të këtij neni mbyllën në kutinë e materialeve zgjedhore:

a) zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË PAPËRDORURA së bashku me kundërfletët;

b) zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË DËMTUARA;

c) lista e zgjedhësve;

ç) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;

d) vula e KQV-së;

dh) vula e kryetarit të KQV-së;

e) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;

ë) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara; dhe

f) Libri i Protokollit të Mbledhjeve.

Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia, shënohen paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit,

shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit. Originali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në Kutinë e Materialeve të Votimit, e cila vuloset menjëherë me kodet përkatëse të sigurisë. Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

Neni 109/1*

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave

1. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të parashikuara në nenin 109 të këtij Kodi, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe Kutia me Materialet e Votimit dërgohen në Vendin e Numërimit të Votave, të caktuar sipas nenit 95 të këtij Kodi. Materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit i dorëzohen KZZ-së ose KZQV-së brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar nga KQZ-ja.

2. Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe Kutia me Materialet e Votimit dorëzohen në vendin e numërimit të votave, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në qendrën e votimit. Dërgimi i tyre bëhet me automjet, në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mosprekjen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe të Kutisë së Materialeve të Votimit. KQZ-ja autorizon KZZ-në ose KZQV-në, duke i dhënë edhe fondet e nevojshme financiare, për të siguruar transportimin me automjet të kutive të votimit me fletët e votimit dhe Kutinë me Materialet e Votimit.

3. Punonjësi i policisë, sipas pikës 2 të këtij neni, është efektiv i përhershëm i policisë së rendit ose i policisë së ruajtjes të objekteve, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit nga KQZ-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Polici i shoqërimit duhet në çdo moment të mbajë uniformën e Policisë së Shtetit dhe të ketë në një vend të dukshëm numrin rendor të caktuar nga KQZ-ja dhe mbiemrin e tij me përmasa të dukshme.

Neni 109/2†

Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZZ-ja ose KZQV-ja

1. KZZ-ja ose KZQV-ja cakton për marrjen në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutive me materialet e votimit një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim me jo më pak se dy anëtarë të saj. Kutitë me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në Vendin e Numërimit të Votave, sipas rregullave të përcaktuara nga KZZ-ja ose KZQV-ja.

2. Gjatë marrjes në dorëzim, grupet e marrjes në dorëzim:

a) shënojnë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim numrat e kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat është mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 80*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 80*)

b) verifikojnë në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qendër votimi në zbatim të nenit 93/1. Në rast mospërputhjeje të këtyre kodeve, grupi i marrjes në dorëzim informon KZZ-në ose KZQV-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZZ-ja ose KZQV-ja verifikon menjëherë mospërputhjen dhe merr vendim, sipas pikës 4 të këtij neni. Në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së shënohen mospërputhjet e konstatuara.

3. Në rast se gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se:

- a) mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;
- b) vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- c) kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose
- ç) kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja;

atëherë grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë për parregullsinë KZZ-në ose KZQV-në dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZZ-ja ose KZQV-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe vendos, sipas pikës 4 të këtij neni. Parregullsia e konstatuar shënohet në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së.

4. Në rastet kur për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të kutive nga grupet e marrjes në dorëzim, konstatohet parregullsi, sipas pikës 2 ose 3 të këtij neni, për njërën nga kutitë me fletët e votimit, atëherë ajo kuti vlerësohet si e KUTI E PARREGULLT dhe dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia me materialet e votimit dhe kutia tjetër me fletët e votimit i nënshtrohen procedurave, sipas neneve 109/3-109/6 të këtij Kodi. Në rastin kur të dy kutitë me fletët e votimit janë vlerësuar si të parregullta, atëherë të dy kutitë me fletët e votimit dhe kutia përkatëse e materialeve të votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta. Në rastin kur vetëm kutia e materialeve të votimit përcaktohet si KUTI E PARREGULLT, ajo i nënshtrohet procedurave, sipas nenit 109/3, së bashku me kutitë e votimit me fletët e votimit.

5. Kutitë e votimit të përcaktuara KUTI TË PARREGULLTA në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZZ-ja ose KZQV-ja dhe as nuk i kalojnë Grupit të Numërimit. Ato dërgohen në KQZ për nevoja të hetimit administrativ.

6. KZZ-ja ose KZQV-ja mban Procesverbal Konstatimi, në të cilin shënohen të dhënat për kutitë e votimit me fletët e votimit ose kutitë me materialet e votimit të deklaruara të parregullta, sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe të dhëna për pasaktësitë ose parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të procedurave të nenit 109/3 të këtij Kodi. Kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZZ-së ose KZQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

7. Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari i KQV-së, zëvendëskryetari i KQV-së, sekretari i KQV-së dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërim, nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim. Originali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim administrohet nga KZZ-ja, e cila u jep nga një kopje përkatësisht

kryetarit, zëvendëskryetarit të KQV-së dhe punonjësit të policisë të caktuar për shoqërimin. Punonjësi i policisë duhet të largohet menjëherë pas marrjes së kopjes së procesverbalit.

8. Procesverbali i Marrjes në Dorëzim përgatitet nga KQZ-ja në formën e një formulari tip dhe duhet të përmbajë kohën e marrjes në dorëzim, numrin e qendrës së votimit, vulave me kodet e sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, hapësirën për përshkrimin e mospërputhjeve ose parregullsive të konstatuara, si dhe hapësirën për nënshkrimet.

9. Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, të marra në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, vendosen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga KZZ-ja. Ky vend duhet të jetë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave dhe duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.

Neni 109/3* **Numërimi i votave**

1. KZZ-ja ose KZQV-ja merr vendim për fillimin e numërimit të votave vetëm pasi të ketë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha qendrat e votimit nën juridiksionin e saj.

2. Sekretarët e grupeve të numërimit, me radhë, sipas numrit rendor, marrin nga stiva e kutive të votimit kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë respektive me materialet e votimit të vetëm një qendre votimi dhe i vendosin pranë tryezës së Grupit të Numërimit përkatës. Në vijim sekretari merr nga sekretari i KZZ-së ose KZQV-së modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së, të depozituar në përputhje me nenin 93/1 të këtij Kodi.

3. Fillimisht Grupi i Numërimit kryen procedurat e verifikimit të të dhënave në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit. Për kryerjen e verifikimit, Grupi i Numërimit ndjek këto procedura:

a) Kryetari i Grupit të Numërimit merr Kutinë me Materialet e Votimit, e vendos atë mbi tryezë dhe e hap, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Nga kutia nxirret Procesverbali për Mbylljen e Votimit dhe verifikohet nëse në kuti ndodhen:

- i) zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË PAPËRDORURA së bashku me kundërfletët;
- ii) zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË DËMTUARA;
- iii) lista e zgjedhësve;
- iv) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;
- v) vula e KQV-së;
- vi) vula e kryetarit të KQV-së;
- vii) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
- viii) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara; dhe
- ix) Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;

b) Kryetari i Grupit të Numërimit fillimisht krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ia bën të ditur anëtarëve të grupit;

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 80*)

c) Kryetari i Grupit të Numërimit numëron fletët e votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Zëvendëskryetari bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura;

ç) Kryetari i Grupit të Numërimit numëron fletët e votimit të dëmtuara dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Zëvendëskryetari bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të dëmtuara;

d) Kryetari i Grupit të Numërimit numëron zgjedhësit që kanë votuar sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Zëvendëskryetari bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e zgjedhësve që kanë votuar;

dh) Kryetari i Grupit të Numërimit, mbi bazën e krahasimit të shifrave të verifikuara, llogarit dhe deklaron numrin e fletëve të votimit të përdorura, i cili rezulton nga diferenca ndërmjet totalit të fletëve të votimit, sipas Procesverbalit për Mbylljen e Votimit, me numrin e fletëve të votimit të papërdorura. Zëvendëskryetari bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.

4. Pas kryerjes së verifikimit, Kryetari i Grupit të Numërimit mbyll kutinë e Materialeve të Votimit me vula me kode sigurie, duke lënë jashtë kutisë Procesverbalin për Mbylljen e Votimit. Zëvendëskryetari shënon numrat e kodeve në Procesverbalin e Grupit të Numërimit për Mbylljen e Kutisë me Materialet e Votimit. Kutia me Materialet e Votimit rivendoset pranë tryezës së KZZ-së ose KZQV-së.

5. Në vijim, Kryetari i Grupit të Numërimit vendos mbi tryezë kutinë e votimit me fletët e votimit për kandidatët dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Kutia e votimit për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore hapet vetëm pasi të jenë përfunduar procedurat e numërimit e të vlerësimit dhe të jetë mbyllur kutia me fletët e votimit për kandidatët. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Grupit të Numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me Procesverbalin e Vulosjes, sipas nenit 97 të këtij Kodi, i shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Fletët e votimit të stivosura numërohen nga kryetari dhe zëvendëskryetari, të cilët, në përfundim të numërimit, ua bëjnë të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Shifrën e deklaruar e verifikojnë me shifrën që del nga diferenca e numrit të fletëve të votimit të përdorura me numrin e fletëve të votimit të dëmtuara. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, kryetari dhe zëvendëskryetari janë të detyruar të rifillojnë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit.

6. Në rast se nga verifikimet e kryera, sipas këtij neni, konstatohen pasaktësi ose parregullsi, atëherë Grupi i Numërimit ose cilido nga anëtarët që bën konstatimin, njofton menjëherë KZZ-në ose KZQV-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet me ngritjen

e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit derisa KZZ-ja ose KZQV-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZZ-ja ose KZQV-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZZ-ja ose KZQV-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZZ-ja ose KZQV-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit.

Neni 109/4*

Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës

1. Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme.
2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët ose partitë politike apo koalicionet zgjedhore në fletën përkatëse të votimit.
3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;
 - b) në pjesën e pasme të fletës së votimit mungojnë vulat, sipas nenit 92 të këtij Kodi;
 - c) në fletën e votimit janë bërë shënime që mund të zbulojnë identitetin e zgjedhësit;
 - ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
 - d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
 - dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
 - e) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose
 - ë) zgjedhësi ka votuar për një person që nuk është në fletën e votimit.

Neni 109/5†

Vlerësimi i votave

1. Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas kryerjes së numërimit të fletëve të votimit. Kryetari i Grupit të Numërimit hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, bën vlerësimin e saj me zë të lartë, duke vepruar sipas kësaj radhe:
 - a) verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; në rast të kundërt e vlerëson votën të pavlefshme;
 - b) verifikon nëse në pjesën e pasme të fletës së votimit është vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së; në rast të kundërt e vlerëson votën të pavlefshme;
 - c) verifikon nëse ekziston ndonjë nga shkaqet e tjera për deklarimin e votës së pavlefshme, të parashikuara në shkronjat “c” deri “ë” të nenit 109/4 të këtij Kodi; nëse ekziston një nga këto shkaqe, e vlerëson votën të pavlefshme.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 80*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 80*)

2. Kryetari i Grupit të Numërimit në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, çmon dhe pastaj propozon për vlerësim kolegjal se cilit kandidati dhe partie politike ose koalicioni zgjedhor i është hedhur vota. Kryetari ia tregon fletët e votimit një për një çdo anëtar të Grupit të Numërimit.

Nëse të gjithë anëtarët e Grupit të Numërimit janë dakord me vlerësimin e kryetarit, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe kryetari merr fletën tjetër të votimit.

Nëse ndonjë nga anëtarët e Grupit të Numërimit s'është dakord me vlerësimin e kryetarit, kryetari ose anëtar i kundërshtues njofton menjëherë KZZ-në ose KZQV-në për kundërshtimin. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit derisa KZZ-ja ose KZQV-ja të njihet me çështjen dhe të marrë vendim lidhur me të. Kryetari i KZZ-së ose KZQV-së shkruan një numër rendor në anën e pasme të fletës së votimit, natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit në mënyrë të përmbledhur. Numri në fletën e votimit, pretendimi i paraqitur për të dhe arsyetimi i vendimit të KZZ-së ose KZQV-së shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së. Çdo anëtar ose vëzhgues mund të shtojë vërejtjet e tij në Librin e Protokollit. Vendimi i marrë nga KZZ-ja ose KZQV-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit, i cili e llogarit fletën e votimit si votë, sipas vlerësimit të bërë nga KZZ-ja ose KZQV-ja, në Tabelën e Rezultateve. Këto fletë votimi, pas nxjerrjes së rezultatit nga Grupi i Numërimit, vendosen në Zarin e Fletëve të Votimit të Kontestuara.

3. Fletët e votimit, sipas vlerësimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ndahen mbi tryezën e punës në vende të caktuara dhe të veçanta në grupime të votave për çdo kandidat, për çdo parti politike ose koalicion zgjedhor, vota të pavlefshme dhe vota të kontestuara. Në rastin e koalicioneve me listë të përbërë, votat e secilës prej partive anëtare të koalicionit grupohen veçmas dhe pranë njëra-tjetrës, duke identifikuar votat për secilën prej partive anëtare të koalicionit.

Neni 109/6*

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit

1. Pas numërimit dhe vlerësimit, sipas neneve 109/4 dhe 109/5 të këtij Kodi, për çdo kuti me fletët e votimit për kandidatët, kryetari numëron votat për çdo kandidat, duke filluar sipas renditjes së kandidatëve në fletën e votimit. Pas çdo numërimi, shifrën ia bën të ditur anëtarëve të Grupit të Numërimit. Nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë kandidat. Në rast se pas edhe këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, Kryetari i Grupit të Numërimit ose anëtar i kundërshtues njofton KZZ-në ose KZQV-në nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit deri në marrjen e vendimit nga KZZ-ja ose KZQV-ja. KZZ-ja ose KZQV-ja numëron në vend votat për kandidatin, të cilat kontestohen dhe urdhëron sekretarin e Grupit të Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 80)

2. Në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kryetari, së bashku me anëtarët e Grupit të Numërimit, plotëson tabelën e rezultateve për atë qendër votimi, sipas formularit tip të përcaktuar nga KQZ-ja.

3. Tabela origjinale e rezultateve të votimit, sipas pikës 2 të këtij neni, duke përfshirë edhe kundërshtimet, nëse ka, të ndonjë anëtari të Grupit, i dorëzohet menjëherë dorazi KZZ-së nga sekretari i Grupit të Numërimit. Kopje të tabelës së rezultateve i jepen çdo anëtari të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

4. Pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, fletët e votimit për kandidatët futen në zarfe të ndara sipas kandidatëve, kurse votat e pavlefshme në zarfin me shënimin "VOTA TË PAVLEFSHME". Zarfet me fletët e votimit për kandidatët, zarfi me fletët e votimit të pavlefshme, zarfi me fletët e votimit të kontestuara dhe zarfi me Procesverbalin e Vulosjes futen në kutinë e votimit. Kutia mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Numrat e kodeve shënohen në tabelën e rezultateve. Pas kësaj, kutia rivendoset pranë tryezës së Grupit të Numërimit dhe merret kutia me fletët e votimit për partitë politike ose koalicionet zgjedhore. Grupi i Numërimit, për kutitë e votimit me fletët e votimit për partitë politike ose koalicionet zgjedhore, kryen të njëjtat veprime të përcaktuara në nenin 109/3 pika 5 deri në nenin 109/6 të këtij Kodi.

5. Grupi i Numërimit merr nga stiva e kutive të votimit kutitë me fletët e votimit dhe me materialet e votimit të qendrës tjetër të votimit, vetëm pasi ka dërguar në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave kutitë e përpunuara dhe i ka dorëzuar KZZ-së ose KZQV-së tabelën e rezultateve përkatëse për qendrën e votimit të numëruar.

Neni 109/7*

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga KZZ-ja ose KZQV-ja

1. Rezultati i zgjedhjeve për njësinë përkatëse zgjedhore nxirret nga KZZ-ja ose KZQV-ja jo më vonë se ora 17⁰⁰ e ditës së nesërme të votimit.

2. Për nxjerrjen e rezultatit, KZZ-ja ose KZQV-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve, në të cilën pasqyrohen shumatat e të dhënave respektive për çdo qendër votimi mbi bazën e origjinaleve të tabelave të rezultateve të grupeve të numërimit.

3. KZZ-ja ose KZQV-ja nxjerr rezultatit për njësinë përkatëse zgjedhore, duke miratuar me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi subjektet zgjedhore kanë të drejtë të ankohen në KQZ, në përputhje me nenin 146 të këtij Kodi.

4. Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZZ-së ose KZQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare dhe origjinalet e tyre i dërgohen KQZ-së.

5. KZZ-ja ose KZQV-ja, në përfundim të procedurave për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve, afishon në një vend të dukshëm me hyrje të lirë, pranë selisë së vet dhe Vendit të Numërimit të Votave, një kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve dhe një kopje të Procesverbalit të Konstatimit.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 80)

6. Me përfundimin e procedurave për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve, KZZ-ja ose KZQV-ja dorëzon në KQZ Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve, Procesverbalin e Konstatimit, Librin e Protokollit të Mbledhjeve, vulën e saj, si dhe çdo material tjetër zgjedhor.

Neni 109/8*

Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave

1. Gjatë procesit të numërimit të votave, në Vendin e Numërimit të Votave janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KZZ-së ose KZQV-së, anëtarët dhe sekretarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e akredituar të medias.

2. KZZ-ja ose KZQV-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në Vendin e Numërimit të Votave, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Në rast të pranisë së personave të tjerë, përveç atyre sipas pikës 1, KZZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZZ-së ose KZQV-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.”

Neni 110

I shfuqizuar

KREU VI

RINUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 111

I shfuqizuar

Neni 112

I shfuqizuar

Neni 113

I shfuqizuar

Neni 114

I shfuqizuar

Neni 115

I shfuqizuar[†]

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 80)

[†] Nenet 110, 111, 112, 113, 114 dhe 115 janë shfuqizuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 81)

KREU VII

NDALIMI I PERDORIMIT TË FORCAVE DHE STRUKTURAVE TË POSAÇME

Neni 116

Përdorimi i forcave dhe strukturave të posaçme

1. Forcat komando dhe forcat e tjera të ushtrisë ndalohen që të përdoren gjatë gjithë periudhës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Mbrojtjes kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësishme së veçantë ose në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Objekteve. Një kopje e urdhrimit me shkrim i dërgohet menjëherë KQZ-së. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.

2. Forcat e ushtrisë ndalohen të kryejnë ushtrime ose manovra ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit të tyre, gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

3. Në të gjitha llojet e zgjedhjeve ndalohet përdorimi ose pjesëmarrja e punonjësve apo strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror.

PJESA E TETË

PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

Neni 117*

Pavlefshmëria e zgjedhjeve

1. Subjektet zgjedhore, brenda 10 ditëve nga data e zgjedhjeve ose brenda 10 ditëve nga data e përsëritjes së zgjedhjeve, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, në njësi të veçanta zgjedhore ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme, në rast se:

- a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
- b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose
- c) votimi nuk ka filluar ose është pezulluar për më shumë se gjashtë orë; dhe për cilindo nga këto shkaqe është cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në njësitë zgjedhore ose në shkallë vendi apo në miratimin ose refuzimin e referendumit.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve fillon ditën që mbaron afati i paraqitjes së tyre, sipas pikës 1 të këtij neni. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kreun I të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 82)

KQZ-ja merr vendim për pavlefshmërinë e zgjedhjeve pas konsultimeve me KZZ-në ose KZQV-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre. Në vendimin për pavlefshmërinë e zgjedhjeve KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore, në një ose më shumë qendra votimi të së cilës zgjedhjet janë deklaruar të pavlefshme ose, sipas rastit, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Pavarësisht nga pika 4 e këtij neni, KQZ-ja ka të drejtë të vendosë mospërsëritjen e zgjedhjeve në rast se vërtetohet se shkeljet nuk mund të kenë ndikuar mbi ndarjen e mandateve në njësitë zgjedhore ose në shkallë vendi.

6. Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme dhe për të cilat KQZ-ja ka vendosur përsëritjen, sipas këtij neni, përsëriten në një ditë të vetme për të gjitha njësitë zgjedhore ku është vendosur përsëritja e tyre. Vendimi për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve merret nga KQZ-ja me përfundimin e procedurave ankimore, sipas Kreut II të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi ose me kalimin e afateve ligjore të ankimit, të përcaktuara në këtë Kre. Përsëritja e zgjedhjeve zhvillohet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit.

7. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për shpalljen ose jo të zgjedhjeve të pavlefshme bëhet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara nga Kreu II i Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

PJESA E NËNTË

REFERENDUMET

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 118

Kuptimi i referendumit

1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës.

2. Votimi për referendum kryhet sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

3. Në referendum konsiderohet fituese alternativa që ka fituar shumicën e votave të vlefshme, por jo më pak se një të tretën e numrit të zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kre.

Neni 119

Kufizime në ushtrimin e të drejtës së referendumit

1. Asnjë referendum kushtetues ose i përgjithshëm nuk mund të zhvillohet datën e zgjedhjeve për Kuvend ose për organet e qeverisjes vendore.

2. Nuk mund të zhvillohet referendum kushtetues ose i përgjithshëm gjatë periudhës nga gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të Kuvendit të ri.

3. Nuk mund të zhvillohet referendum vendor gjatë periudhës nga tre muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të këshillave vendorë.

4. Kur shpallen zgjedhje të parakohshme për Kuvendin, procedura për zhvillimin e referendumit pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga mbledhja e parë e Kuvendit të ri.

5. Kur në një njësi të qeverisjes vendore shpallen zgjedhje të parakohshme, procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore.

6. Në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës, kërkesat për referendum, që nuk kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat e këtij kreu, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri në vitin pasardhës.

Neni 120

Procedurat për zhvillimin e referendumeve

1. Referendumet kushtetuese dhe referendumet e përgjithshme administrohen nga KQZ-ja nëpërmjet KZZ-ve dhe, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, për aq sa është e mundur ose e nevojshme.

2. Referendumet vendore administrohen nga KQZ-ja nëpërmjet KZQV-ve dhe, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod për zhvillimin e zgjedhjeve vendore, për aq sa është e mundur ose e nevojshme.

3. Për referendumet në nivel qarku, KQZ-ja krijon komisionin zgjedhor në nivel qarku. Përbërja e këtij komisioni propozohet nga këshilli i qarkut, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod për përbërjen e KZQV-së.

4. Kur në të njëjtën datë zhvillohet më shumë se një referendum, fletët e votimit të secilit referendum janë me ngjyra të ndryshme.

Neni 121

Miratimi i projektligjeve që votohen në referendum

1. Projektligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Shfuqizimi i një ligji me referendum hyn në fuqi menjëherë me shpalljen e rezultatit. Kuvendi, me kërkesë të arsyetuar të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë shtyrjen e shfuqizimit të ligjit ose të pjesës së shfuqizuar të tij, por jo për më shumë se 60 ditë.

KREU II
LLOJE TË VEÇANTA REFERENDUMESH

SEKSIONI 1

REFERENDUMI KUSHTETUES

Neni 122

Llojet e referendumit kushtetues

Referendumi kushtetues, sipas pikës 4 të nenit 177 të Kushtetutës, zhvillohet me vendim të dy të tretave të të gjithë deputetëve që projektamendamenti kushtetues të votohet drejtpërdrejt nga populli. Referendumi kushtetues, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, është referendumi që kërkohet nga një e pesta e deputetëve, për t'ia nënshtruar votimit popullor amendamentin kushtetues, të miratuar nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 123

Procedurat fillestare

1. Kërkesa për referendum kushtetues për rishikimin e Kushtetutës përmban tekstin e projektligjit për rishikimin e Kushtetutës.

2. Kërkesat për referendum, në përputhje me pikën 5 të nenit 177 të Kushtetutës, i dorëzohen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit brenda 15 ditëve nga miratimi i amendamentit kushtetues nga Kuvendi.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ia dërgon menjëherë Gjykatës Kushtetuese dhe Presidentit të Republikës vendimin e Kuvendit ose, sipas rastit, kërkesën e një të pestës së deputetëve, që kërkojnë zhvillimin e një referendumit kushtetues.

Neni 124

Shqyrtimi paraprak nga Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, shqyrton paraprakisht kushtetueshmërinë e mbajtjes së referendumit kushtetues, sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

Neni 125

Procedurat e mëtejshme për referendumin kushtetues

1. Kur Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa për referendum kushtetues është në pajtim me Kushtetutën ose nuk shprehet brenda afatit, Presidenti i Republikës cakton datën e zhvillimit të referendumit, në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës.

2. Në këtë rast, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit njofton KQZ-në për zhvillimin e referendumit kushtetues dhe i dërgon tekstin e projektligjit që do të votohet në

referendum. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit e boton tekstin e projektligjit që do të votohet në referendum në tri gazetata me tirazhin më të madh në shkallë vendi.

3. Në rast se Gjykata Kushtetuese vendos që kërkesa për referendum kushtetues nuk është në pajtim me Kushtetutën, procedura për zhvillimin e referendumit pushon. Në rastin e kërkesës, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, amendamentet kushtetuese të miratuara nga Kuvendi shpallen nga Presidenti i Republikës dhe hyjnë në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

4. Amendamentet kushtetuese, që i nënshtrohen referendumit, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, rrëzohen kur më shumë se gjysma e të gjithë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë votuar kundër tyre. Në qoftë se amendamentet kushtetuese nuk rrëzohen në referendum, ato shpallen nga Presidenti i Republikës dhe hyjnë në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKSIONI 2

REFERENDUMI I PËRGJITHSHËM

Neni 126

Nisma për referendum të përgjithshëm

1. Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve .

3. Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

4. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

a) titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet, si dhe në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

b) arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj, si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoqe dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me "PO" ose "JO".

Neni 127

Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

1. KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e

nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkojnë të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

2. Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.

Neni 128

Verifikimi i kërkesës nga KQZ-ja

1. KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

2. KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

3. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.

Neni 129

Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese

1. Pas verifikimit të rregullsisë së kërkesave, KQZ-ja ia përcjell kërkesat për referendum të përgjithshëm Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 119 të këtij Kodi. KQZ-ja njofton njëkohësisht Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin për kërkesat e pranuar.

2. Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetutshmërinë e kërkesave për referendum të përgjithshëm dhe nëse ato janë formuluar në përputhje me pikat 3 dhe 5 të nenit 126, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së kërkesave nga KQZ-ja.

3. Presidenti i Republikës vendos për zhvillimin ose jo të referendumeve për çështje të rëndësishme të veçantë pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit, brenda të cilit ajo duhet të shprehej. Në qoftë se vendos që referendumi i kërkuar nuk duhet të zhvillohet, Presidenti njofton me shkrim KQZ-në për arsyet, të cilat KQZ-ja ua dërgon nismëtarëve.

Neni 130

Caktimi i datës së referendumit të përgjithshëm

Presidenti i Republikës cakton datën e votimit për referendum të përgjithshëm, në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës.

Neni 131

Referendume me nismën e Kuvendit

Kur Kuvendi vendos për zhvillimin e referendumeve të përgjithshme, në përputhje me pikën 2 të nenit 150 të Kushtetutës, zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, rregullat e parashikuara në këtë seksion për referendumet, sipas pikës 1 të nenit 150 të Kushtetutës.

SEKSIONI 3

Referendumet vendore

Neni 132

Nisma për referendum vendor

1. Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Një numër këshillash bashkiakë ose komunalë, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

4. Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.

PJESA E DHJETË

FUSHATA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Neni 133*

Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon në orën 24⁰⁰ të ditës së premte përpara datës së zgjedhjeve.

2. Dita e shtunë përpara datës së zgjedhjeve dhe dita e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

Neni 134

Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 83)

1. Gjatë fushatës zgjedhore, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

2. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve.

3. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.

4. Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet e depolitizuara.

5. Ndalohet propaganda në favor ose kundër një kandidati ose subjekti tjetër zgjedhor nga ana e të huajve.

Neni 135

Materialet propagandistike

Organet e qeverisjes vendore caktojnë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike.

Neni 136

Fushata zgjedhore në Radiotelevizionin Publik

1. Gjatë fushatës zgjedhore, Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara dhe të KQZ-së, që ndahet sipas rregullave të mëposhtme:

a) KQZ-së i vihen në dispozicion gjithsej dy orë, sipas segmenteve orare të kërkuara prej saj. Të paktën dy të tretat e këtij minutazhi duhet të jenë brenda segmentit orar 18⁰⁰-22⁰⁰;

për partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në parlament, KQZ-ja cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike, kurse për partitë e tjera parlamentare, kjo kohë është jo më pak se 15 minuta. Rritja e kohës së transmetimit brenda grupit përkatës, rrit proporcionalisht kohën në dispozicion të grupit tjetër;

c) çdo parti jashtëparlamentare që merr pjesë në zgjedhje përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike;

ç) në çdo program ose reklamë radiotelevizive në shërbim të propagandës zgjedhore duhet të përcaktohet qartë subjekti zgjedhor përkatës.

2. Radiotelevizioni Publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit të parashikuara në nenet 4, 36 dhe 41 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion e televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë". Minutazhi falas që përfitojnë partitë politike, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të caktohet si pjesë e lajmeve dhe programeve informative.

3. Radiotelevizioni Publik nuk mund të përgatisë ose transmetojë reklama politike me pagesë.

4. Gjatë fushatave për referendum të përgjithshëm, Radiotelevizioni Publik vë minutazh të barabartë prej jo më shumë se tri orësh gjithsej në dispozicion të partive politike që mbështesin secilën prej alternativave.

Neni 137

Edicionet informative të Radiotelevizionit Publik

1. Në minutazhin politik të edicioneve informative, Radiotelevizioni Publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend.*

2. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një force ose të një blloku politik, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve urdhëron reduktimin në të njëjtën masë të kohës në dispozicion të forcës ose bllokut politik ose kompensimin e forcave apo blloqeve të tjera politike me minutazh shtesë brenda 48 orëve.

3. Koha e pasqyrimin të veprimtarive qeveritare, që lidhen me fushatën zgjedhore, përfshihet në kohën e partisë së cilës i përket titullari i institucionit që zhvillon veprimtarinë.

4. Për pasqyrimin e veprimtarive të partive jashtëparlamentare Radiotelevizioni Publik zbaton kriteret profesionale të lajmit, me kusht që koha në dispozicion të jetë jo më e madhe se koha e dhënë për partitë parlamentare.

5. Brenda edicioneve informative gazetarët e Radiotelevizionit Publik e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike.

6. Në rast të shkeljes së kërkesave të përcaktuara në këtë nen, KQZ-ja gjobit, sipas rasteve dhe shkallës së përgjegjësisë, me 15 000 lekë reporterin që ka përgatitur kronikën; me 20 000 lekë redaktorin përgjegjës, me 30 000 lekë Drejtorin e Informacionit dhe me 50 000 lekë Drejtorin e Përgjithshëm.

7. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga Drejtoria e Financës e Radiotelevizionit Publik. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 138

Minutazh falas për KQZ-në

Përveç minutazhit, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 136 të këtij Kodi, Radioja dhe Televizioni Publik vënë 60 minuta falas në vit në dispozicion të KQZ-së për informimin e zgjedhësve. Ky minutazh caktohet në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 136 të këtij Kodi.

Neni 139

Orari i transmetimeve

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 84)

1. Jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik, në bazë të të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja për partitë e regjistruara, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie dhe organizon, nën mbikëqyrjen e KQZ-së, shortin për caktimin e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar.

2. Minutazhi në dispozicion të partive politike dhe të kandidatëve të pavarur caktohet në segmentin orar 18⁰⁰ - 22⁰⁰ të çdo dite të fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit.

Neni 140

Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private

1. Në radiot dhe televizionet private, pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative. Radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre.

2. Radiot dhe televizionet private, për edicionet e tyre të zakonshme dhe të posaçme informative, duhet të respektojnë kushtet e mëposhtme:

a) minutazhi politik i edicioneve informative të radiotelevizioneve private ndahet në segmente kohore sipas nenit 137 pika 1. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një force ose të një blloku politik, KQZ-ja kryesisht ose me propozimin e KZZ-ve a KZQV-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 000 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 2 500 000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga Zyra e Përmbartimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18⁰⁰ e ditës pasardhëse;

b) koha e pasqyrimin të veprimtarive qeveritare që lidhen me fushatën zgjedhore përfshihet në kohën e partisë së cilës i përket titullari i institucionit që zhvillon veprimtarinë;

c) për pasqyrimin e veprimtarive të partive jashtëparlamentare radiot dhe televizionet private zbatojnë kriteret profesionale të lajmit, me kusht që koha në dispozicion të jetë jo më e madhe se koha e dhënë për partitë parlamentare;

ç) brenda edicioneve informative gazetarët e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike. Në rast shkeljeje, KQZ-ja, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 000 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 2 500 000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga Zyra e Përmbartimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18⁰⁰ e ditës pasardhëse.

3. Radiot dhe televizionet private kanë të drejtë të organizojnë debate zgjedhore midis forcave politike ose kandidatëve konkurrentë. Në organizimin dhe zhvillimin e debatit, radiotelevizionet private janë të detyruara të ruajnë barazpeshën mes forcave politike.

Në rast shkeljeje KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18⁰⁰ e ditës pasardhëse.

4. Radiot dhe televizionet private mund të përgatisin dhe të transmetojnë reklama politike me pagesë. Në këtë rast ato janë të detyruara të pranojnë dhe të transmetojnë reklama në raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike nga radiot dhe televizionet private nuk mund të jetë më shumë se 30 minuta në ditë.*

Reklammat për kandidatët përfshihen në kohën e subjektit politik që ata përfaqësojnë.

Për partitë jashtëparlamentare dhe për kandidatët e pavarur radiot dhe televizionet private vënë në dispozicion kohë transmetimi shtesë për reklammat mbi kohën që zbatohet, sipas kësaj pike. Koha e transmetimit të reklamave për partitë jashtëparlamentare dhe kandidatët e pavarur nuk mund të kapërcejë 10 për qind të kohës së programuar dhe zbatuar për reklammat zgjedhore. Për partitë jashtëparlamentare dhe kandidatët e pavarur zbatohen tarifa të njëjta me ato që zbatohen për partitë parlamentare. Në rast shkeljeje KQZ-ja gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 000 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 2 500 000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit gjyqësor. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Në rast shkeljeje KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18⁰⁰ e ditës pasardhëse.

Neni 141[†]

Thyerja e heshtjes zgjedhore

1. Subjekti zgjedhor që thyen heshtjen zgjedhore gjobitet nga KQZ-ja me 500 000 lekë.

2. Botuesi ose operatori radioteleviziv që thyen heshtjen zgjedhore gjobitet nga KQZ-ja me 1 000 000 lekë.

3. Gjoba, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga Zyra e Përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për gjobën nuk pezullon ekzekutimin e gjobës.

Neni 142

Monitorimi i fushatës zgjedhore

* Paragrafi i parë i kësaj pike është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 85)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 86)

1. Dhjetë ditë përpara fillimit të periudhës zgjedhore KQZ-ja ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private. Bordi i Monitorimit të Medias e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin zgjedhor. Për kryerjen e monitorimit Bordi shfrytëzon kapacitetet teknike që disponon Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit. Për transmetuesit vendorë që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese të KKRT-së, Bordi cakton monitorues vendorë. Monitoruesit vendorë të Bordit vendosen pranë KZZ-së ose KZQV-së ku ka qendrën e transmetimit operatori radioteleviziv që monitorohet. Për rregullat, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve teknike të KKRT-së për nevojat e monitorimit, KQZ-ja dhe KKRT-ja lidhin marrëveshje bashkëpunimi jo më vonë se tre muaj përpara datës së zgjedhjeve.

2. Bordi i paraqet KQZ-së çdo ditë raport për përfundimet e monitorimit për ditën pararendëse. Raporti shoqërohet, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Bordi kolegjisht ose secili nga anëtarët e tij ka të drejtë të propozojë marrjen e masave administrative. Monitoruesit vendorë raportojnë përpara KZZ-së ose KZQV-së ku janë vendosur. Kopja e raportit, së bashku me opinionin e KZZ-së ose KZQV-së, i dërgohet menjëherë Bordit të Monitorimit të Medias dhe bëhet pjesë e raportit ditor për KQZ-në.*

3. Ankesat e subjekteve zgjedhore shqyrtohen së bashku me raportin e Bordit Monitorues.

4. KQZ-ja shqyrton raportet e Bordit të Monitorimit jo më pak se një herë në javë. KQZ-ja merr vendim lidhur me raportet sa herë që propozohet marrja e masave administrative. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

5. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë. Secili nga anëtarët e KQZ-së cakton një anëtar të Bordit. Anëtarët e Bordit duhet të jenë me profesion ose përvojë pune si gazetarë apo të jenë analistë ose studiues të mediave.†

6. Radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen për një periudhë tremujore pas përfundimit të zgjedhjeve dhe vihen me kërkesë të KQZ-së menjëherë në dispozicion të Komisionit.

PJESA E NJËMBËDHJETË

FINANCIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 143‡

Financimi i zgjedhjeve

* Kjo pikë është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 87)

† Pikat 4 dhe 5 janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 87)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 88)

1. KQZ-ja administron fondet e caktuara për zhvillimin e zgjedhjeve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

2. Buxheti i KQZ-së përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit.

3. Fondet e buxhetit për financimin e zgjedhjeve janë pjesë e buxhetit vjetor të vitit kur zhvillohen zgjedhjet dhe duhet të jenë të disponueshme nga KQZ-ja 6 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit ose të organeve të qeverisjes vendore. Në të kundërt, fondet e buxhetit janë pjesë e buxhetit të vitit paraardhës.

4. Fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit për fushatën zgjedhore të subjekteve zgjedhore përbëhen nga fondet për financimin e fushatës, të cilat shpërndahen sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të nenit 145 të këtij Kodi, si dhe nga kuota shtesë për fondet për financimin e fushatës, e cila përdoret nga KQZ-ja për dhënien e shumave kompensuese, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Fondet për financimin e fushatës nuk mund të jenë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

Neni 144*

Burimet jopublike të financimit të fushatës zgjedhore

1. Përveç fondeve nga Buxheti i Shtetit, subjektet zgjedhore mund të përfitojnë për fushatën e tyre zgjedhore dhurata nga persona fizikë ose juridikë privatë vendas. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund t'i japë të njëjtit subjekt zgjedhor dhurata në vlerë më të madhe se 1 milion lekë ose kundërvleftën në sende ose shërbime. Subjektet zgjedhore regjistrojnë dhe deklarojnë, në përputhje me nenin 145/1 të këtij Kodi, të gjitha dhuratat e përfituara në periudhën nga data e dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.

2. Partitë politike nuk mund të shpenzojnë për fushatën e tyre zgjedhore, përfshirë dhe atë të kandidatëve të tyre, më shumë sesa dhjetëfishin e shumës më të madhe të përfituar nga një parti, sipas pikës 1 të nenit 145 të këtij Kodi.

Neni 145†

Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondit për financimin e fushatës zgjedhore

1. Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit u shpërndahet subjekteve zgjedhore me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme:

a) 10 për qind e shumës ndahet ndërmjet të gjitha partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të kandidatëve të tyre në KZZ ose KZQV. Partitë që, më vete ose si koalicion, regjistrojnë më pak se 30 kandidatë në zonat zgjedhore njëemërore ose me pak se 30 për qind të numrit të përgjithshëm të kryetarëve të bashkive dhe komunave në shkallë vendi nuk përfitojnë nga shumat që ndahen sipas kësaj shkronje;

b) 40 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive të përfaqësuara në Kuvend dhe deputetëve të pavarur që rikandidojnë. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 89*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 90*)

KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të kandidatëve të tyre në KZZ ose KZQV. Në zgjedhjet vendore kjo shumë ndahet ndërmjet partive që janë të përfaqësuara nga anëtarë të këshillave të bashkive ose të komunave. Shumat, sipas kësaj shkronje, ndahen në përputhje me formulën e paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Kodi;

c) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive që, në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin ose, sipas rastit, për organet e qeverisjes vendore, kanë marrë jo më pak se 2,5 për qind të votave, në përpjesëtim me numrin e votave të fituara prej partive në shkallë vendi, sipas formulës së paraqitur në Shtojcën 1. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

2. Shumat e shpërndara, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, rillogariten dhe rishpërndahen, sipas formulës së paraqitur në Shtojcën 1, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

a) brenda 30 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar, KQZ-ja kryen rillogaritjen e shumave të akorduara dhe përcakton shumat që partitë politike do të përfitojnë si kompensim ose do të kthejnë për shkak të rillogaritjes;

b) partive politike që përfitojnë kompensim, shumat kompensuese u jepen nga KQZ-ja;

c) partive politike që detyrohen të kthejnë shuma, KQZ-ja u kërkon që të shlyejnë detyrimin brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit. Në të kundërt, KQZ-ja i kërkon Ministrin të Financave që të urdhërojë Zyrën e Thesarit që këto shuma t'i mbajë nga fondet e tjera buxhetore që përfitojnë këto parti dhe t'i kalojë ato në buxhetin e KQZ-së. Zyra e Thesarit, së bashku me detyrimin, mban dhe një penalitet në masën 1 për qind të shumës për t'u shlyer në muaj, për çdo muaj vonesë.

3. Partitë politike, të cilat deri më 1 mars 2005, nuk i kthejnë Buxhetit të Shtetit shumat të cilat i detyrohen për pasojë të financimit të fushatës zgjedhore në zgjedhjet e mëparshme, nuk përfitojnë financime nga Buxheti i Shtetit për zgjedhjet e vitit 2005, sipas pikës 1 të këtij neni. Në rast se shuma që këto parti detyrohen të kthejnë është më e vogël se ajo që përfitojnë, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja u shpërndan partive politike përkatëse vetëm diferencën ndërmjet tyre.

Neni 145/1*

Deklarimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore

1. Jo më vonë se 45 ditë pas datës së zgjedhjeve, të gjitha partitë ose kandidatët e pavarur dorëzojnë pranë KQZ-së raportet financiare të fushatës, sipas formularëve dhe udhëzimeve të përcaktuara me vendim të KQZ-së.

2. Raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, publikohen nga KQZ-ja brenda 90 ditëve nga data e zgjedhjeve dhe dokumentojnë të gjitha të dhënat përkatëse, duke përfshirë domosdoshmërisht informacionin për shpenzimet e fushatës, dhurimet dhe fonde të tjera joshtetërore të përdorura në fushatën zgjedhore. Çdo dhurim me vlerë mbi 100 000 lekë ose kundërvlefte e kësaj shume në sende ose shërbime duhet të deklarohet, duke përcaktuar emrin e dhuruesit dhe shumën e dhuruar.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 91)

3. Ndaj partive, koalicioneve ose kandidatëve të pavarur, të cilët nuk i përmbushin këto detyrime raportimi, ose raportimi i të cilëve ka mangësi, KQZ-ja zbaton sanksione administrative, në përputhje me nivelin e shkeljes. Në këto sanksione bëjnë pjesë: humbja e plotë ose e pjesëshme e fondeve, të cilat u janë caktuar nga shteti, gjohë deri në dyfishin e shumës së fondeve që nuk janë justifikuar siç duhet, ose deri humbjen e së drejtës për t'u regjistruar në zgjedhjet e ardhshme, derisa të zgjidhen parregullsitë dhe të paguhet gjoha përkatëse.

PJESA E DYMBËDHJETË

ANKIMET

KREU I

ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE I VENDIMEVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Neni 146*

E drejta e ankimit

1. Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të ankohet në KQZ kundër vendimeve të KZZ-së ose KZQV-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda dy ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në pikat 2 dhe 3 të nenit 18 të këtij Kodi, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZZ-ve ose KZQV-ve.

3. Kërkesat, sipas nenit 117 të këtij Kodi, për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve shqyrtohen, për aq sa lejon neni 117, nga KQZ-ja, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kre.

Neni 146/1†

Llogaritja e afateve

1. Afatet që në këtë Kre janë përcaktuar me orë llogariten duke përjashtuar orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë Kod llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky Kod është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 8⁰⁰ e ditës pasardhëse.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 92)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 93)

2. Afatet që në këtë Kre janë përcaktuar me ditë llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ.

3. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 2 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse.

4. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.

5. Për afatet e ankimit, sipas këtij kreu, nuk mund të ketë rivendosje në afat.

6. Për efekt të këtij neni, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰ dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel.

Neni 147*

Forma dhe përmbajtja e ankimit kundër vendimeve të KZZ-së ose KZQV-së

1. Ankimi zgjedhor kundër vendimeve të KZZ-së ose, sipas rastit, të KZQV-së, paraqitet në formën e kërkesës ankimore dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues dhe adresën e tij;
- b) referimin të vendimi që ankimohet;
- c) bazën ligjore;
- ç) përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- d) përshkrimin e fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore tek të cilat ai mbështet ankimin;
- dh) tregimin e provave të cilat kërkon të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, si dhe burimin e tyre; dhe
- e) datën dhe firmën e ankuesit.

2. Mbi bazën e kërkesave të pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja përgatit dhe vë në dispozicion formularin tip të kërkesës ankimore, në bazë të të cilit hartohet ankimi zgjedhor.

3. Subjekti zgjedhor ankues duhet të depozitojë së bashku me ankimin edhe vendimin e plotë ndaj të cilit ushtron ankimin.

Neni 148†

Regjistrimi i kërkesave ankimore nga KQZ-ja

1. Kërkesat ankimore depozitohen në selinë e KQZ-së. KQZ-ja krijon dhe mban një regjistër të posaçëm për regjistrimin e kërkesave ankimore. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore është i vlefshëm vetëm për zgjedhjet në proces.

2. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore përmban:

- a) numrin rendor të kërkesës ankimore;
- b) datën dhe orën e paraqitjes së ankimit;
- c) subjektin ankimues;

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 94)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 95)

- ç) objektin e ankimit;
 - d) numrin dhe llojin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës ankimore.
3. Pas bërjes së shënimeve në regjistër, subjekti që ankohet merr nga KQZ-ja një vërtetim, i cili provon dorëzimin dhe marrjen e kërkesës ankimore.
4. KQZ-ja nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e kërkesave ankimore.

Neni 149*

Verifikimi i plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore

1. Për çdo kërkesë ankimore të regjistruar KQZ-ja cakton me short si relator njërin nga anëtarët e saj. Relatori bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës, sipas nenit 147 dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 150 të këtij Kodi. Rezultati i verifikimit relatohet në mbledhjen e KQZ-së jo më vonë se 24 orë nga çasti i regjistrimit të kërkesës ankimore.

2. Rregullat për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit, sipas pikës 1 të këtij neni, caktohen me vendim të KQZ-së.

3. KQZ-ja bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos:

- a) kalimin e kërkesës për shqyrtim;
- b) mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 150 të këtij Kodi; ose
- c) kthimin e kërkesës për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 147 të këtij Kodi.

4. Në rastin e parashikuar në shkronjën "c" të pikës 3 të këtij neni, ankuesi bën plotësimin e kërkesës dhe e ridepoziton atë brenda 24 orëve nga çasti i shpalljes së këtij vendimi. Kërkesa ankimore mund të kthehet për plotësim vetëm një herë. Verifikimi i dytë i kërkesës ankimore kryhet brenda 24 orëve nga ridepozitimi i saj.

Neni 150†

Objekti i verifikimit paraprak

KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore pasi verifikon elementet e mëposhtme:

- a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitetin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 96)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 97)

Neni 151^{*}

Përmbajtja e vendimit të pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore

1. Në vendimin e pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore, KQZ-ja duhet të përcaktojë datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike. Vendimi afishohet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij.

2. Seanca e shqyrtimit zhvillohet jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit.

Neni 152[†]

Bashkimi i kërkesave ankimore

1. KQZ-ja, përpara ose gjatë shqyrtimit të një kërkesë ankimore, ka të drejtë të vendosë shqyrtimin bashkërisht të saj me një ose më shumë kërkesa të tjera ankimore, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim të KZZ-së ose KZQV-së. Bashkimi i kërkesave ankimore bëhet edhe në rastet kur dy ose më shumë subjekte kërkojnë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të njëjtën njësi zgjedhore. KQZ-ja vendos bashkimin e kërkesave ankimore kur çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre lehtëson zhvillimin e gjykimit, ose kur shqyrtimi i veçantë i secilës prej kërkesave ankimore mund të paragjykonte objektin e ankimeve të tjera.

2. Kur për të njëjtën njësi zgjedhore janë paraqitur në KQZ kërkesa ankimore dhe kur të paktën njëra prej tyre ka për objekt pavlefshmërinë e zgjedhjeve, KQZ-ja merr në shqyrtim fillimisht kërkesën ankimore me objekt pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Afatet për shqyrtimin e kërkesave ankimore me objekt kundërshtim vendimi të KZZ-së ose KZQV-së pezullohen deri në datën e shpalljes së vendimit të KQZ-së për pavlefshmërinë.

3. Vendimi i KQZ-së për bashkimin e kërkesave ankimore është i formës së prerë.

4. Vendimi i KQZ-së për bashkimin e kërkesave ankimore shpallet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij.

Neni 153[‡]

Palët në shqyrtimin administrativ

1. Palë në procesin e shqyrtimit administrativ pranë KQZ-së janë:

a) ankuesit;

b) palët e interesuara. Palë e interesuar është çdo subjekt zgjedhor, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, kanë të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në përfundim të procedurës administrative.

2. Palët kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë procesit të shqyrtimit administrativ nga përfaqësues të autorizuar të tyre. Subjektet zgjedhore të përfaqësuara në KQZ, si

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 98*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 99*)

[‡] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 100*)

rregull, përfaqësohen nga përfaqësuesit e akredituar të tyre. Kandidatët e pavarur përfaqësohen nga persona të pajisur me prokurë.

3. Palët e interesuara kërkojnë përfshirjen e tyre në shqyrtimin e çështjes jo më vonë se ora e caktuar për zhvillimin e seancës. Pranimi i tyre si palë e interesuar vendoset nga KQZ-ja në fillim të seancës, pas deklarimit të tyre në mbështetje ose kundër kërkesës ankimore. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ mund të marrin pjesë në shqyrtimin administrativ të kërkesave ankimore, vetëm nëse deklarohen dhe pranohen si palë e interesuar, në përputhje me këtë nen.

Neni 154^{*}

Shqyrtimi administrativ

1. Shqyrtimi administrativ për kërkesën ankimore zgjedhore zhvillohet nga KQZ-ja në seancë plenare.

2. Kryetari i KQZ-së drejton seancën plenare.

3. Afatet për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KQZ-ja në konsultim me palët.

4. Shqyrtimi i kërkesës ankimore përpara KQZ-së bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes.

5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore sekretari i KQZ-së mban procesverbal, në të cilin pasqyrohen shpjegimet e palëve, provat që merren, si dhe urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të KQZ-së.

Neni 155[†]

Çelja e seancës për shqyrtimin e kërkesës ankimore

1. Në ditën dhe në orën e caktuar palët njoftojnë sekretarinë e ngritur posaçërisht nga KQZ-ja për praninë e tyre.

2. Përpara fillimit të seancës, administrata e KQZ-së thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton të zënë vendet e caktuara.

3. Pasi deklarohet çelja e seancës së shqyrtimit, verifikohet legjitimitimi procedural i palëve, sipas nenit 153 të këtij Kodi.

4. Në qoftë se në ditën dhe në orën e caktuar njëra ose disa prej palëve nuk paraqiten, seanca zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së tyre.

5. Përpara se palët të paraqesin pretendimet e tyre, KQZ-ja:

a) pranon ose refuzon deklaratimet individuale të anëtarëve të KQZ-së për ekzistencën e konfliktit të interesit, sipas nenit 23 pika 5 këtij Kodi;

b) vendos lidhur me kërkesat e palëve për përjashtimin e anëtarëve të KQZ-së për ekzistencën e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 23 pika 5 të këtij Kodi;

c) vendos lidhur me kërkesat e palëve për mosshqyrtimin e çështjes për mungesë kompetence të KQZ-së, ose kalim të afatit për ankim.

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 101*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 102*)

6. Pasi merr vendim për kërkesat paraprake të palëve dhe në rast se ato nuk sjellin pushimin e shqyrtimit administrativ, KQZ-ja shqyrton dhe zgjidh çështjen në themel.

Neni 156*

Paraqitja e pretendimeve dhe kërkitimi i provave

1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 155 të këtij Kodi, KQZ-ja fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:

- a) të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;
- b) të tregojnë faktet dhe provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile;
- c) të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.

2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KQZ-ja, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit.

3. KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KQZ-së për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin përfundimtar.

4. Paraqitja e pretendimeve të palëve fillon me ankuesin dhe vijon me palët e interesuara, sipas radhës së caktuar nga Kryetari i KQZ-së. Kjo radhë ruhet gjatë gjithë procedimit.

Neni 157†

Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova

1. KQZ-ja u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.

2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së KQZ-së dhe brenda afatit të përcaktuar në të.

3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, KQZ-ja, në përputhje me nenin 179 të këtij Kodi, gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës të përcaktuar në nenin 6 të këtij Kodi.

Neni 158‡

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 103*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 104*)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 105*)

Këqyrja e materialit zgjedhor

1. Për nevojat e hetimit administrativ, KQZ-ja ka të drejtë të kryejë këqyrjen e materialit zgjedhor, që ndodhet në administrim të KZZ-ve ose KZQV-ve. Kur materiali zgjedhor ndodhet brenda kutive me vula sigurie, hapja dhe rimbyllja e kutive me vula të reja sigurie bëhet sipas procedurave që ky Kod parashikon për hapjen dhe mbylljen e kutive nga KZZ-të ose KZQV-të.

2. Këqyrja e materialit zgjedhor bëhet në prani të palëve dhe publikut. Provat e gjetura fiksohen në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së.

3. Kur KQZ-ja çmon se për dhënien e vendimit është i nevojshëm rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara, KQZ-ja kryen, në praninë e palëve, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin dhe pasqyron përfundimin në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së.

Neni 159*

Faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet

1. Për faktet, të cilat janë të njohura botërisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për KQZ-në, për shkak të funksioneve të saj, nuk nevojitet verifikim. Gjatë hetimit administrativ të çështjes, KQZ-ja konfirmon në seancë njohjen dhe marrjen parasysh të tyre në shqyrtimin e çështjes.

2. Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e kërkesave ankimore kërkohen njohuri të posaçme në fusha të shkencës ose teknikës, KQZ-ja mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë.

Neni 160†

Prapësimet mbi provat

1. Palët në shqyrtimin administrativ kanë të drejtë të paraqesin prapësimet e tyre për të kundërshtuar:

- a) mënyrën e marrjes së provave të paraqitura nga palët e tjera;
- b) faktet që tregojnë këto prova; ose
- c) vërtetësinë dhe besueshmërinë e fakteve që tregojnë këto prova.

2. Në mbështetje të këtyre prapësimeve, palët kanë të drejtë të paraqesin edhe prova të tjera, përveç atyre të kërkuara, sipas nenit 156 të këtij Kodi.

Neni 161‡

Mbyllja e hetimit administrativ

1. Pas përfundimit të hetimit administrativ, KQZ-ja pyet palët nëse kanë kërkesa ose prova të tjera në dobi të shqyrtimit të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen,

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 106*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 107*)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 108*)

KQZ-ja i jep fund hetimit administrativ dhe i fton palët të parashtrojnë pretendimet përfundimtare.

2. KQZ-ja vendos, rast pas rasti, nëse palët do t'i parashtrojnë pretendimet përfundimtare me shkrim ose me gojë.

Neni 161/1*

Tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre

1. Në diskutimin përfundimtar, palët e interesuara kanë të drejtë të tërhiqen nga procedimi ose nga ndonjë prej pretendimeve të formuluar, si dhe të heqin dorë nga të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshëm.

2. Tërheqja nga pretendimet ose heqja dorë nga vazhdimi i procedimit në diskutimin përfundimtar nuk ndikon në vazhdimin e procedimit, në qoftë se KQZ-ja çmon se procedimi është në interes të publikut.

Neni 161/2†

Afati për marrjen e vendimit

1. KQZ-ja merr vendim përfundimtar për kërkesën ankimore brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të saj.

2. Në rastin e bashkimit të kërkesave ankimore, afati, sipas pikës 1 të këtij neni, llogaritet nga data e regjistrimit të kërkesës së fundit ankimore.

Neni 161/3‡

Vendimet me shumicë të cilësuar në KQZ

1. Në rast se kërkesa për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sipas nenit 117 të këtij Kodi, nuk merr të paktën 5 vota *pro* të anëtarëve të KQZ-së, kërkesa quhet e rrëzuar dhe kërkesit i lind e drejta e ankimit në Kolegjin Zgjedhor, sipas Kreut II të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

2. Në rast se kërkesa ankimore kundër vendimit të KZZ-së ose KZQV-së për rezultatin e zgjedhjeve nuk merr të paktën 5 vota *pro* të anëtarëve të KQZ-së, atëherë kërkesa ankimore quhet e rrëzuar dhe ankuesit i lind e drejta e ankimit në Kolegjin Zgjedhor, sipas Kreut II të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.

3. Në rast se vendimi i KQZ-së për shpalljen e rezultatit të votimit për listat shumëmemërore për Kuvendin nuk merr të paktën 5 vota *pro* të anëtarëve të KQZ-së, Kryetari i KQZ-së, secili nga anëtarët e saj ose subjekti zgjedhor i interesuar i kërkon brenda 24 orëve Kolegjit Zgjedhor të marrë vendim për të.

Neni 161/4§

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 109*)

† Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 109*)

‡ Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 109*)

§ Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 109*)

Përmbajtja e vendimeve të KQZ-së

1. Vendimi i KQZ-së është gjithmonë i formës së shkruar.
2. Vendimet e KQZ-së për ankimet zgjedhore përmbajnë:
 - a) palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ;
 - b) kërkimet e secilës palë;
 - c) tregimin e çdo prove të marrë në shqyrtim;
 - ç) shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga këto prova;
 - d) analizën ligjore të çështjes; dhe
 - dh) pjesën urdhëruese.
3. Vendimi i KQZ-së përmban numrin, datën, përkatësisht orën e shpalljes së tij, si dhe nënshkrimet e anëtarëve të KQZ-së, së bashku me deklarinimin e votës.
4. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga anëtarët që e mbështesin atë.
5. Vendimi përmban edhe sqarimin për të drejtën e palëve për ta ankimuar në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit.
6. KQZ-ja në asnjë rast nuk nxjerr vendime që nuk përmbajnë të gjitha elementet e përmendura në këtë nen.

KREU II

ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË

Neni 162

E drejta e ankimit në gjykatë

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 168 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.
2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër KQZ-së për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.
3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 18, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZZ-ve ose KZQV-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 146 të këtij Kodi.*

* Titulli i Kreut II dhe neni 162 janë ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 110)

Përbërja e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë

1. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

2. Në shortin e hedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve që përbëjnë Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, përfshihen emrat e të gjithë gjyqtarëve të të gjitha gjykatave të apelit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 165.

3. Shorti për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë hidhet jo më vonë se pesë ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve. Jo më vonë se 24 orë pas daljes së dekretit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë shpall publikisht dhe boton në të paktën tri gazeta me tirazhin më të madh datën, orën dhe vendin ku do të hidhet shorti dhe u dërgon dy partive parlamentare të maxhorancës dhe dy partive parlamentare të opozitës, që kanë përkatësisht numrin më të madh të mandateve në Kuvend, listën e gjyqtarëve që do të përfshihen në short. Shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të partive politike, koalicioneve dhe të medias. Shorti zhvillohet duke tërhequr emrat e tetë gjyqtarëve nga kutia e shortit. Para fillimit të tij, të pranishmëve u jepet mundësia të këqyrin kutinë e shortit dhe emrat e gjyqtarëve të futur në të. Pas këqyrjes, nxirren tetë emra nga kutia. Secili prej përfaqësuesve të dy partive parlamentare të maxhorancës dhe dy partive parlamentare të opozitës, që kanë përkatësisht numrin më të madh të mandateve në Kuvend, ka të drejtën të përjashtojë një prej tetë emrave të nxjerrë nga kutia e shortit. Asnjë prej partive të tjera nuk ka të drejtën e kundërshtimit. Procedura për përjashtimin e emrave është e fshehtë. Kërkesa për përjashtim përmban vetëm emrin e gjyqtarit, pa përmendur shkaqet e përjashtimit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi konstaton rastin e përjashtimit, brenda një ore nga shorti i parë, organizon një hedhje të dytë shorti për të zëvendësuar emrat e përjashtuar nga përfaqësuesit e partive politike. Tetë emrat që mbeten përbëjnë Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe delegohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë menjëherë pas hedhjes së shortit.

4. Brenda 24 orëve nga përzgjedhja e tyre me short, të tetë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë bëjnë betimin në një ceremoni publike, në prani të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nën drejtimin e Presidentit të Republikës. Betimi ka përmbajtjen që vijon: **"Beto hem solemnisht se do të respektoj, mbroj dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të këtij vendi, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Beto hem se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person ose parti."**

5. Shorti i parë për ngritjen e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë hidhet sipas procedurave të parashikuara nga ky nen me shpalljen e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003. Kohëzgjatja në detyrë e Kolegjit Zgjedhor të dalë nga ky short, vazhdon deri me dekretimin e datës së zgjedhjeve të radhës për në Kuvend, për të cilat hidhet një short i ri.

6. Gjykata e Apelit Tiranë vë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor mjedise të mjaftueshme pune, pajisje dhe personel, në mënyrë që të sigurojë kryerjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të detyrave të veta.

Neni 164

Kohëzgjatja dhe mbledhjet e Kolegjit Zgjedhor

1. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i ushtron funksionet e veta gjatë gjithë kohëzgjatjes së legjislaturës së Kuvendit të dalë nga zgjedhjet për të cilat është hedhur shorti.

2. Konstituimi i Kolegjit bëhet menjëherë pas betimit. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit, lidhur me procesin zgjedhor të radhës.

3. Kolegji rithirret në detyrë nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë jo më vonë se 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kuvendin ose të zgjedhjeve të pjesshme apo të përgjithshme për organet e qeverisjes vendore, si dhe për referendumet. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit për këto zgjedhje.

4. Me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Kolegji rithirret në detyrë sa herë që pranë kësaj gjykate depozitohen ankime ndaj vendimeve të KQZ-së, jashtë afateve të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 165

Kriteret për mospërfshirjen e gjyqtarëve në short

Nuk përfshihen në shortin e hedhur, sipas nenit 163:

- a) gjyqtarët e emëruar në detyrë në bazë të pikës 1 të nenit 20 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- b) gjyqtarët, ndaj të cilëve është vendosur fillimi i çështjes penale;
- c) gjyqtarët, ndaj të cilëve është në fuqi një masë disiplinore;
- ç) gjyqtarët, ndaj të cilëve është filluar procedim disiplinor.

Neni 166

Pavlefshmëria e delegimit

1. Delegimi i gjyqtarëve në Kolegjin Zgjedhor është i pavlefshëm në rast se pjesëmarrja e tyre në short është bërë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 165.

2. Pavlefshmëria e delegimit është shkak për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Neni 167

Mbrojtja e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor

1. Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji.

Gjatë kësaj kohe, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk mund të lëvizin nga detyra e gjyqtarit, për shkaqe që lidhen me pikën 5 të nenit 27 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për pamjaftueshmëri profesionale. Ndaj tyre nuk mund të jepet vlerësimi “i paaftë”.

Neni 167/1*

Përrjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes

1. Palët në gjykimin përpara Kolegjit Zgjedhor kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin nga gjykimi i çështjes të ndonjërit prej gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor.

2. Përrjashtimi bëhet nëse rezulton se gjyqtari ka ndonjë interes për çështjen, ka qenë më parë punëdhënës, punëmarrës, këshilltar, përfaqësues ose avokat i ndonjërit prej palëve, ka lidhje gjinie ose marrëdhënie krushqie të afërt me ndonjë nga palët, ose rezulton se ai nuk mund ta kryejë detyrën në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar asnjë prej palëve.

3. Përrjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes bëhet nga Kolegji Zgjedhor. Të gjithë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor vendosin së bashku mbi vlefshmërinë e kundërshtimit ndaj ndonjërit prej gjyqtarëve.

4. Kërkesën për përrjashtim paditësi e paraqet së bashku me kërkesëpadinë, sipas nenit 169 të këtij Kodi, kurse palët e interesuara e paraqesin brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit, sipas nenit 170 të këtij Kodi.

5. Kërkesa për përrjashtim përmban arsyen specifike pse nuk është e përrshtatshme që një gjyqtar i caktuar i Kolegjit Zgjedhor të gjykojë kërkesëpadinë.

6. Kërkesat për përrjashtim të gjyqtarit, të paraqitura jashtë afateve dhe procedurave të këtij neni, nuk merren në shqyrtim.

Neni 168†

Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përrfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.

Neni 169‡

Forma dhe përmbajtja e ankimit

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 111)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 112)

‡ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 113)

1. Ankimi paraqitet në formën e kërkesëpadisë dhe duhet të përmbajë:
 - a) të dhënat për identitetin e paditësit;
 - b) tregimin e palës së paditur;
 - c) tregimin e palëve të interesuara. Palë të interesuara janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë KQZ-së;
 - ç) objektin e kërimit;
 - d) bazën ligjore;
 - dh) përshkrimin e shkëljes së pretenduar dhe pikat e vendimit të KQZ-së, të cilat ankuesi kundërshton; dhe
 - e) faktet, argumentet dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.
2. Kërkesëpadia depozitohet në aq kopje sa është numri i palëve në proces, si dhe shoqërohet me kopjen e vendimit të KQZ-së dhe, sipas rastit, me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit.
3. Kërkesëpadia regjistrohet me paraqitjen e saj.

Neni 170*

Veprimet paraprake lidhur me kërkesëpadinë

1. Pas regjistrimit të kërkesëpadisë, Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë i kalon Kolegjit Zgjedhor çështjen për shqyrtim.
2. Kolegji Zgjedhor njihet me kërkesëpadinë jo më vonë se 24 orë nga dërgimi i saj, sipas pikës 1 të këtij neni dhe:
 - a) merr vendim për kërkesën e paditësit për përjashtimin e gjyqtarit;
 - b) hedh shortin për përbërjen e trupit gjykues dhe relatorin e çështjes; dhe
 - c) cakton datën dhe orën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.
3. Relatori menjëherë pas caktimit kryen veprimet paraprake të mëposhtme:
 - a) njofton palët për datën dhe orën e gjykimit të çështjes dhe përbërjen e trupit gjykues;
 - b) sipas rastit i kërkon paditësit plotësimin e kërkesëpadisë, jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtim gjyqësor;
 - c) u dërgon palëve të interesuara kopje të kërkesëpadisë dhe i informon ato për të drejtën ligjore për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të trupit gjykues, sipas nenit 167/1 të këtij Kodi. Palët e interesuara kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit duhet ta paraqesin brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit, sipas shkronjës "a" të kësaj pike. Kërkesat, sipas kësaj shkronje, shqyrtohen nga Kolegji Zgjedhor brenda 24 orëve nga depozitimi i kërkesës;
 - ç) në rast se KQZ-ja nuk ka lëshuar vendimin, sipas nenit 160 të këtij Kodi, i kërkon asaj të depozitojë vendimin në gjykatë jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtimin gjyqësor.

Neni 171†

Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 114*)

† Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 115*)

1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesëpadive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji Zgjedhor zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallë të parë.

2. Kolegji Zgjedhor gjykon me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Relatori i çështjes kryeson trupin gjykues.

Neni 172^{*}

Të drejtat e palëve në proces

1. Palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadiës kanë të gjitha të drejtat procedurale, që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

2. Provat e administruara nga KQZ-ja gjatë shqyrtimit administrativ sillen prej saj në gjykim, pavarësisht nga kërkesat e palëve për to.

3. Mungesa e njëjës palë gjatë procesit nuk përbën pengesë për vazhdimin e gjykimit nga ana e Kolegjit Zgjedhor, përveç rastit kur Kolegji vendos ndryshe.

Neni 173[†]

Afati i gjykimit në Kolegjin Zgjedhor

1. Kolegji Zgjedhor gjykon dhe vendos për kërkesëpadi të brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesëpadiës.

2. Në rastet e parashikuara nga pika 4 e nenit 164 të këtij Kodi, Kolegji Zgjedhor vendos brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankimit.

Neni 174[‡]

Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

- a) pushimin e gjykimit;
- b) gjykimin e çështjes në themel; ose
- c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.

3. Me gjykimin e çështjes në themel Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padiës ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj, si dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 161/3 të këtij Kodi, shpalljen e rezultatit të votimit për listat shumëmemërore për Kuvendin.

4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim në zbatim të paragrafit 2 të nenit 162 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.

^{*} Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 116*)

[†] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 117*)

[‡] Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (*neni 118*)

5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

Neni 174/1*

Përmbajtja e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor përmbajnë hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

Në hyrjen e vendimit përmenden:

- a) gjykata, trupi gjykues dhe sekretari;
- b) koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
- c) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, palë e interesuar, si dhe përfaqësuesit e tyre;
- ç) objekti i padisë; dhe
- d) kërkimet përfundimtare të palëve.

Në pjesën përshkuese-arsyetuese të vendimit përmenden:

- a) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata;
- b) provat dhe arsyet, në të cilat mbështetet vendimi; dhe
- c) dispozitat ligjore, në të cilat bazohet vendimi.

Në pjesën urdhëruese të vendimit, ndër të tjera, duhet të përmenden:

- a) çfarë vendosi gjykata; dhe
- b) sipas rastit, kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore.

2. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga gjyqtarët që e mbështesin atë.

PJESA E TREMBËDHJETË

PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 175

Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve

Anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të këtij Kodi.

Neni 176

Votimi më shumë se një herë

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie deri në tre muaj.

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 119)

Neni 177

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve

Braktisja e detyrës, pa shkaqe të ligjshme, nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie nga 6 muaj deri në 2 vjet.

Neni 178

Sanksione administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.

2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1 000 deri në 2 500 lekë.

2/1. Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenet 37/1, 43 dhe 47 të këtij Kodi përkatësisht nga sekretari i KZZ-së, KZQV-së ose KQV-së dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.

2/2. Personat e ngarkuar nga ky ligj, me përgatitjen dhe miratimin e listave të zgjedhësve, kur përfshijnë në këto lista të dhëna të rreme ose kur lënë pa përfshirë zgjedhës, përgjigjen penalisht në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

2/3. Shkelja e rregullave të tjera dhe afateve të parashikuara në Pjesën e Katërt të këtij Kodi, kur nuk përbën shpërdorim të detyrës, sipas nenit 248 të Kodit Penal, dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Gjoha vendoset nga titullari i institucionit, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra përkatëse e financës.*

3. Për shkeljet e parashikuara në pikat 2/1 dhe 2/2 të këtij neni dhe në rastin kur shkelja, sipas pikës 2/3, kryhet nga titullari i institucionit, gjoha vendoset nga KQZ-ja.†

Neni 179

Sanksionet për shkelje të parimeve të Kodit

1. Shkelja e ndonjërit nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4 ose 5 të këtij Kodi, në rastet kur kjo shkelje nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.

2. Masa e gjobës përcaktohet në varësi nga rrethanat e mëposhtme:

a) rreziku që formon shkelja për zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në të ardhmen;

b) fakti nëse autori i shkeljes ka përfituar nga shkelja materialisht ose nëpërmjet shkeljes ka ndikuar në marrjen e mandatit nga kandidati, partia politike a koalicioni;

c) kohëzgjatja dhe rrethi i veprimeve që kanë çuar në kryerjen e shkeljes;

ç) fakti nëse ka pasur përpjekje për fshehjen e shkeljes dhe në ç'shmallë kanë qenë ato;

d) qëndrimi i autorit të shkeljes pas zbulimit të saj;

* Pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 janë shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 120)

† Pika 3 është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 120)

dh) fakti nëse në kryerjen e shkeljes kanë marrë pjesë persona zyrtarë ose janë shfrytëzuar burime publike;

e) fakti nëse shkelja është përsëritur;

ë) fakti nëse është kryer në bashkëpunim;

f) rreziku potencial ndaj zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente.

3. Gjobat, sipas pikës 1 të këtij neni, vihen nga KQZ-ja.

4. Shkeljet, sipas pikës 1 të këtij neni, kur kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet.

PJESA E KATËRMBËDHJETË

RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 180

Ruajtja e dokumentacionit

1. Asnjë procesverbal i KQV-së, KZQV-së, KZZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

2. Të gjitha procesverbalet e KQV-së ose të çdo komisioni tjetër të ngritur nga KZQV-ja ose KZZ-ja i jepen KZQV-së ose KZZ-së në mënyrën dhe kohën e caktuar nga KQZ-ja.

3. KZQV-ja dhe KZZ-ja mbajnë nga një kopje:

a) të dokumentacionit të kandidatëve dhe partive politike që marrin pjesë në zgjedhje;

b) të listës së emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KQV-së dhe komisioneve të tjera;

c) të listës së qendrave të votimit;

ç) të listave të zgjedhësve për njësinë zgjedhore;

d) të emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZQV-së ose KZZ-së;

dh) të hartës së njësisë zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;

e) të përshkrimit me shkrim të kufijve të të gjitha njësive zgjedhore;

ë) të dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, të njoftimeve zyrtare për zgjedhjet të KZQV-së ose KZZ-së, të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për çdo qendër votimi dhe të shpalljes përfundimtare të rezultateve;

f) të deklaratës së shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.

4. Dokumentet origjinale, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, i dërgohen KQZ-së brenda tre muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. KQZ-ja mban një kopje dhe ia dërgon dokumentet origjinale Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e kërkuar prej tij dhe brenda 12 muajve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

5. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZQV-ja ose KZZ-ja, komisioni i dërgon KQZ-së, në mënyrën e caktuar prej saj, të gjitha kutitë e vulosura të votimit me procesverbalet e votimit, vulën e komisionit, fletët e votimit të përdorura në zgjedhje, si edhe fletët e votimit të papërdorura.

6. Me marrjen e kutive të votimit dhe fletëve të votimit të papërdorura dhe pas përfundimit të afatit për ankimet, sipas këtij Kodi, KQZ-ja hap të gjitha kutitë e votimit, nxjerr procesverbalet e votimit, si dhe tabelat dhe procesverbalin e numrit të fletëve të votimit dhe ia dërgon ato Arkivit Qendror të Shtetit në mënyrën e caktuar prej tij. Të gjitha fletët e votimit dhe kundërfletët digjen nën mbikëqyrjen e KQZ-së.

PJESA E PESËMBËDHJETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 181*

Zonat zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2005

1. Ndarja e zonave zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2005 bëhet sipas kritereve të mëposhtme:

a) numrit të zgjedhësve të përftuar nga kombinimi i të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2001 të publikuar nga Instituti i Statistikave; numrit të banorëve me shtetësi shqiptare, përfshirë edhe të miturit, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2001; numrit të zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të vitit 2001 dhe vitit 2003 dhe mundësisht numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime në zgjedhjet në vitet 2000, 2001 dhe 2003. Asnjë zonë zgjedhore nuk lejohet të ketë devijim më të madh se 10 për qind nga numri mesatar i zgjedhësve në shkallë Republike;

b) vazhdueshmërisë së zonës zgjedhore. Asnjë zonë zgjedhore nuk lejohet të ketë ndërprerje ose ndërfitje me zona të tjera zgjedhore;

c) kompaktësisë së zonës zgjedhore. Asnjë zonë zgjedhore nuk lejohet të përshkohet nga barriera gjeografike ose ndasi që vijnë për shkak të zhvillimit demografik ose historik;

ç) pandashmërisë së komunës;

d) lidhjeve ekonomike dhe interesave të përbashkët tradicionalë;

dh) mundësive të mira komunikimi brendapërbrenda zonës zgjedhore;

e) kufijve të qarqeve. Asnjë zonë zgjedhore nuk mund të shtrihet gjeografikisht në dy ose më shumë qarqe të ndryshme.

2. Numri mesatar i zgjedhësve për një zonë zgjedhore përcaktohet nga pjesëtimi i numrit të përgjithshëm të zgjedhësve, që përfitohet sipas fjalisë së parë të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, me numrin 100 të zonave zgjedhore.

3. Zonat zgjedhore caktohen me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Kryetari i Kuvendit paraqet në Kuvend në formën e projektligjit ndarjen e zonave zgjedhore. Projektligji duhet të përmbajë:

a) numrin mesatar të zgjedhësve për një zonë zgjedhore;

b) numrin e zgjedhësve të çdo zone, si dhe diferencën midis këtij numri dhe numrit mesatar të zgjedhësve në çdo zonë;

c) hartën e çdo zone zgjedhore;

ç) listën e njësive të qeverisjes vendore që përfshihen në çdo zonë; dhe

* Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 121)

d) përshkrimin e kufijve të çdo zone zgjedhore.

4. Kuvendi shqyrton dhe miraton projektligjin për ndarjen e zonave zgjedhore jo më vonë se data 14 shkurt 2005. Kuvendi nuk mund të ndryshojë kufijtë e propozuar të zonave zgjedhore.

Neni 181/1*

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së në funksion të përtëritjes së përbërjes së tij

1. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 3 të këtij Kodi mbaron më 31 mars 2006. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi, mbaron më 31 mars 2010.

2. Anëtarit të KQZ-së, i cili është zgjedhur fillimisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është përfshirë në përtëritje, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të shfuqizuar, i mbaron mandati në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtari zëvendësues zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përputhje me nenin 22 pika 3 shkronja “a” të këtij Kodi.

3. Mandati i anëtarit të ri të KQZ-së, të zgjedhur në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mbaron në të njëjtën ditë me atë të anëtarëve të tjerë të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi.

Neni 182

Shfuqizime

Ligji nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8780, datë 3.5.2001, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë Kod, shfuqizohen.

KZQV-të e ngritura para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9341 datë 10.1.2005 do të vazhdojnë të funksionojnë deri në shfuqizimin e këtij Kodi.[†]

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, si dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.[‡]

Neni 182/1§

I shfuqizuar

* Ky nen është shtuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004 (neni 2)

† Ky paragraf është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 122)

‡ Ky paragraf është shtuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005 (neni 123)

§ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 9371, datë 14.4.2005 (neni 1)

SHTOJCA 1*

Në bazë të nenit 145, pika 1, do të përdoret formula e mëposhtme për të përcaktuar shpërndarjen e fondeve të fushatës ndërmjet partive:

Përkufizime

D është numri i deputetëve që ka partia në parlament në periudhën e zgjedhjeve. Për kandidatët e pavarur, D është 1.

K është numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillave të bashkive ose komunave që ka partia në periudhën e zgjedhjeve.

KP është numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillave të bashkive ose komunave që përfaqësojnë partitë politike (dmth. jo anëtarët e pavarur).

N është numri i partive që plotësojnë kriteret e nenit 145, pika 1, shkronja "a" e këtij Kodi.

T është shuma e përgjithshme e fondeve në dispozicion të fushatës politike, pa marrë parasysh kuotën shtesë që përshkruhet në nenin 143, pika 4 e këtij Kodi.

V_1 është proporcioni i votës së fituar nga një parti në zgjedhjet e mëparshme për të njejtin organ, shprehur në formë dhjetore midis 0 dhe 1.

V_2 është proporcioni i votës së fituar nga një parti në zgjedhje, shprehur në formë dhjetore midis 0 dhe 1.

Σ_1 është proporcioni i përgjithshëm i votave, shprehur në formë dhjetore midis 0 dhe 1, të fituara në zgjedhjet e mëparshme për të njejtin organ nga të gjitha partitë që fituan mbi 2,5 % të votave.

Σ_2 është proporcioni i përgjithshëm i votave, shprehur në formë dhjetore midis 0 dhe 1, fituar në zgjedhje nga të gjitha partitë që fituan mbi 2,5 % të votave.

FA_1 është shuma e përgjithshme e fondeve që i caktohen një partie politike para zgjedhjeve.

FA_x është një shumë e ndërmjetme që përdoret për të llogaritur shumën që i takon një partie pas zgjedhjeve.

FA_2 është fondi i përgjithshëm, i cili i takon një partie në bazë të rezultatit të zgjedhjeve.

FR është shuma e përgjithshme e fondeve që i caktohet një partie politike thjesht në bazë të regjistrimit të një numri të përcaktuar kandidatësh, sipas nenit 145, pika 1, shkronja "a".

FP është shuma e përgjithshme e fondeve që i caktohen një partie politike, ose në rastin e zgjedhjeve parlamentare dhe një kandidati të pavarur, si rezultat i përfaqësimit të asaj partie në Kuvend ose në këshillat e bashkive/komunave.

FV_1 është shuma e përgjithshme e fondeve që i caktohet një partie politike para zgjedhjeve si rezultat i votave që ajo parti kishte marrë në zgjedhjet e mëparshme. V_1 shprehet në formë dhjetore midis 0 dhe 1.

E është shuma e fondeve të marra nga partitë para zgjedhjeve dhe nuk mund përdoret për rishpërndarje meqenëse rishpërndarja e këtyre fondeve do të kërkonte të përdorej FP dhe/ose FR për atë parti; në fillim të llogaritjeve, E vendoset në 0.

* Kjo Shtojcë është miratuar me ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005

R është shuma e fondeve që do t'i shpërndahet një partie pas zgjedhjeve në përputhje me nenin 145, pika 2, shkronja "b".

M është shuma e fondeve që do të mblidhen nga një parti pas zgjedhjeve në përputhje me nenin 145, pika 2, shkronja "c".

X është numri i deputetëve të pavarur që nuk rikandidojnë, as për një parti, dhe të deputetëve të partive që nuk marrin pjesë në zgjedhje, nëse ata nuk kandidojnë për parti tjetër.

1. Formula e mëposhtme do të përdoret për të llogaritur fondet e caktuara para zgjedhjeve, sipas nenit 145, pika 1.

$$FA_1 = FR + FP + FV_1$$

$$FR = (0.1 * T / N)$$

Për fushatat për zgjedhjet parlamentare, $FP = (0.4 * T * D / 140)$

Nëse ka kandidatë të pavarur apo parti parlamentare që nuk rikandidojnë, $FP = (0.4 * T * D / (140 - X))$

Për fushatat për zgjedhjet për pushtetin vendor, $FP = (0.4 * T * K / KP)$

Për partitë që kanë fituar më shumë se 2,5% të votave në zgjedhjet e mëparshme, $FV_1 = (0.5 * T * V_1 / \Sigma_1)$

Për partitë që kanë fituar më pak se 2,5% të votave në zgjedhjet e mëparshme, $FV_1 = 0$.

2. Në përputhje me nenin 145, pika 2, fondet do të rishpërndahen sipas formulave të mëposhtme:

a. Përlllogaritja fillestare e fondeve të përgjithshme të cilat i takojnë një partie pas zgjedhjeve:

$$FA_x = V_2 * T / \Sigma_2$$

Për partitë që kanë fituar më pak se 2,5% të votave në zgjedhje, $FA_x = 0$.

b. Përlllogaritja e fondeve përfundimtare të cilat i takojnë një partie pas zgjedhjeve (FA_2):

Nëse $FA_x < FA_1$, dhe $FA_1 - FA_x \geq FV_1$, atëherë $FA_2 = FP + FR$ dhe $FA_1 - FA_x - FV_1$ i shtohen E-së.

Për të gjitha partitë e tjera përlllogaritja kryhet pastaj si më poshtë:

$$FA_2 = FA_x * (T - E) / T$$

Nëse, për një parti, $FA_2 < FA_1$, dhe $FA_1 - FA_2 \geq FV_1$, atëherë $FA_2 = FP + FR$ dhe $FA_1 - FA_2 - FV_1$ i shtohet E-së. Atëherë FA_2 llogaritet për të gjitha partitë, përveç atyre të përcaktuara në $FA_2 = FP + FR$. Ky cikël përsëritet derisa $FA_1 - FA_2 \geq FV_1$ për të gjitha partitë, ose $FA_2 = FP + FR$ për ato parti për të cilat kjo nuk qëndron.

c. Në përputhje me nenin 145, pika 2, do të përdoret llogaritja e mëposhtme për të përcaktuar fondet që do t'u rishpërndahen (R) ose mblidhen (M) partive politike pas zgjedhjeve:

Nëse $FA_2 < FA_1$, atëherë $R=0$ dhe $M = FA_1 - FA_2$

Nëse $FA_2 > FA_1$, atëherë $M=0$ dhe $R = FA_2 - FA_1$

Nëse $FA_2 = FA_1$, atëherë $R=0$ dhe $M = 0$.